

# MATURË SHTETËRORE

---

## TESTE GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

---

2016 – 2019

---



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2016

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIM PËR KANDIDATIN

Me kujdes lexo udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test („**Shifra e kandidatit**“)

**Mos i shfletu faqet** dhe mos fillu me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Në detyra duhet të përgjigjesh në një nga mënyrat vijuese:

- duke rrethuar germën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar;
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, pikë së pari zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me përgjigjen e pyetjeve në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin tek përgjigjet. **Shkruaj lexueshëm**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me germa të shkrimit.** Përgjigjet e shkruara me laps vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohej rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Për pjesën Hartim është paraparë të shkruash një tekst në temë sipas dëshirës tënde. Mbikëqyrësi do të jep një fletëshitesënë të cilën janë të shënuara temat e propozuara dhe udhëzimet e detyrës sipas të cilave duhet të shkruash.

**Të dëshirojmë shumë sukses!**



**1 Lexoje me vëmendje fragmentin e veprës "Tartufi" nga Molieri dhe përgjigju pyetjeve!**

***ORGONI***

Mjaft më, o im kunat:  
Ju nuk e njihni atë pa flisni ashtu.

***KLEANTI***

Ja nuk e njoh, të themi, po mjafton,  
Për të ditur se çfarë njeriu është...

***ORGONI***

O im kunat! Ta njihni, veç ta njihni,  
Dhe do të ngazëllohi sa më s'ka.  
Është njeri... njeri... po çfarë njeriu!  
Kush ndjek fjalën e tij, i prehet shpirti,  
I duket kotësirë gjithë bota,  
Kur flas me të, njeri krejt tjetër bëhem  
Se më mëson t'heq dorë nga çdo gjë  
E nga çdo dhembshuri më zverdh shpirtin  
Saqë, tani, as pikë keq s'më vjen  
Sikur bij, nënë e grua t'i shoh shtrirë.

***KLEANTI***

Të shënjtja ndjenja paske, o im vlla'

***ORGONI***

Sikur ta dinit ju se si e njoha,  
Në zemër do t'ju hynte sa dhe mua;  
Në kishë vinte rregullisht çdo ditë,  
Pa gjunjëzohej mu përpara meje  
E falej me kaq zjarr e devocion  
Sa gjithë kthenin sytë nga ai,  
Binte n'ekstaz, me shpirtin lart në qiell,  
E ulej or'e çast e puthte dhenë;  
Pa po kur dilja unë, shpejt më parë  
Te dera vij e m'ip ujë të bekuar,  
Nga shoku i tij, q'i shkonte pas, mësova  
Kush ishte e sa i varfër ishte,  
Zura diçka t'i fal; po, njerëzisht,  
Ai s'deshte t'i merrte që të gjitha.  
"Oh, shumë janë, shumë, mjaft dhe gjysmat!  
S'e meritoj – thoshte – gjithë këtë mëshirë."  
Dhe kur s'pranoja unë të m'i kthente,  
Në sytë e mi të varfërve ua ndante.  
Desh zoti në shtëpi ta marr së fundi  
E q'atë dit' ma gjeti e mira derën.  
Ai vë re çdo gjë, i ndreq të gjithë  
Aq sa dhe sime shoqje s'ja ndan syrin.  
Ma ruan nderin, sheh kush i vardiset,  
E më njofton, - xheloz më keq se unë!



S'mund ta besoni sa i përsjirtshëm është!  
Dhe gjënë më të vogël faj e quan.  
Tronditet për asgjë, merrni me mend:  
Ka disa ditë, erdhi e m'u rrëfye  
Se, tek po falej, kish kapur një plesht  
Dhe e paska vrarë shumë me inat.

***KLEANTI***

Oh, oh, qenki shkalluar, siç më duket,  
Apo mos doni të talleni me mua?  
Me ç'mendje vini? Me të tilla profka...

***ORGONI***

Ju flisni si ata që nuk besojnë.  
Ka nisur të molepset shpirti juaj!  
Shikoni! Jua kam thënë njëqind herë,  
Do të mbaroni keq, po mblidhni mendjen!

***KLEANTI***

Kështu arsyetojnë ca që s'dinë:  
Kush s'është qorr ashtu siç janë ata,  
Kush hap syt' e shikon, - është i pafë.  
Kush s'adhuron ngërdheshjet hipokrite  
S'paska respekt ndaj gjërave të shenjta!  
S'më trembni dot me gjepura të tilla.  
E di se ç'them dhe Zoti ma sheh zemrën.  
Jo, hipokritët nuk ma hedhin dot.  
Ka shenjtë fals siç ka dhe trima fals.  
Po trimat e vërtetë i tregon puna,  
S'të kanë fjalë e mburrje e zhurmë shumë;  
Kështu edhe fetarët shëmbëllorë  
Nga veprat njihen, jo nga skilifacat.  
Po a s'më thoni: s'dini ju ta ndani  
Hipokrizinë nga devocioni?  
Njësoj ju duken, e një vlerë u jepni?  
S'e hiqni dot maskën nga fytyra?  
Të shtirët nga sinqeriteti vetë?  
Të dukurit e rremë nga e vërteta?  
Si e ngatëroni hijen me njeriun?  
Paranë kallpe me paranë e saktë?  
Çudi me njerëzit! Më të shumë syresh  
S'qëndrojnë kurrë brenda masës s'drejtë:  
Nuk u pëlqen të jenë të përkorët;  
U duken fort të ngushta këto caqe,  
I kapërcejnë gjithnjë kufijtë,  
Dhe më të mirat gjëra i zvetënojnë,  
S'duhet harruar, vëlla, kjo e vërtetë!

*Tartufi (skena V) nga Molieri*

(1.1) Sipas fragmentit, çfarë raporti ka Orgoni ndaj religjiozitetit të Tartufit?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.2) Cila dukuri e rrymës letrare, ku bën pjesë kjo vepër, Molieri e pasqyron përmes personazhit të Kleantit?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.3) Në këtë vepër Molieri e kritikon \_\_\_\_\_ e kishës së shoqërisë frënge.

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.4) Brenda kornizave të ngjarjes zbulohet "fytyra e vërtetë" e Tartufit. Kjo realizohet në skenën kur ai shpreh dashurinë e tij ndaj \_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.5) Çfarë lloj drame është "Tartufi"?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.6) Në shtëpinë e kujt zhvillohet ngjarja e dramës?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.7) Cili personazh në fund të veprës do të burgoset nga nëpunësi i mbretit?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.8) Në cilën periudhë të historisë së letërsisë bën pjesë vepra "Tartufi"?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

ANËS LUMENJVE

Arratisur, syrgjynosur,  
Rraskapitur dhe katosur,  
Po vajtonj pa funt, pa shpresë,  
Anës Elbë-s, anës Spree-së,

Ku e lam' e ku na mbeti  
Vaj-vatani e mjer mileti  
Anës detit i palarë,  
Anës dritës i paparë,  
Pranë sofrës i pangrënë,  
Pranë dijes i panxënë,  
Lakuriq dhe i dregosur,  
Trup e shpirt i sakatosur?

Se ç' e shëmpnë derbederët,  
Mercenarët dhe Bejlerët  
Se ç' e shtypnë jabanxhinjtë  
Se ç' e shtrydhnë fajdexhinjtë,  
Se ç' e pren' e e se ç' e vranë,  
Ç' e shkretuan anembanë,  
Nënë thundrën e përdhunës  
Anës Vjosës, anës Bunës!

Çire, digjem i vrerosur,  
Sakatosur, çarmatosur,  
As i gjall' as i varrosur,  
Pres me vjet' e pres me ditë,  
S' e ç' u-tera se ç' u-mpaka,  
S' e ç' u – çora, se ç' u mplaka,  
Lark prej vatrës dhe prej punës,  
Anës Rinit, anës Tunës.

Çakërditur, batërditur,  
Përpëlitur dhe zalisur,  
Ëndërronj pa funt, pa shpresë  
Anës Elbë-s, anës Spree-së.

Dhe një zë vëngon nga lumi,  
Më buçet, më zgjon nga gjumi  
Se mileti po gatitet,  
Se tirani lebetitet,  
Se pëlçet, kërcet furutna,  
Fryhet Vjosa, derdhet Buna,  
Skuqet Semani dhe Drini,  
Dridhet beu dhe zengjini,  
Se pas vdekjes ndriti jeta,  
Dhe kudo gjëmon trumbeta:  
Ngrehuni dhe bjeruni,  
Korini dhe shtypini,  
Katundar' e punëtorë,  
Që nga Shkodra gjer në Vlorë!

Ky ilaç e ky kushtrim  
Më bën djal' e më bën trim,  
Më jep forc' e më jep shpresë,  
Anës Elbë-s, anës Spree-së

Se pas dimrit vjen një verë  
Që do kthehem një herë  
Pranë vatrës, pranë punës,  
Anës Vjosës, anës Bunës.

Arratisur, syrgjynosur,  
Rraskapitur e katosur  
Brohorit me bes' e shpresë  
Anës Elbë-s, anës Spree-së.

Fan Stilian Noli

(2.1) Në poezi pasqyrohet gjendja e rëndë dhe e mjeruar

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(2.2) Në çfarë trajte (forme) është shkruar kjo poezi?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(2.3) Bukurtingëllimi (eufonia) në këtë poezi arrihet përmes theksit ritmitk të cilave rrokje?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(2.4) Noli, poezinë "Anës Lumenjve" e ka shkruar në rrethana historiko-shoqërore gjatë kohës kur

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(2.5) Cila figurë stilistike mbizotëron në strofën e parë?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(2.6) Katër vargjet antitezë të strofës së dytë paraqesin gjendjen

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(2.7) Në cilin nga vargjet e mësipërme poeti krijon figurën impresive të paralelizmit duke e shprehur tërbimin e popullit që bëhet gati të shpërthejë?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(2.8) Si quhet vëllimi i Nolit, ku është përfshirë poezia "Anës lumenjve"?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|



### STUDENTI NË SHTËPI

- A t'u mbush mendja me ardhë, - i tha i ati kur e pa. Nushi u mallëngjye pak me të pamun t'anë dhe donte këtë dhe ta diftojë, por i ati vetëm i shtrini dorën, të cilën Nushi e shtrëngoi pa ditë me u përgjegjë në pyetje. Kur u rrok me motra, këto si me u mendue a ta puthin apo jo. Vetëm puthja e s'amës ishte e kurtë dhe oshtini nëpër shtëpi.

- Mamë, - tue kuvendue një mbramje me Nushin thirri Agia, motra e fejueme, dhe shpejtoi tek e ama në dhomë të zjarrit. Mamë! Nushi thotë se edhe vajzat sa unë, edhe të martueme bile, shkojnë në shkollë. Ha- ha- ha! U përplas qeshja e vajzës në ftyrë të s'amës.

- Mos u qesh ashtu moj bijë, se po të ndijnë kojshijtë... asht marre. Vajza nuk përgjegji, por, e zanun me tregimet e vllaut, mendonte ato vende të çuditshme, ku vajzat nuk lidhen për shtëpi, ku dalin me djelm me shëtitë pa farë turpi, ku kërcëjnë... ah! Kërcëjnë aq bukur.

Vllau muer motrën dhe filloi t'i kallzojë do rregulla, por ashtu në grykë të shoqi-shoqit dhe tue kërcye, i gjeti i ati.

- S'ke marre! Nesër do të martohesh!... Edhe ti, - tue iu sjell Nushit, - s'je i vogël. Shyqyr që paske ardhë sonte herët! – i tha i ati vranët.

Nushi nuk dinte çka me thanë. Nuk dinte me folë me t'anë. Kur ishte fëmi, e kuptonte shumë ma mirë. Por kaloi ajo kohë, kur në imagjinatën e tij baba ishte diçka më tepër se babë, ishte një ideal, ideal i andrimeve fëminore. E sot, e din Nushi, se baba i tij asht një prej qindra – në mos mija- etnish të qytetit tonë, njeni prej atyne etëve që nga fmia i vet duhet me bamë një njeri anakronik, pikturën e vet, trashëgimtarin e dej të një të kaluese të zyrtë.

E Nushi ndigjon. Don me qenë djali i mirë. Si mos me ndigjue babën i cili e lindi, e rriti, e bani aq. Pale mos dëgjo. Megjithëse kundra ndërgjegjes së vet, Nushi ndigjon. Nga fjalët e t'et i shtrembnohet fytyra, por me ndëgjue- ndigjon. Ndëgjojnë edhe vllaznit e motrat, të cilat kanë ndejun përreth dhe të gjithë janë bamë vesh. Pale mos ndëgjo. Ndëgjon edhe nana në dhomë të zjarrit fjalët e burrit të vet dhe me një frigë çuditet për ditunin e madhe të bashkëshortit. Tanë një familje, e mbyllun brenda mureve të shtëpis dhe brenda një ambienti patriarkal, përgatitet për jetën qytetare të nesërme. "Mos të më korisin, - mendon kryetari i familjes, tue i shikue me rend të gjith pjestarët. Mos të më korisin, prandaj shtrëngo frenat, shtrëngo sa të mundesh, e nëse nuk mund të marrin frymë – të pëlcastin. Sa vështirë asht me rritë fëmi në kohë të soçme! Sa vështirë është me ruejtë varzat! Eh kohët e kalueme! – Por a e dini ju, mor fëmi, se unë njaq sa ju ishe, kur fillova me fitue bukën... Nushi ndigjon. Të gjithë ndigjojnë. Pale mos ndëgjo... Nushi e din që dhe baba i tij s'ka faj se asht i tillë; rrethanat dhe shoqnia e krijuen.

Prandaj dhe ka mbetun dashuria birmore në Nushin, pse din të arsyetojë. Por vllaznit e tij, motrat, thue do ta dojnë babën? Kujtohet se kur ishte fëmi, kundrejt babës ma parë ndiente frigë se dashuni. E tash motrat dridhen para babës, e vllaznit nuk e kanë aspak në qejf shoqnin e babës: kur vjen baba ata zhduken.

MIGJENI

**(3.1) Migjenin si artist të fjalës, në këtë fragment e shohim si autor:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. romani
- B. novele
- C. drame
- Ç. skice

1 pikë

**(3.2) Nushi si kryepersonazh studioi në:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. Greqi
- B. Austri
- C. Itali
- Ç. Gruz

1 pikë

**(3.3) Marrëdhëniet në familjen e Nushit janë:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. patriarkale
- B. matriarkale
- C. moderne
- Ç. të lira

1 pikë

**(3.4) Babai i Nushit është:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. i butë
- B. i ashpër
- C. krenar
- Ç. frikacak

1 pikë

**(3.5) Ageja, motra e Nushit, dallohet nga e ëma sepse është:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. gjithnjë e zemëruar
- B. gazmore, e etshme për të renë
- C. e padurueshme
- Ç. llafazane

1 pikë

**(3.6) "Nushi e ndëgjon babën...nga fjalët e t'et i shtrembohet fëtyra, por me ndigjue ndigjon...ndigjojnë edhe vllaznit e motrat...pale mos dëgjo!" këtu na del figura stilistike e :**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. sarkazmit
- B. ironisë
- C. satirës
- Ç. personifikimit

1 pikë

|  |               |
|--|---------------|
| <p><b>4</b> Si quhet disiplina shkencore që merret me studimin e periudhave të zhvillimit të letërsisë?<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. teoria e letërsisë<br/>B. kritika letrare<br/>C. teoria e kulturës<br/>Ç. historia e letërsisë</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>5</b> Vepra në të cilën rrëfëhet jeta e një personi, quhet:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. biografi<br/>B. polemikë<br/>C. udhëpërshkrim<br/>Ç. fejton</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>6</b> "Komedia hyjnore" i përket letërsisë së krijuar në periudhën e:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. romantizmit<br/>B. realizmit<br/>C. humanizmit dhe renesancës<br/>Ç. klasicizmit</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>7</b> Përfaqësues kryesor i letërsisë së realizmit francez është:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. Honore de Balzak<br/>B. Moliere<br/>C. Zhan Rasin<br/>Ç. Andre Breton</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>8</b> Poezitë në të cilat përshkruhet natyra dhe bukuritë e saj, për nga motivi janë:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. shoqërore (sociale)<br/>B. patriotike<br/>C. peizazhiste<br/>Ç. refleksive</p>                                 | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>9</b> Cili nga përfaqësuesit e letërsisë së vjetër greke është autor komedish?<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. Eskili<br/>B. Aristofani<br/>C. Homeri<br/>Ç. Aristoteli</p>  | <p>1 pikë</p> |

|  |               |
|--|---------------|
| <p><b>10 Fjalët që formohen duke u bashkuar dy a më shumë tema, si at+dhe, botë+kuptim, mirë+sjellje, krye+qytet, jetë+gjatë, quhen:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. fjalë të përbëra (kompozita)<br/>B. fjalë të përngjitura<br/>C. fjalë të prejardhura<br/>Ç. fjalë të përziera</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>11 Emrat e gjinisë femërore: mbesë-a, lule-ja, kala-ja, bëjnë pjesë:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. në lakimin e parë<br/>B. në lakimin e dytë<br/>C. në lakimin e tretë<br/>Ç. në lakimin e katërt</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>12 Në fjalën vijuese, morfema “a”, e fjalës “vepra” është:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. prapashtesë<br/>B. nyje<br/>C. mbaresë<br/>Ç. lidhëz</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>13 Fjalët: e, dhe, edhe, janë lidhëza bashkërenditëse:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. këpujore a shtuese<br/>B. veçuese<br/>C. përmbyllëse<br/>Ç. kundërshtore</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>14 “Sa të rrosh, do të mësosh”. – është periudhë me fjali të varur:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. kohore<br/>B. vendore<br/>C. përcaktore<br/>Ç. rrethanore</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>15 Fjala të lexuarit në morfologji është:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. folje në mënyrën lidhore<br/>B. emër i gjinisë mashkullore<br/>C. emër i gjinisë asnjësore<br/>Ç. mbiemër i nyjshëm</p>  | <p>1 pikë</p> |

|  |   |
|--|---|
| <p><b>16</b> Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar drejt:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. nëqoftëse<br/>B. në qoftëse<br/>C. në qoftë se<br/>Ç. nëqoftë se</p>   | <p><b>1 pikë</b></p>  |
| <p><b>17</b> Në fjalinë: <i>Pema ishte e zhveshur nga gjethet, togfjalëshi – ishte e zhveshur</i> është:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. kallëzues i thjeshtë foljor<br/>B. kallëzues i përbërë foljor<br/>C. kallëzues emëror<br/>Ç. kundrinor i drejtë</p> | <p><b>1 pikë</b></p>  |
| <p><b>18</b> Fjalja: <i>Afërdita lexon shumë libra.</i> – sipas kuptimit çfarë fjalie është?</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>19</b> Çfarë lloji përemrash janë fjalët: <i>disa, çdo, të gjithë, secili, ndonjë?</i></p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>20</b> Fjalët: <i>e dashur, e bukur, të bukur, të zellshëm, të bardhë në morfologji janë:</i></p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>21</b> Fjala e huaj definicion mund të zëvendësohet me fjalën shqipe</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>22</b> Çfarë kuptimi ka shprehja frazeologjike: <i>ul kokën?</i></p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |

|  |   |
|--|---|
| <p><b>23</b> <i>Drita është nxënëse më e mirë se Artani.</i><br/>Në këtë fjali mbiemri është përdorur në shkallën</p> <hr/>            | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |
| <p><b>24</b> Kur fjalëve u jepen kuptime figurative, ato quhen:</p> <hr/>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |
| <p><b>25</b> Dega e letërsisë e cila merret me vlerësimin dhe gjykimin e vlerave letrare të një vepre artistike quhet:</p> <hr/>       | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |
| <p><b>26</b> Për një fjali thuhet se është e përbërë, nëse ajo ka së paku</p> <hr/>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |
| <p><b>27</b> Në fund të fjalisë: <i>Rrofsh gjithmonë e lumtur</i> – cilën shenjë të pikësimit duhet të përdorim?</p> <hr/>             | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |
| <p><b>28</b> Në fjalinë: <i>Moti ishte shumë i mirë.</i> - cila prej këtyre fjalëve është kryefjala?</p> <hr/>                         | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |
| <p><b>29</b> Numrin e rrokjeve të një fjale e gjejmë në bazë të numrit të _____ të asaj fjale.</p>                                     | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |
| <p><b>30</b> Dukuritë gjuhësore si: <i>asimilimi, qiellzorizimi (palatalizimi), metafoia, apofonia, rotacizmi</i> etj. janë:</p> <hr/> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 30px; height: 30px; text-align: center; line-height: 30px;">2</div> </div> |

## SEKRETET INTERESANTE TË INDUSTRIE SË MODËS

Industria e modës përmban shumë sekrete që janë të panjohura për shumicën nga ne. Ju paraqesim dhjetë fakte interesante që do t'ju befasojnë.

Gratë moderne nuk mund ta paramendojnë jetën pa stoli. Por, meshkujt janë ata të cilët filluan t'i mbajnë këto shtojca të modës me qëllim që ta theksojnë statusin social të tyre.

Të gjithë kemi kopsa në mëngët e xhaketave tona, por rrallëkush e di se kjo ide buron nga perandori i madh Napoleon Banaparta. Ai kishte kërkuar nga rrobaqepësit e vet të fillojnë të qepin kopsa në mëngët e xhaketave në mënyrë që ushtarët e tij të mos mund t'i fshijnë hundët me to.

Në shekullin e 18-të meshkujt dhe femrat i kanë fiksuar flokët e vet me një sasi të madhe kremi për flokë, të krijuar nga yndyra e gjedhëve, e pastaj i kanë mbuluar me pluhur mielli të grunjtë apo mielli të orizit. Duke qenë se larja është konsideruar si diçka e rrezikshme, ndërsa flokët kanë qenë tepër masivë për t'u larë, parazitët kanë qenë "banorë" të rregullt të flokëve të njerëzve.

Moda e fëmijëve në kohën e sotme është po aq e rëndësishme sa ajo për të rriturit. Çdo nënë dëshiron që fëmija i saj të duket bukur dhe modern. Por, a e dini se moda për më të vegjlit daton prej jo më shumë se 200 vjet më parë? Dikur fëmijët kanë qenë të detyruar të mbajnë kopje më të vogla të dizajneve për burra dhe për gra.

Deri në shekullin e 19-të nuk ka pasur manekine dhe manekinë, kështu që dizajnesit, për t'ua demonstruar kreacionet e tyre konsumatorëve, kanë përdorur kukulla të vogla. Ndoshta kjo ka qenë një ide e mirë, për arsye se nuk kanë qenë të detyruar të shpenzojnë shuma të mëdha parash për revytë e modës.

Flokët e shkurtër sot janë më se të zakonshëm dhe askush nuk befasohet kur sheh ndonjë vajzë me flokë të shkurtër. Megjithatë, dikur nuk ka qenë kështu. Deri para një periudhe, flokë të shkurtër kanë mbajtur vetëm gratë e pabesa. Kjo ka qenë shenjë e pandershmërisë së tyre.

Shumë meshkuj të njohur mbajnë mjekër, midis tyre edhe Bred Piti, Xhorxh Kluni, Robert Patinsoni... Me një pamje jokonvencionale, shumica prej tyre vërtet duken më joshës. Por, sikur këta të jetonin në Rusi në kohën e Pjetrit të Madh, për mjekrat e veta do të duhej të paguanin tatim të veçantë. Ky tatim është caktuar për t'i detyruar meshkujt të rruhen dhe të duken "më evropianë".

Me siguri keni vërejtur se amësia është mjaft e popullarizuar në Hollivud. Miranda Ker, Anxhelina Xholi etj., vazhdimisht e promovojnë amësinë si trend. Kjo "modë" fare s'është e re. Në shekullin e 15-të, shtatzënia ka qenë e popullarizuar deri në atë shkallë sa që gratë që nuk kanë pasur fëmijë, për të krijuar iluzionin se janë shtatzënë, nën veshjet e tyre kanë vënë jastëk.

Veshja e punuar me dorë është shumë e çmuar në mbarë botën dhe konsiderohet si diçka prestigjioze, për arsye se është tejet ekskluzive. Por, deri në vitin 1850, 70% e njerëzve, veshjet e veta i kanë punuar vetë. Me fjalë të tjera, moda për ta, nuk ka pasur fare rëndësi. E rëndësishme për ta ka qenë të qenët komod.

Po që se i vështroni revistat e modës, si për shembull *Vogue*, do të vëreni se te manekinet, bien në sy vetullat e natyrshme të parregulluara, por në periudhën e Rilindjes (Renesancës) ithtarët e modës i kanë rruar vetullat e veta. Shembull i mirë i këtij trendi është piktura e Mona Lizës.

*Burimi: IDIVIDI*

**(31.1) Me çfarë qëllimi meshkujt kanë filluar të mbajnë shtojca të modës?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. që ta theksojnë statusin social të tyre
- B. që të tërheqin vëmendjen e grave
- C. që të ndihen të kënaqur
- Ç. që të jenë më të respektuar

1 pikë

**(31.2) Çfarë kanë promovuar Miranda Ker dhe Anxhelina Xholi si trend mode?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. frizura të reja
- B. veshje moderne
- C. stoli moderne
- Ç. amësi

1 pikë

**(31.3) Me çfarë i kanë fiksuar flokët (frizurën) meshkujt dhe femrat në shekullin e 18-të?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. me llak për flokë
- B. me xhel për flokë
- C. me krem për flokë
- Ç. me balsam për flokë

1 pikë

**(31.4) Cilët burra modernë (në tekst) mbajnë mjekër?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. Majkëll Dagllasi, Marllon Brandoja, Kijanu Rivsi
- B. Bred Piti, Xhorxh Kluni, Robert Patinsoni
- C. Tom Kruzi, Mell Gibsoni, Xhorxh Kluni
- Ç. Morgan Frimani, Denzell Vashingtoni, Bred Piti

1 pikë

**(31.5) Pse meshkujt në Rusi në kohën e Pjetrit të Madh kanë qenë të detyruar të paguajnë tatim të veçantë për mjekrat e tyre?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. që të jenë më të rregulluar dhe për shkak të higjienës
- B. që të theksojnë statusin social të tyre
- C. që të fillojnë të rruhen dhe të duken "më evropianë"
- Ç. që të dallohen për nga niveli i arsimimit

1 pikë



**(31.6) Çfarë u ka kërkuar Napolen Bonaparti rrobaqepësve të tij?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. të fillojnë të qepin kapela
- B. të fillojnë të qepin kopsa në xhamadan
- C. të fillojnë të qepin kopsa në pantallona
- Ç. të fillojnë të qepin kopsa në mëngët e xhaketave

1 pikë

**(31.7) Pse sot veshja e punuar me dorë konsiderohet si diçka prestigjioze?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. sepse është më ekskluzive
- B. sepse është më e përshtatshme (e rehatshme)
- C. sepse është më moderne
- Ç. sepse është më e lirë

1 pikë

**(31.8) Prej çfarë ka qenë i bërë kremi për flokë me të cilin meshkujt dhe femrat i kanë fiksuar flokët (frizurat) e tyre?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. prej sheqeri
- B. prej limoni
- C. prej yndyrës së gjedhëve
- Ç. prej lëvoreve të arrës

1 pikë

**(31.9) Në shekullin e 15-të gratë që nuk kanë qenë shtatzënë, nën veshjet e tyre kanë vënë:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. jastëk
- B. brez
- C. korse
- Ç. mëndafsh

1 pikë

**(31.10) Çfarë u kanë bërë vetullave të veta ithtarët e modës në periudhën e Renesancës?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. i kanë shprishur
- B. i kanë rruar
- C. i kanë ngjyrosur
- Ç. i kanë krehur

1 pikë

### **Evropa midis internetit dhe pajisjeve mobile – koha për kapërcim**

Popullata evropiane e internetit është në rritje konstante. Deri në fund të vitit 2012 në internet kanë “surfuar” pothuajse 410 milionë qytetarë të Evropës, qoftë në punë, qoftë në shtëpi, që paraqet një rritje prej 7 për qind në krahasim me një vit më parë. Një e pesta e të gjitha vizitave në internet kanë ardhur nga telefonat celularë dhe nga tabletët, me ç’rast pjesëmarrja e telefonave celularë është 75%.

Në pesë vende evropiane (Gjermani, Britani të Madhe, Itali, Francë dhe Spanjë) telefona celularë kanë përdorur pothuajse 241 milionë shfrytëzues. Prej tyre, një e treta kanë qenë të moshës deri 35 vjeç. Pjesëmarrja e telefonave të mençur në kategorinë shfrytëzues të pajisjeve mobile është e madhe – 136 milionë të plotë, përkatësisht 57% e shfrytëzuesve. Ajo që më shumti tërheq vëmendjen është dallimi i pjesëmarrjes së shfrytëzimit të telefonave të mençur në shtete të caktuara. Në Spanjë, telefona të mençur përdorin 66% e shfrytëzuesve të telefonave celularë, ndërsa në Gjermani i njëjti numër arrin “vetëm 51 për qind”. Po ashtu prej pesë vendeve të analizuara, pikërisht në Gjermani ndodhet numri më i vogël i shfrytëzuesve të telefonave të mençur. Është më se e sigurt se numri i shfrytëzuesve të telefonave të mençur në të ardhmen do të rritet, për arsye se në dhjetor të vitit 2012, 75% e numrit të përgjithshëm të telefonave të blerë kanë qenë “të mençur”.

Sistemi operativ më së shpeshti i shfrytëzuar i telefonave të mençur është sistemi operativ i Google-Androidit, të cilin e shfrytëzojnë 50% e telefonave, e pas tij pason Apple me një pjesëmarrje prej 20%. Shfrytëzimi i telefonave celularë ndryshon me shpejtësi drite. Në dhjetor të vitit 2012 deri 8,2% të njerëzve e kanë shfrytëzuar telefonin vetëm për bisedë, 32,5% prej tyre e kanë përdor edhe për SMS porosi pa i shfrytëzuar mediumet celulare. Me fjalë të tjera, 60% e shfrytëzuesve qysh atëherë telefonat i kanë përdorur për mediumet mobile, që do të thotë për kërkime në internet, për blerje, për të vizituar rrjetet sociale, për të luajtur lojëra etj. Është me rëndësi të theksohet se nga dhjetori i vitit 2011, domethënë në një periudhë prej një viti, shfrytëzimi i medimeve mobile ka shënuar një rritje prej 30%. Mund të thuhet se 23 milionë e popullatës së pesë vendeve të sipërpërmendura ka edhe telefona të mençur, edhe tabletë.

Një rritje të jashtëzakonshme patën edhe video përmbajtjet. Derisa të shikuarit e videopërmbajtjeve të kompjuterëve, nga dhjetori i vitit 2011 deri në dhjetorin e vitit 2012 është rritur për 5%, të shikuarit e videopërmbajtjeve në pajisjet mobile është rritur për 162%, prej 20 milionë shikimesh të vetme, në 50 milionë.

Filluam me të dhëna të përgjithshme, për të ardhur në përfundim. Motori i kërkimit “Google” ende është pa konkurrencë midis shfrytëzuesve të internetit në BE. Pjesëmarrja e tij në lëmin e hulumtuar është 86%. Pas tij vijnë „Yandex“ me 10%, „Mail.Ru“ me 2%, „Bing“ dhe „Ask Network“ me nga 1%.

Duket sikur interneti, sikurse edhe shfrytëzuesit e tij zhvendosen në ujëra mobile – në telefona të mençur dhe në tablete. Me këtë rast, duhet thënë se kësaj tendence i përshtaten edhe ofertuesit e produkteve dhe të shërbimeve, por gjithsesi edhe agjencitë e shpalljeve, të cilat në ofertat e veta duhet t’i fusin edhe kanalet e reja të komunikimit siç është interneti dhe të dinë të parashikojnë të ardhmen ose të paktën një pjesë të saj. Sa i përket fatit, ai, si gjithmonë, i përcjellë të guximshmit.

[http://www.ris.org/uploadi/editor/13646247392013\\_europe\\_digital\\_future\\_in\\_focus.pdf](http://www.ris.org/uploadi/editor/13646247392013_europe_digital_future_in_focus.pdf)

(32.1) Sa qytetarë të Evropës kanë surfuar deri në fund të vitit 2012?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.2) Sa përqind të shfrytëzuesve të telefonave celularë në Spanjë përdorin telefona të mençur ?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.3) Në cilin nga pesë vendet e analizuara ndodhet numri më i vogël i shfrytëzuesve të telefonave të mençur ?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.4) Cili është sistemi operativ që më së shpeshti shfrytëzohet nga telefonat e mençur?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.5) Në dhjetor të vitit 2012 deri 8,2% të njerëzve e kanë shfrytëzuar telefonin vetëm për

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.6) Përdorimi i cilave përmbajtje rritet për 5 % në periudhën prej në dhjetor të vitit 2011 deri në dhjetor të vitit 2012?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.7) Cili motor kërkimi është ende pa konkurrencë?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.8) Agjencitë e shpalljeve në ofertat e veta duhet patjetër t'i fusin edhe:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**33 Mbikëqyrësi do të të japë një fletë plotësuese, në të cilën janë dhënë dy tema. Zgjidhe vetëm njërën temë dhe:**

13 pikë

- Shkruaj një ese që do të përmbajë 350 deri në 500 fjalë.
- Respektoji rregullat e kompozicionit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore - shtjellimi i çështjes / i temës, përfundimi dhe fjalitë nënrenditëse).
- Respektoji rregullat dhe normat e gjuhës standarde (letrare).
- Mendimet shprehi qartas dhe në mënyrë të lidhur, përdor argumente, përkatësisht fakte dhe dëshmi.
- Përdor stil dhe leksik përkatës.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---





Ruled lines for writing, consisting of 30 horizontal lines.



Lined writing area with 30 horizontal lines.

| Gjuhë                  |   |
|------------------------|---|
| 1                      | 2 |
| Kompozicioni i tekstit |   |
| 1                      | 2 |
| Përbajtja              |   |
| 1                      | 2 |

*FAQE E ZBRAZËT*



*FAQE E ZBRAZËT*



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

gusht, 2016

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Me kujdes lexo udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test („Shifra e kandidatit“)

**Mos i shfleto faqet** dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Në detyra duhet të përgjigjesh në një nga mënyrat vijuese:

- duke rrethuar shkrojnë para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar;
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, pikë së pari zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me përgjigjen e pyetjeve në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin të përgjigjet. **Shkruaj lexueshëm**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkrojnë të shkrimit**. Përgjigjet e shkruara me laps vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Për pjesën Hartim është paraparë të shkruash një tekst në temë sipas dëshirës tënde. Mbikëqyrësi do të të japë një fletëshesë në të cilën janë të shënuara temat e propozuara dhe udhëzimet e detyrës sipas të cilave duhet të shkruash.

**Të urojmë shumë sukses!**



**1** Lexoni me vëmendje fragmentin nga vepra “Hamleti” e Uiliam Shekspirit dhe përgjigjuni pyetjeve.

**Akti III, Skena IV**

*Hyjnë mbretëresha dhe Polloni*

**POLLONI**

Po vjen, i foli dhe jepi të kuptojë  
i thuaj që shakafi tepëroi  
Që u nxeh në gjakrat, po ndërhyrja jote  
E nderqi punën. Unë prapa perdes,  
Këtu, të mbaj; foli hapur, të lutem.

**HAMLETI** (*Që përbrenda*)

O nën', o nën' o nënë!

**MBRETËRESHA**

Të siguroj që do t'i flas si duhet,  
Mos, kij kujdes; largohu se po vjen.  
(*Polloni shkon prapa perdes. Hyn Hamleti*)

**HAMLETI**

Ç'më deshe, nënë?

**MBRETËRESHA**

E ke lënduar fort tët atë (Klaudin), Hamlet

**HAMLETI**

E ke lënduar fort tim atë (mbretin Hamlet), nënë

**MBRETËRESHA**

Eja, eja, mos m'u përgjigj me tallje

**HAMLETI**

Hajde, hajde, mos më pyet me çpojtje (fjalë shpuese)

**MBRETËRESHA**

Ç'do të më thuash, Hamlet?

**HAMLETI**

Ti thuamë, ç'më deshe?

**MBRETËRESHA**

Harron, përpara kujt po ndodhesh

**HAMLETI**

Për Krishtin jo e jo. Je Mbretëresha  
E shoqja e të vëllait të burrit tënd  
edhe, për fat të zi, je nëna ime...



**MBRETËRESHA**

Të çoj pra ku të dinë të të flasin.

**HAMLETI**

Mos luaj vendit; hajde ulu poshtë,  
S'të lë pa vëvë një pasqyrë syve  
Ku të shikosh të zitë e zemrës sate.

**MBRETËRESHA**

Ç'mendon të bësh? Mos të më vraç?  
Ndihmë! Ndihmë! Oh!

**POLLONI**

*(Prapa perdes)* Ndihmë! Ndihmë! Oh!

**HAMLETI**

*(nxjerr shpatën)* Si, qysh?  
Një mi? U vra! Vë bast se u vra!  
*(Goditi nëpër perden)*

**POLLONI**

*(Prapa perdes)* Oh, oh, më vrau! *(bie dhe vdes)*

**MBRETËRESHA**

E mjera unë, ç'bëre?

**HAMLETI**

Nuk di!  
Mos ishte mbreti?

**MBRETËRESHA**

Oh, çfarë vepër e egër dhe e gjaktë!

**HAMLETI**

E gjaktë? Nënë e mirë, jo më keq sesa të vraç një burrë  
e mbret mënjane dhe sheshit të martohesh me të vëllanë!

**MBRETËRESHA**

Të vraç një mbret!

(1.1) Çfarë lloj vepre dramatike është “Hamleti“?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.2) Në cilin shtet zhvillohet ngjarja në këtë vepër?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.3) Prej kujt Hamleti e kupton shkakun e vërtetë për vdekjen e babait të tij?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.4) Çfarë ndien Hamleti për nënën e vet, e cila vërehet në këtë fragment?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.5) Cila është tema e fragmentit?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.6) Në cilën periudhë të letërsisë botërore bën pjesë kjo vepër e Shekspirit?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.7) Çfarë ndodh me Hamletin në fund të veprës?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.8) Çfarë kanë dashur të zbulojnë Polloni me mbretëreshën gjatë bisedës me Hamletin?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**"HANKO HALLA" NGA ALI ASLLANI**

**Pjesa e dytë**

1. Nuse kësaj kohe tjetër zanat s'paska,  
a do marr' kalemin, që të bëj' laraska,  
a do zër' të shkruaj' ose do dëgjojë  
një kuti të vogël që na flet me gojë.  
Një kuti të vogël që mos qoft' të jet',  
është një frëng i marrë, çirret e bërtet!
2. Me një biz' në dorë bën sikur punon,  
këmbë përmbi këmbë nusja e dëgjon;  
dhe çudi, moj motër, si e çysh duron!  
Duket nga një herë zëri e lëndon,  
frëngu rri i qetë ose do bërtas',  
nusja e humbët dhe i vete pas,  
frëngu e ngrë zërin edhe sokëllin  
nusja e lë për in edhe vërshëllin;  
ai flet me vete, flet e flet përçartë  
nusja s'është në vete, bëhet më e zjarrtë!
3. Halla do një nuse, nuse goja plotë,  
si një zall të bardhë, si një zall të fortë,  
me shami në krye anë e mban' qëndisur  
dhe me flok' të gjata prapa arratisur;  
dhe me flok' të gjata deri mu në mes  
mu si nat' janari, sa të thell' të zes;  
me shami të hollë ballë e faqe hedhur,  
sa t'i duket syri në qepalle kredhur;  
me flori në gushë hapur mu si prush,  
si t'ju them, moj motra.... pjergulla me rrush!
4. Rrallë e tek të duket, rrall e tek të flas',  
një thëllëzë e bukur mbyllur në kafaz,  
mbyllur në kafaz një thëllëz e bukur,  
mu në mes të reve hëna në të dukur,  
mu në mes të reve si hënë e si yll  
ose si në xhinde fshehur në një pyll!  
Halla do një nuse si edhe i biri  
rrënjët prej ergjendi, degat prej floriri  
me të folur halla, nusja të hap sytë  
"Lepe" fjala e parë "peqe" fjala e dytë;  
edhe asgjë tjetër, vetëm "lepe", "peqe",  
pasi zemra Hallës qenka si një qelqe:  
po u thye, vajti, e s'ka më: ngjite, qepe,  
zogu i plagosur di të kap' me sqepe!

*"Hanko Halla" Ali Asllani*

**(2.1) Në pjesën 1 dhe 2 të fragmentit të dhënë përshkruhet:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. bukuria e nuses së Hanko Hallës
- B. ankesat e Hallës, se si nuset e kohës së sotme bëjnë punët dhe kalojnë kohën
- C. dallimi i klasave mes Hallës dhe nuses
- Ç. aftësia e nuses për t'i bërë punët e shtëpisë

1 pikë

**(2.2) Ç'nënkuptoni me vargun "një kuti të vogël që na flet me gojë"?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. radio
- B. televizor
- C. kompjuter
- Ç. një libër që e lexon nusja

1 pikë

**(2.3) Sipas Hanko Hallës nusja duhet të duket:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. e lyer, e rregulluar
- B. gjysmë e veshur dhe gjysmë e zhveshur
- C. e veshur sipas modës së fundit
- Ç. me shami në kokë, me flokë të gjata, me flori në gushë

1 pikë

**(2.4) Ç'domethënie kanë vargjet:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

*"Halla do një nuse si edhe i biri  
rrënjët prej ergjendi, degat prej floriri"*

- A. simbolizojnë pasurinë e hallës
- B. tregojnë për nipin se sa i pashëm është
- C. simbolizojnë shtresën e bejlerëve nga e cila rrjedh i nipi
- Ç. simbolizojnë shtresën klasore të nuses

1 pikë

**(2.5) Vargu që përdor Ali Asllani te vepra "Hanko Halla" është?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. gjashtërokëshi
- B. tetërokëshi
- C. dhjetërokëshi
- Ç. dymbëdhjetërokëshi

1 pikë

**(2.6) "Hanko Halla" i takon llojit të:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. poemës
- B. tregimit
- C. novelës
- Ç. epit

1 pikë



## DRAMA "EMIRA" NGA ANTON SANTORI

### *Akti II, skena 3*

**Emira:** Ik, ore! S'e zija besë. Po më sqaro tash një dyshim: unë dua edhe aq të tjerë...

**Miriani:** Dua të them: dua edhe aq miq e kushërinj e pse nuk dridhem kur gjendem ndonjëherë me ty bashkë me ata, kurse, sa herë që takohem me ty gjithnjë më rreh zemra, më tundet barku, më ndizet fytyra, më dridhen gjunjët e më mpihen krahët? Një ngutësi që s'di as si ta them vetë, më shtyn të iki shpejt dhe, pasi kam ikur, më vjen keq që të mund të ndodhem vetëm për vetëm me ty. Shumë herë, natë e ditë, mendoj për kush e di sesa fjalë e të pyetura që dua të të bëj. Po pastaj me t'u takuar me ty, përnjëherë më mbyllet goja. Kur m'i dhe ato dardha te Përroi, unë nuk i desha, po pastaj i mbajta natë e ditë në duar e në gjinj, gjersa u thanë! Tufën me manushaqe që më dhe pardje, e kam ende këtu.

**Miriani:** Ku e ke?

**Emira:** Brenda nyjes së gërshetës, po tashti janë tharë.

**Miriani:** Hidhi tashi, ç'i do më? Tash që s'kanë më erë!

**Emira:** Qoftë larg! Bashkë me to do të hidhja edhe një pjesë të vetës sime!

**Miriani:** M'i jep mua, se të mbledh të tjera më të freskëta.

**Emira:** Ta prish nyjen dhe gërshetin? Korrdhelja është e gjatë dhe po ndodhi që të kaloj njeri e më sheh ashtu të përflushur? Shkojmë

**Miriani:** Qofsh bekuar, vajzë e mençur!...Ti ke më shumë urti se unë! Ec, ec me engjëllin.

### *Skena 4*

**Kalina:** Me gjasë unë s'vlej më fare sa për qiellin e as për botën? Vetëm varri është vendi që nuk më shtyn! . . . Kjo punë vajti aq larg sa s'ka ku vete më zi. Zemra ime u vyshk mu si lulja e ujit, e mbetur pa ujë, të cilën dielli vapullor e than dhe djeg! Miriani m'i preu të gjitha shpresat, jo aq me të bëta sa me të thëna. Ai më tregoi se femër tjetër, pos Emirës, për të s'ka lindur në botë.... Ç'fat që pati pëllumbesha...Moj, a është e mundur që Kallonjeri e hëngri gjith atë dajak pa bërë zë fare? Unë do ta ndez.

### *Akti V, skena 1*

**Kalina:** Po duhet të rrëfhem: mua s'më përket fare kjo mirësi për shkak të ligësisë që pata.

**Emira:** Ç'ligësi do të mund të kishe pasur ti? Unë besoj se je një vashëz si një kordele e bardhë.

**Kalina:** O motër ti e mat botën me zemrën tënde, po nuk është ashtu. Jo ç'do dritë që na shkëlqen është diell!!Ja edhe unë vetë, jo më shumë se tridhjetë ditë para isha aq e zezë.

**Emira:** Obobo! Ç'thua ndrikull? Ti po më plas shpirtin me këto fjalë!

**Kalina:** Mua më duhet të të lyp ndjesë në gjunj dhe duke qarë me lot vërtet të hidhur.

**Emira:** Ç'bën moj motër? Ngreu, për nder të tynë Zot! Ç'bën kështu? A mos luajte mendsh?

**Kalina:** Kij mëshirë, motër, dëgjomë një thërrimëz për nder të shenjtë Virgjër.

**Emira:** Ngrehu njëherë e mandej më fol si të duash ti.

**Kalina:** Jo motër, jo, detyrohem që të flas kështu, po pate mëshirë të më dëgjosh e të më shërosh.

**Emira:** O Zot, ndihmomë! Ç'mund të më kishe bërë ti s ta meritoj tërë këtë pendesë?

**Kalina:** Ty Emirë të thonë dhe vërtet je. Ç'të bëra. Pak m'u desht madje që të të shqyeja edhe me sy. Qe një kohë kur të kurdisja një ndodhi aq të keqe sa smund të rrëfëhet, desha të të helmoja! .

**Emira:** Unë jam e trallisur, s'di as ç'të them, as ç'të mendoj, ç'duhet të bëj?

**Kalina:** Duhet të më falësh.

**Emira:** Të faltë ynë Zot. Po përse të të fal, që s'më ka vajtur kurrë mendja se më ke bërë lig.

**Kalina:** Jo, motër, më fal, më fal me gojën tënde për gjithë të këqijat që t'i desha.

*Drama "Emira" nga Anton Santori*



(3.1) Pse shfaqet shqetësim tek Emira kur takohet me Mirianin?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.2) Çka simbolizojnë dardhat që Miriani ia ka dhënë Emirës?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.3) Cilën figurë stilistike ka përdorur autori kur thotë: *më tundet barku, më ndizet fytyra*?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.4) Për kë mendon Kalina në skenën 4 kur thotë: *Ç'fat që pati pëllumbesha*?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.5) Përmes fjalëve që thotë Kalina: *Unë do ta ndez* - shprehet xhelozia e Kalinës ndaj dashurisë së

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.6) Cila është tema qendrore në dramën "Emira"?

1 pikë

---

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.7) Përveç veprimeve shkatërrimtare të cubave, cili është faktori tjetër që përpiket ta pengojë dashurinë mes Mirianit dhe Emirës?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.8) Cilat veti të Emirës dalin në pah në aktin V, skena 1?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|  |               |
|--|---------------|
| <p><b>4 Lloji letrar-publicistik në të cilin përshkruhet ajo që autori e ka parë, përjetuar dhe regjistruar për një vend tjetër, quhet:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. autobiografi<br/>B. biografi<br/>C. udhëpërshkrim<br/>Ç. fejton</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>5 Tercina është:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. lloj vjershe e përbërë prej tri strofash<br/>B. lloj këmbë ritmike<br/>C. strofë e përbërë prej tri vargjesh<br/>Ç. lloj rime e alternuar</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>6 Hiperbola është figurë stilistike:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. me të cilën shprehet krahasim mes dy dukurish, duke e përdorur fjalën "si"<br/>B. me të cilën zmadhohen apo stërzmadhohen veçoritë e njerëzve apo sendeve<br/>C. ku përsëriten të njëjtat fjalë në fillim të disa vargjeve<br/>Ç. kur sendeve, bimëve dhe dukurive u japim veçori njerëzore</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>7 Përsëritja e të njëjtave rrokje të theksuara në fund të dy a më shumë vargjeve, quhet:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. ritëm<br/>B. strofë<br/>C. këmbë ritmike<br/>Ç. rimë</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>8 Teksti në të cilin ndërthuret artistikja me shkencoren, quhet:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. ese<br/>B. polemikë<br/>C. kronikë<br/>Ç. intervistë</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>9 Një tërësi e plotë ose e përmbyllur kuptimore, që është pjesë e një vepre dramatike, quhet:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. epilog<br/>B. didaskalie<br/>C. akt<br/>Ç. skenë</p>   | <p>1 pikë</p> |

|   |               |
|---|---------------|
| <p><b>10</b> Në fjalinë e dhënë: <i>Si vdes tek unë kujtimi yt, fjala tek është:</i><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. emër<br/>B. parafjalë<br/>C. pjesëzë<br/>Ç. pasthirmë</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>11</b> Dukuria e ndërrimit të zanores /a/ në /e/ si p.sh.: <i>plak-plëq</i> në fonetikë njihet si:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. apofoni<br/>B. palatalizim<br/>C. metafoni<br/>Ç. metatezë</p>                         | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>12</b> Rrethoni fjalën që është formuar me paranyjëzim:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. shpirtmadh<br/>B. shitblerje<br/>C. i lexuar<br/>Ç. nëpunës</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>13</b> Cililit lakim i përkasin emrat: <i>fëmijë, lule, dajë?</i><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. lakimit të parë<br/>B. lakimit të dytë<br/>C. lakimit të tretë<br/>Ç. lakimit të katërt</p>                             | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>14</b> Në fjalinë: <i>Shumë erdhën e pak mbetën. Fjalët e nënvizuara janë:</i><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. përcaktorë<br/>B. mbiemra<br/>C. ndajfolje<br/>Ç. përemra</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>15</b> Fjalja: <i>Liria është ajo që i bën të lumtur njerëzit. është fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur:</i><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. kryefjalore<br/>B. kallëzuesore<br/>C. kundrinore<br/>Ç. përcaktore</p> | <p>1 pikë</p> |

**16** Në fjalinë: *Na priti me krahë hapur pjesa e nënvizuar në sintaksë është:*

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. rrethanor kushti
- B. rrethanor mënyre
- C. rrethanor vendi
- Ç. rrethanor shkaku

1 pikë

**17** Fjalët në vijim "lart, atje, brenda, këtu, përpara" janë:

(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. ndajfolje të mënyrës
- B. ndajfolje të vendit
- C. ndajfolje të kohës
- Ç. ndajfolje të sasisë

1 pikë

**18** Në fjalinë *Armikut dhe erës tregoju gjoksin*, emri armikut është në rasën

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**19** Sipas kategorisë së vetës, foljet: agon, ngryset, bubullon, vetëtin janë folje

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**20** Fjalën gendra ndaje në dy pjesë sikur të ndodhet në fund të rreshtit

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**21** Në sintaksë fjalia *Nuk flitet keq për shokët*, është fjali

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**22** Cilat janë zanore buzore në gjuhën shqipe?

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|  |   |
|--|---|
| <p><b>23</b> Mbiemri i <u>ftohtë</u> në shkallën sipërore bën:</p> <hr/>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>24</b> Fjalët: <u>po, bile, pikërisht, le, pa, si urdhëro, jo se jo</u> në morfologji janë</p> <hr/>                                     | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>25</b> Pjesët e nënvizuara në fjalitë: <u>Na</u> e dha librin, <u>Ua</u> dha librat, <u>M'i</u> dha librat në morfologji janë:</p> <hr/> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>26</b> Në cilën mënyrë është forma e foljes: <u>vrapuaka</u>?</p> <hr/>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>27</b> Çfarë kuptimi ka shprehja frazeologjike: <u>i vari buzët</u>?</p> <hr/>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>28</b> Në fjalinë <i>Vdekja e Skënderbeut shkaktoi dhimbje të thellë në Shqipëri</i>, pjesa e nënvizuar në sintaksë njihet si:</p> <hr/> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>29</b> Shkruaje në formën e pashtjelluar të paskajores foljen <u>ha</u>:</p> <hr/>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>30</b> Në togfjalëshin "<u>buzë lumit</u>" fjala "<u>buzë</u>" në morfologji kryen funksionin e:</p> <hr/>                               | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |

### HUMBËSIT MË TË MËDHENJ NË VITIN 2015

Këto ditë magazina prestigjioze “Forbs” dhe internet portali “Yahoo” i paraqitën listat në të cilat janë radhitur dhjetra filma të cilët në këtë 2015 producentëve të tyre u sollën humbje serioze në vend të fitimit të pritur. Është interesante se edhe angazhmani i yjeve me famë nuk është ndonjë garanci e sigurtë se filmi do të jetë i suksesshëm. Për këtë ka shumë shembuj në historinë e filmit, por edhe në këtë 2015.

I tillë është rasti me komedinë “Kazbah rok” në të cilën rolet kryesore i luajnë Bill Mari, Brus Villis, Kejd Hadson dhe Zoi Deshanell. Sipas revistës “Fobs”, filmi ka përfituar vetëm 2.87 milionë dollarë, përderisa buxheti për të ishte 15 milionë dollarë. Sipas këtyre të dhënave, përqindja e kthimit të parave për këtë film është mizere vetëm 19,3%.

Ose të themi filmi “Pan” i regjisorit Xho Vrajt i cili në distribucion hyri më 9 tetor, në të cilin rolin kryesor e luante megaylli Hju Xhekmen. Sipas “Yahoo”-së humbjet nga ky film mund të përshkruhen si epike. Në fakt buxheti i filmit ishte 150 milionë dollarë. Në këtë shumë duhet të shtohen edhe 120 milionë dollarë që janë harxhuar për marketingun e filmit në të gjithë botën dhe së bashku me mjetet e harxhuara arrijnë shifrën maramendëse prej 270 milionë dollarësh. Film i deri tani ka fituar 35 milion dollarë në kinosallat në SHBA dhe në pjesën tjetër të globit edhe 89 milionë dollarë shtesë ose gjithsej 123 milionë dollarë. Sipas llogarive përfundimtare, humbja mund të llogaritet shumë lehtë dhe kjo kap shumën e 147 milionë dollarëve.

Nuk kaloi më mire as Shon Pen me filmin “Shigjetari”, dramë tek e cila Pen paraqitet si bashkautor. Kjo dramë kriminalistike-akcion filloi të shfaqet më 30 mars në kinosallat në SHBA dhe në botë e deri tani ka arritur të fitojë 10.7 milion dollarë, që nuk është as i përafërt me buxhetin e filmit prej 40 milion dollarëve. Pa harxhimet shtesë rreth marketingut, ai arriti që t’i kthejë mjetet e investuara vetëm 26.7%. Kjo përqindje është edhe më e vogël nëse llogariten edhe harxhimet për marketing.

Blokbasteri potencial “Katërshja fantastike”, sipas përfitimit nuk i plotësoi pritshmëritë e producentëve. Në fakt buxheti i produksionit kishte vlerë 120 milion dollarë. Gjithë kjo nuk ishte garanci se paratë e investuara do të kthehen. Këtë e dëshmuuan edhe llogaritë e arkave të kinosallave të cilët deklaruan se filmi në SHBA ka fituar 56 milionë dollarë dhe në pjesën tjetër të globit edhe 111 milionë dollarë, që përsëri paraqet humbje prej 35 milion dollarësh krahas 200 milion dollarëve të investuara për të.

Xhoni Dep njihet si aktor që mbush kinosallat, megjithatë ai shpesh di të xhirojë ndonjë film që nuk i realizon pritshmëritë dhe rezultatet financiare. Këtë vit kjo i ndodhi me filmin “Mordekai” që kishte buxhet financiar prej 60 milion dollarësh, por deri tani ka përfituar gjithsej 47 milion dollarë, pra me humbje 13 milion dollarëshe. As edhe pjesëmarrja e Gvinet Palltrou-s, Juan Mek Gregor-it dhe Poll Betani-t nuk ndihmuan që filmi të realizojë pritshmëritë e producentëve.

*Shkëputur nga shkrimi “Humbësit më të mëdhenj në 2015”,  
<http://www.publicitet.mk/filmoljubie/item/1197-najgolemite-gubitnici-vo-2015;>  
zbritur më 3.12.2015*





**(31.1) Cili film filloi të shfaqet nga fundi i muajit mars?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. „Kazbah rok“
- B. „Pan“
- C. „Shigjetari“
- Ç. „Katërshja fantastike“

1 pikë

**(31.2) Njërën nga rolet e filmit “Mordekai” e luan aktorja:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. Zoi Deshanell
- B. Gvinet Palltrou
- C. Kejt Hadson
- Ç. Demi Mur

1 pikë

**(31.3) Humbjet e cilit film mund të përshkruhen si epike?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. „Snajper“
- B. „Pan“
- C. „Star trek“
- Ç. „Room“

1 pikë

**(31.4) Në cilin zhanër bën pjesë filmi “Shigjetari”?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. dramë kriminalistike-akcion
- B. dramë komike
- C. aksion horor
- Ç. dramë-triler

1 pikë

**(31.5) Gjithsej 56 milionë dollarë në llogaritë e arkave të kinosallave të SHBA-së i ka fituar filmi:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. „Brave heart“
- B. „The big short“
- C. „Kazablanka“
- Ç. „Katërshja fantastike“

1 pikë

**(31.6) Cili është aktori kryesor te filmi „Pan“?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. Shon Pen
- B. Hju Xhekmen
- C. Denzell Vashington
- Ç. Robert Deniro

1 pikë

**(31.7) Filmi „Katërshja fantastike“ regjistroi humbje prej:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. 111 milionë dollarësh.
- B. 80 milionë dollarësh.
- C. 56 milionë dollarësh.
- Ç. 35 milionë dollarësh.

1 pikë

**(31.8) Sipas përlllogaritjeve të kujt, komedia “Kazbah rok” fitoi vetëm 2,87 milionë dollarë?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. sipas internet-portalit “Yahoo”
- B. sipas producentëve
- C. sipas arkave të kinemave të ShBA-së
- Ç. sipas revistës „Forbs”

1 pikë

### USHTRIMET PËR KONCENTRIM MË TË MIRË TË FËMIJËVE

Koncentrimi është shkathhtësi kognitive e lindur te secili fëmijë. Çdo ngjarje që rrethon fëmijën ia tërheq vëmendjen dhe kështu angazhohen të gjitha shqisat e tij. Kjo mund të ndodhë qoftë me ndonjë aromë të re, tingull, shije, fotografi të re. Ndërkaq, për koncentrim është e domosdoshme që fëmija në të vërtetë të investojë përpjekjet intelektuale, respektivisht të mendojë. Prandaj, për forcimin e koncentrimit të tij është mirë që çdo ditë të bëjë ushtrime të caktuara intelektuale, siç janë gjëgjëza ose puzzle (përputhëse), ndërtimi i objekteve të ndryshme, ose madje i qyteteve nga kubëzat me madhësi të ndryshme ose të vizatuarit.

Nëse ndonjë stimulans i jashtëm pengon rrjedhën e mendimeve të fëmijës derisa është duke bërë diçka, ai menjëherë do të dekoncentrohet dhe do të dorëzohet. Prandaj, mos e pengoni dhe mos e ndërpritni rrjedhën e tij të mendimeve, derisa është në ndonjë aktivitet intelektual. Pavarësisht a është i vetëm në dhomë apo në grup me fëmijë të tjerë, të vegjël duhet t'i lini që vetë të kryejnë atë që e kanë filluar; sepse ekziston rreziku që humbja e shpejtë e interesimit të manifestohet më vonë përmes vështirësive në mësim.

Por, nëse fëmija nga vegjël mësohet që prindërit ta ndërpresin ose t'i ndihmojnë në atë që bën, ai nga prindërit do ta presë këtë edhe kur të shkojë në shkollë dhe rrallë do të jetë në gjendje t'i kryejë vetë detyrat e shtëpisë ose të mësojë mësimin, madje as që do ta dëgjojë mësimin deri në fund. Sa herë i dëgjojmë prindërit e adoleshentëve duke u ankuar: "Kam përshtypjen që çdo gjë që i them, i hyn në njërin vesh dhe i del nga tjetri!" Që të mos ndodhë kjo, ndihmojeni fëmijën tuaj me kohë për ta përmirësuar koncentrimin.

Shndërroni ushtrimet e shkurtra intelektuale në lojëra që do t'i pëlqejnë. Organizoni gara për të ndërtuar kështjella nga kubet e drunjtë ose me ngjyra, por caktoni afatin për kryerjen e atyre detyrave, dhe gjithsesi, edhe një shpërblim të vogël. Jepni, për shembull kohë që për një orë të zgjidhë tri detyra nga matematika dhe si shpërblim ofrojani 30 minuta vozitje me biçikletë në park.

(koha.net) 28 prill 2012

**(32.1) Çfarë shkathhtësie kognitive është koncentrimi te fëmijët?**

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.2) Çka është e domosdoshme për koncentrimin e fëmijëve?**

1 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.3) Çka duhet të bëjë fëmija për forcimin e koncentrimit?**

1 pikë

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.4) Çka e dekoncentron fëmijën?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.5) Pse duhet t'i lëmë fëmijët që të kryejnë vetë atë që kanë filluar?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.6) Cilët tipa të fëmijëve i presin gjërat të gatshme?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.7) Shkruani citimin me të cilin shpesh ankohen prindërit e adoleshentëve?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.8) Në çka duhet të shndërrohen ushtrimet e shkurtra intelektuale?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.9) Çka duhet t'u caktoni fëmijëve, kur organizoni gara për të ndërtuar kështjella?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.10) Si duhet shpërblyer fëmija nëse për kohë të caktuar i zgjidh tri detyra matematikore?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|





Lined writing area with 20 horizontal lines.



Lined area for text or drawing.

| Gjuhë                  |   |
|------------------------|---|
| 1                      | 2 |
| Kompozicioni i tekstit |   |
| 1                      | 2 |
| Përbajtja              |   |
| 1                      | 2 |



*FAQE E ZBRAZËT*



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2017

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Me kujdes lexo udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test („Shifra e kandidatit“)

**Mos i shfleto faqet** dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Në detyra duhet të përgjigjesh në një nga mënyrat vijuese:

- duke rrethuar shkrojnë para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar;
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, pikë së pari zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me përgjigjen e pyetjeve në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin të përgjigjet. **Shkruaj lexueshëm**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkrojnë të shkrimit**. Përgjigjet e shkruara me laps vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Për pjesën Hartim është paraparë të shkruash një tekst në temë sipas dëshirës tënde. Mbikëqyrësi do të të japë një fletëshesë në të cilën janë të shënuara temat e propozuara dhe udhëzimet e detyrës sipas të cilave duhet të shkruash.

**Të urojmë shumë sukses!**



**KANGA I  
(Fragment)**

Në mes shtegëtisë së kësaj jetë  
u gjeta në një pyll krejt errësi  
se kishe humbë në rrugën e vërtetë

Si ish ta them sa kam vështirësi  
ai i egri pyll, i ashpër, pyll hata,  
sa ta mejtoj më kall frikë përsëri!

veçse ma e idhtë në qoftë vdekja paksa  
Po me tregue ç'të mirë kam gjetë n'atë anë,  
do flas për sende tjera që kam pa.

Si hyna mbrendë as unë s'di me ju thanë  
aq gjumë i fortë qepallat kish randue,  
kur rrugën e vërtetë e pata lanë.

E, ja, gati përpjetën pa filluem,  
më doli një panterë e lehtë, e shpejtë  
që me lëkurë të larme ish mbuluem;

synin mbi mue e mbante ngulun drejtë  
e udhën time aq keq e kishte pre,  
sa qeshë sa herë tue ikë e kthye unë krejt.

ish koha kur agonte dita e re  
e ngrihej Dielli me ata yj në qiell,  
që me te ishin, kur Zotynë mbi dhé

sëpari i lëvizi n'ajr të kthiell;  
guxim e shpresë në shpirt më kish përtritun  
për bishë-larushen, që s'po i gjeja fill,

ai agu i ditës, e ëmblastinë endritun,  
por jo sa frikë aspak t'mos më shkaktonte  
pamja e një luani çfaqë papritun.

Ky dukej se drejt meje po afronte  
me kokën lart, me një uri t'turbueme,  
sa ngjante se dhe ajrin e tmeronte.

Veç një ulkojë që shihej e pushtueme,  
ashtu kockë e lëkurë, nga shumë dëshira,  
që sa njerzinë e bani të mjerueme



Kur unë e pashë me sy n'atë log shkretie,  
brita: "Mëshirë të keshë për mue, aman,  
kush do ti qofsh, njeri i gjallë o hije!"

E ai: "Nuk jam, por qesh njeri taman,  
lombardas prindët pata porsi farë  
e si atdhe të dy qen mantovan.

Linda sub Iulio, ndon se pak ma parë  
jetova n'Romë kur ish Augusti i mirë,  
N'atë kohë hyjnish të rrejshëm, gënjeshtarë.

Poet unë qeshë, këndova t'drejtin bir  
të Ankizit, ardhun Troje, kur u krye  
lufta q. Ilionin dogji pa mëshirë.

Po ti drejt s'keqes pse je tue u kthye,  
pse s'i hyp malit, që i çdo gëzimi  
edhe hareje asht fillim, arsye?"

"Ti qenke ai Virgjili ai burimi,  
që fjala i rrjedh si lum i gjanë? – mejherë  
i gjegja unë i skuqun nga turpnimi.

*"Komedia Hyjnore" FERRI, Dante Aligieri*

(1.1) Nga fragmenti mund të kuptojmë se poeti ndodhet në:

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.2) Cili është bashkudhëtari i Dantes gjatë shtegëtimit të tij në këtë fragment?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.3) Cila periudhë letrare nis me këtë vepër?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.4) Si janë të radhitur mëkatarët nëpër rrathët e ferrit?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.5) Në cilën gjuhë ose variant gjuhësor Dante Aligeri e shkroi veprën “Komedia Hyjnore”?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.6) Nga sa pjesë është e përbërë “Komedia Hyjnore”?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.7) Çfarë ndjenjash shpreh poeti në fillim të fragmentit?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(1.8) Cilat numra janë përdorur në mënyrë simbolike në këtë vepër?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**2** Lexoni me vëmendje fragmentin nga vepra "Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr" nga A. Z. Çajupi dhe përgjigjuni pyetjeve.

**PAMJA E PARË**

**Burrë e grua**

- Tana:** Nëgjo burrë...
- Vangjeli:** Ç'ke moj grua?
- Tana:** rënkon Jam sëmurë.
- Vangjeli:** Që kur? Ç'thua!
- Tana:** Ç'them! Ja them që jam sëmurë... .
- Vangjeli:** Po tani vallë ç'pësove... .
- Tana:** Gjithë ditën ç'keshe bërë?  
Ti për bar e dru s'vete  
Dhe qaej se nukë fletë?  
Tërë ditën ngas qetë,  
Dhe drek' e dark bëj vetë  
Gjithë puna përmbi mua.
- Vangjeli:** Përse të kam marrë grua?  
Gratë për punë po janë.
- Tana:** Edhe burratë të hanë  
Dhe të rrinë nat' e dit! . .
- Vangjeli:** me inat Mos më bëj të të godit,  
Se zakonë s'e harrova,  
Sonte shumë të durova.  
Nga hunda s'më heq dot kurrë,  
Ç'ke që s'pushon duke qarë?  
Nga u ç'të ligë ke parë?  
S'të kam lënë si të tjerë,  
Nuk ika kurr nga fshati.  
E a s'të shkoi inati?  
Ngreu të biem të flemë  
Dhe këto fjalë t'i lemë.
- Tana:** Bjer' e fli, mua s'më fliet.
- Vangjeli:** Nesër posa që të gdhiet,  
Do t'dërgoj djalin me vrap  
Të bjerë jatron prapë.
- Tana:** Cilin jatro?
- Vangjeli:** Adhamutnë.
- Tana:** Se sho dot me sy çifutnë,  
As për mace s'i vë besë!  
S'jam e sëmurë për jatro  
Po të më dëgjosh një fjalë...
- Vangjeli:** Fol, ç'do të më thuash vallë?
- Tana:** Sa qe e ndyera vjerrë,  
Gjeja darkënë përpara.  
Po tani ç'të bëj më parë,  
Në vështë të jem a nd'arë?  
Të të bëj edhe drek' e darkë,  
Tani s'mundem se jam plakë.
- Vangjeli:** Plakë? S'je plakë moj grua,  
Po je ashtu si të dua.
- Tana:** Të të vij keq për mua  
Punët janë të rënda,  
S'punoj jashtë dhe brënda...

**Vangjeli:** Puno sa të duah vetë,  
Arat jepi me të tretë.

**Tana:** Kjo punë s'bënet kurrë,  
Po djali na u bë burrë... .  
Ndaj të lutem ta martojmë  
Erdhi dita të gëzojmë  
Ne pa nuse pse të rrimë?  
Kur të kem nusen ndimë?ëmë me jetë. .  
Punëtë bënenë vetë  
Nukë rojëmë me jetë...  
Pse s'më flet?

**Vangjeli:** Ç'të them moj grua?  
Çuditë me ç'fjalë thua!  
Katërbëdhjetë vjeç djalë  
Do ta martosh?

**Vangjeli:** Ea moj grua nër mënde

**Tana:** Çuditë me kokë tënde

**Vangjeli:** Sado qave ngreu bjerë...

**Tana:** S'je baba si dhe të tjerë! .  
Thuamë, për Perëndinë  
Ps es'do ta martojmë Gjinë?

**Vangjeli:** Ësht' i vogël moj Tanë!

**Tana:** Ç'thua? Pa shukoi shtanë  
Me mua kur u martove,  
Sa vjeç jeshë, mos harrove?  
Tani për djalënë tonë,  
Do të ndërrojmë zakonë?

**Vangjeli:** Mos kërko ç'bënim njëher  
Pa shuko ç'bëjnë të tjerë:  
Shuko bejnë rrënjëdalë,  
Nukë ka edhe ai djalë?  
kur i thashë ta martojë,  
"Le të bëjë si të dojë"

**Tana:** I muarrë mentë gratë  
Të bukur njeri që gjete!  
Ai të kish mënt për vetë,  
Nuk e shkretonte shtëpinë,  
S'kish marrë porropotinë,  
Mendjeprishur, zemërligu  
Le të shoqenë dhe iku.  
E zeza grua seç hoqi  
Njëzet vjet e la i shoqi

**Vangjeli:** Tani le bejnë mënjanë  
Dhe hajde të flemë pranë,

**Tana:** Dhe mua më marrtë lumi!

**Vangjeli:** Pa dhe nesër kuvendojmë





**(2.1) Në fillim të komedisë, Tana i ankohet Vangjelit sikur është e sëmurë, sepse:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. vuante nga ndojë sëmundje
- B. dëshiron ta nxjerrë në pah qëllimin kryesor të saj
- C. ishte e lodhur nga jeta
- Ç. do që Vangjeli t'i ndihmojë në punët e fushës

1 pikë

**(2.2) Pse i është përkeqësuar gjendja Tanës pas vdekjes së vjehrrës?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. sepse ajo e këshillonte
- B. sepse ajo e ndihmonte në punët e fushës
- C. sepse ajo ia bënte drekën dhe darkën
- Ç. sepse ajo e donte shumë

1 pikë

**(2.3) Përmes figurës së Vangjelit del në shesh:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. pozita e një burri punëtor dhe të interesuar për punët e shtëpisë
- B. pozita e një burri që është i brabartë me gruan
- C. pozita e një burri parazit që ushqehet nga munda dhe djersa e gruas
- Ç. pozita e një burri pa profesion

1 pikë

**(2.4) Tana dëshiron ta martojë djalin sepse:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. dëshiron të ketë një krah pune më shumë
- B. ka presion nga djali
- C. dëshiron të krenohet me nusen
- Ç. dëshiron t'i gëzojë fqinjët

1 pikë

**(2.5) Me çfarë argumentesh Vangjeli e refuzon kërkesën e Tanës?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. me shembullin e vet
- B. me shembullin e fshatarëve të tjerë
- C. me shembullin e djalit të beut
- Ç. me bukurinë e nuses

1 pikë

**(2.6) Si e bindi Tana Vangjelin për ta martuar djalin?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. përmes shembujve të djemve të tjerë të fshatit
- B. duke i thënë se djali është bërë vërtet burrë
- C. me kërcënime
- Ç. me mençurinë, shkathtësinë dhe dinakërinë e saj

1 pikë

**ERVEHEJA**  
(fragment)

**I**

Pa digjoni një hiqajet:  
në zemanëra të parë,  
Ne Revza e bën rivajet,  
punëra që kanë ngjarë.

Në vakit ben i Israil,  
si gjau punë e Ervehesë,  
kush ish I urtë dhe akil  
prej hiqajetit të marrë pjesë.

Erveheja qe një grua,  
që s'kish shoqe nd'atë ditë:  
vajzë dhe si u martua,  
posi hëna që bën dritë.

Bukurinë I kish mehshur,  
qe një zënjë fort e ndershurë;  
burrënë e kish bënë mamur,  
edhe huje të bukurë.

Burri saj e kish në nazar,  
që s'e duaj vetëhenë,  
as me tjetrë, bën karar  
grua, veçse Ervehenë.

Erdhi rasti që ish adet,  
Burri i saj do dil gurbet,  
dërgon të vëllajt e i flet,  
gruan t'i li amanet:

**II**

“Ti vëlla bënu mukajet  
mahsus për gruan time,  
që t'i gjendeç në zhdo hizmet,  
të mos i lipset as qime.

Se u, ja, vura tahmin  
të vete n'udh të gjatë,  
dhe tek ti u bëçë emin  
që t'i gjendeç dit'e natë”.

I vëllai ja muar teahud  
punërat e Ervehesë;  
“Kam umidh të bëneç hashnud,  
po hajde e mos të presë.  
Mos ja ki dhe s'këllidinë,  
se u zhdo që t'i lipsetë,  
kam umidh në Perëndinë,  
më mir se të jeç vetë”.  
Gjene s'mund që të bën karar,  
nga zemëra psherëtit,  
tek vëllaj u kthe tekrar,  
rixhanë ja përsëriti.

I bën rixha duke qarë:  
“Amanet të lë shtëpinë!  
erdhi vakti për të ndarë,  
s'mun të mban paraponinë”.

Gjene i vëllaj i thotë:  
“S'lë kusur për Ervehenë”,  
dhe u qas i fshiti lotë:  
“Të heqsh dhe vesvesenë!”

E më nuke mbeti suhbet,  
mblodhi mëndnë, fiqirë,  
dhe u nis e bëri gajret,  
Ervehesë i la tumirë.

I vëllaj më tjetrë anë,  
u kthe të sos amanetnë,  
vuri festen më një anë,  
erdhi e gjet Ervehenë.

“Ervehe, moj jetëgjatë!”  
Me një here brriti e thirri:  
“U i mjeri ditë e natë,  
Që s'të kërrej nga fiqiri.

Sot për sot erdhi sahati,  
Të kujtojç Perëndinë,  
Të mjerit m'u sos murati,  
Që më trete si qirinë!

*Muhamet Çami - Kyçyku*



(3.1) Çfarë përshkruan autori në pjesën e dytë të këtij fragmenti?

1 pikë

---

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.2) Cilat tipare karakteristike e shquajnë Ervehenë?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.3) Erveheja është viktimë e

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.4) Cilën temë e trajton autori në këtë vepër?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.5) Cili është shkaku kryesor që burri i Ervehesë do të shkojë në kurbet?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.6) Nga e merr autori motivin e kësaj poeme?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.7) Me cilin alfabet i ka shkruar veprat e veta Muhamet Çami - Kyçyku?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.8) Cilin lloj të strofës e ka përdorur autori në këtë fragment?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|   |               |
|---|---------------|
| <p><b>4 Për t'u krijuar rima e kryqëzuar, duhet të lidhen:</b><br/> <i>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</i></p> <p>A. vargu i parë me të tretin<br/> B. vargu i parë me të dytin<br/> C. vargu i dytë me të katërtin<br/> Ç. vargu i parë me të katërtin</p>                                     | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>5 Kryevepra e madhe në prozë e realizuar në disa vëllime e titulluar "Komedia njerëzore" e shkruar nga Honore de Ballzak është krijuar në periudhën e:</b><br/> <i>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</i></p> <p>A. realizmit<br/> B. romantizmit<br/> C. klasicizmit<br/> Ç. renesancës</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>6 Parimet e klasicizmit i konceptoi:</b><br/> <i>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</i></p> <p>A. Zh. B. P. Moliere<br/> B. Nikolla Boallo<br/> C. Zhan Rasin<br/> Ç. Migel de Servantes</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>7 Oktava është strofa e krijuar nga:</b><br/> <i>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</i></p> <p>A. pesë vargje<br/> B. gjashtë vargje<br/> C. shtatë vargje<br/> Ç. tetë vargje</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>8 Përcaktimi i këngëve të dashurisë në lirikën popullore mbështetet në:</b><br/> <i>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</i></p> <p>A. kompozicionin e këngës<br/> B. motivin e këngës<br/> C. krijuesin e këngës<br/> Ç. dëgjuesin e këngës</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>9 Në shprehjen: <i>E bukur je si hënë</i> është përdorur figura stilistike, e cila krijohet përmes:</b><br/> <i>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</i></p> <p>A. krahasimit<br/> B. përsëritjes<br/> C. kontrastit<br/> Ç. gradacionit</p>   | <p>1 pikë</p> |

|  |               |
|--|---------------|
| <p><b>10 Emri <u>shteg</u> shumësin e formon:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. me anë të prapashtesave trajtëformuese<br/>B. me anë të ndërrimeve fonetike në temën e emrit<br/>C. me anë të ndërrimeve fonetike dhe me anë të prapashtesave<br/>Ç. duke mos ndryshuar formën</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>11 Në fjalinë <i>Malit s'i bihet me kokë</i>, emri <u>malit</u> është dhënë në rasën:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. emërore<br/>B. dhanore<br/>C. gjinore<br/>Ç. kallëzore</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>12 Në fjalinë: <i>Arat duhet punuar sa më shpejt</i>, folja <u>duhet</u> para foljes punuar është në funksionin e foljes:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. gjysmëndihmëse<br/>B. ndihmëse<br/>C. të zakonshme a të mëvetësishme<br/>Ç. formës së përcjellores</p>           | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>13 Ndajfoljet: <u>mbrëmë</u>, <u>sivjet</u>, <u>dikur</u>, <u>ditë për ditë</u> janë ndajfolje:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. kohe<br/>B. vendi<br/>C. shkaku<br/>Ç. mënyre</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>14 Varianti i saktë i rrokjes së theksuar është:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. kumbulla<br/>B. kumbulla<br/>C. kumbulla<br/>Ç. është fjalë e patheksuar</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>15 Në fjalinë: <i>Bota të jep sa t'i kesh dhënë</i>, fjala <u>bota</u> në sintaksë është:</b><br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. kundrinor<br/>B. kryefjalë<br/>C. kallëzuesor<br/>Ç. rrethanor</p>   | <p>1 pikë</p> |

|  |   |
|--|---|
| <p><b>16</b> Sipas mënyrës së formimit të fjalëve, cila nga fjalët e dhëna është kompozitë:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. atdhe<br/>B. miqësi<br/>C. i pabesë<br/>Ç. përpunim</p>                | <p><b>1 pikë</b></p>  |
| <p><b>17</b> Fjalët: <u>bej</u>, <u>aga</u>, <u>shishane</u>, <u>topuz</u> janë:<br/>(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. internacionalizma<br/>B. neologjizma<br/>C. historizma<br/>Ç. profesionalizma</p> | <p><b>1 pikë</b></p>  |
| <p><b>18</b> Fjalja <i>Ajo ditë mallëngjyese s'harrohet kurrë</i>. sipas kuptimit ose qëllimit të thënies është fjali:</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>19</b> Në cilën mënyrë është folja në fjalinë: <i>Paskan shkuar larg gjërat!</i></p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>20</b> Zanoret jobuzore në gjuhën shqipe janë</p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>21</b> Nga emri <u>qytet</u> formo emër banori, duke ia shtuar prapashtesat përkatëse:</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>22</b> Zëvendëso fjalën <u>apel</u> me fjalë shqipe:</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>23</b> Shkruaje shumësin e fjalës <u>fshat</u> në trajtën e pashquar.</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>24</b> Në fjalinë <i>Vetëm në vendlindje flihet i qetë. <u>rrethanor i vendit</u> është fjala</i></p> <p>_____</p>                                | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>25</b> Çka janë në morfologji fjalët e nënvizuara në fjalinë: <i>Iliri shkruan <u>shpejt</u>, <u>bukur</u> dhe <u>saktë</u>?</i></p> <p>_____</p> | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>26</b> Ktheje në numrin shumës, në trajtën e shquar togfjalëshin <u>kunat i vogël</u></p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>27</b> Shkruaje emrin <u>fletore</u> në rasën dhanore, në trajtën e pashquar</p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>28</b> Folja <u>lexohet</u> është dhënë në diatezën:</p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>29</b> Fjalja: <i>Kush zgjohet herët, kurrë nuk pendohet</i>, është fjali me nënrenditje</p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>30</b> Fjalët e huaja: <u>konak, bahçe, hambar, kurban, xhambaz, kapak, hesap</u> kanë origjinë nga gjuha:</p> <p>_____</p>                       | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |

### TEATRI GRANDIOZ EDHE MË TEJ SHKRUAN HISTORI

Teatri “Bollshoj” e vazhdon historinë e tij të filluar në vitin e largët 1776. Në këto pothuajse dy shekuj e gjysmë, që nga formimi që e bëri knjaz Petar Uruov dhe Mihail Madoks, teatri edhe më tej e ndërton dhe zgjeron historinë artistike. Ndërtesa e sotme është e ndërtuar mbi themelet në të cilat ndodhej që nga viti 1824, ndërsa është ndërtuar menjëherë pas zjarrit të madh që e përfshiu dhe shkatërroi teatrin Petrovski, në vitin 1805. Emri i sotëm i teatrit daton që nga 6 janari i vitit 1825. Prej atëherë e deri më sot teatri pësoi disa rekonstruime (më 1843, 1941, 1975, 2011).

Meremetimi më i ri ka filluar me 1 korrik të vitit 2005. Që teatri të bëhet ai që është sot dhe të arrijë famë botërore, duhej që të përfundonte epoka e Stalinit, meqë derisa ai ishte në pushtet lejoi që të shfaqen vetëm pjesë të autorëve rusë. Pas vdekjes së tij “Bolshoj”u bë botërisht i njohur dhe teatër prestigjioz, ku shfaqjet e tyre i kanë mbajtur filharmonitë më të njohura botërore. Ndërtesa e teatrit sot është destinacion shumë i rëndësishëm turistik i Moskës, ndërsa shfaqjet që jepen në të janë shumë aktuale dhe kushtojnë rreth 200 euro për një biletë. Për premierat e operës, bileta për radhët e para arrin deri më 500 euro.

Një nga gjërat më të bukura të teatrit në fjalë është perdja e artë, e cila u bë simbol i këtij teatri me paraqitjen në vitin 1955, e njëjta është e ndërtuar në bazë të skicave të Teodor Fjodorit dhe të grafikut të njohur Majkëll Petar. Sipërfaqja e përparme e perdes është e dizajnuar si tapiseri dhe e thurur nga materiale natyrore mëndafsh dhe ar.

Skulpturat që gjenden në hyrje të teatrit, siç është “muza e vallëzimit” Terpsihora është e paraqitur me lirë në duart e saja. Në mënyrë të ngjashme është e bërë me madhësi natyrore edhe muza e poezisë lirike Erato. Sa i përket eksterierit, salla e koncerteve me 330 ulëse ndodhet në ambiente të reja të teatrit “Bolshoj”, i lokalizuar në qendrën teatrore të kahmotshme. Këto hapësira, sipas drejtorit të sektorit për lëminë skenike, do të shfrytëzohen për prova dhe shfaqje. Interessant është edhe fakti që nën bazën e teatrit dhe sallën kryesore ka edhe pjesë nëntokësore, ku është e vendosur hapësira e zyrave të teatrit. E gjithë hapësira që e përfshin sipërfaqen skenike është 480 000 metër katror.

Parapëlqehet repertori që bazohet në teatrin muzikor rus të shekullit XIX dhe XX, i pasuar me projekte të reja nga rrjedhat artistike në konceptin e operës dhe të baletit. Këto vepra përbëjnë 70 përqind të repertorit të teatrit. Fondi i artë i kulturës muzikore kombëtare ka të bëjë me prezencën e përhershme të muzikës moderne dhe asaj klasike në repertorin e teatrit, së bashku me krijimet e rifreskuara, por shumë më shpesh edhe me arritjet bashkëkohore. Në këtë kontest, janë prezente edhe operat “Rusllani dhe Ludmilla” nga Glinka, “Mazepa” dhe “Eugjen Onjegini” nga Çajkovski, “Zonja Magbet” nga Shostakoviç (versioni fillestar), si dhe redaktimi autorial i dytë i operës “Boris Godunov”.

*Gazeta ditore “Veçer” e datës 19 janar 2011 <http://vecer.mk/life/>*





**(31.1) Sa meremetime i janë bërë teatrit nga viti 1825 deri më sot?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. tre
- B. katër
- C. pesë
- Ç. gjashtë

1 pikë

**(31.2) Stalini ka lejuar të shfaqen pjesë:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. vetëm nga autorë gjermanë
- B. vetëm nga autorë francezë
- C. vetëm nga autorë rusë
- Ç. vetëm nga autorë anglezë

1 pikë

**(31.3) Teatrin “Bolshoj“ e kanë themeluar?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. Teodor Fjodori dhe grafiku i njohur Majkëll Petar
- B. knjazi Petar Urusovi dhe Mihail Madoksi
- C. knjazi Petar Urusovi dhe grafiku i njohur Majkëll Petar
- Ç. knjazi Petar Urusovi dhe Teodor Fjodori

1 pikë

**(31.4) Çmimi i shfaqjeve të baletit kushton:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. afro 100 euro
- B. afro 200 euro
- C. afro 300 euro
- Ç. afro 400 euro

1 pikë

**(31.5) Në hyrje të teatrit ndodhen:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. skulptura të autorëve më të njohur rusë
- B. perde të arta, simbol i teatrit
- C. skulpturat e themeluesve
- Ç. skulptura të muzave

1 pikë

**(31.6) Çfarë ka ndodhur me teatrin e dikurshëm “Petrovski” në fillim të shekullit XIX:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. u shkatërrua nga zjarri
- B. u shkatërrua nga tërmeti
- C. u shkatërrua nga vërshimi
- Ç. u shkatërrua nga sulme lufte

1 pikë

**(31.7) 70 përqind të repertorit të teatrit përbëjnë vepra të operas dhe baletit nga kultura muzikore kombëtare ruse, siç janë veprat:**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. „Ruslani dhe Ludmilla“ dhe „Zonja Magbet“ nga Çajkovski
- B. „Mazepa“ dhe „Eugjen Onjegini“ nga Çajkovski
- C. „Boris Godunovi“ dhe „Zonja Magbet“ nga Çajkovski
- Ç. „Ruslani dhe Ludmilla“ dhe „Boris Godunovi“ nga Çajkovski

1 pikë

**(31.8) Hapësirat e cilit teatër do të shfrytëzohen për prova dhe shfaqje, sipas drejtorit të sektorit për lëminë skenike?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. të teatrit “Bolshoj”
- B. të teatrit “Pjotër Fomenko”
- C. të teatrit “Marijski”
- Ç. të teatrit “Aleksandrijski”

1 pikë

**(31.9) Çfarë lloj kulturë muzikore është përherë prezente në teatrin “Bolshoj”?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. muzikë moderne dhe klasike
- B. muzikë moderne dhe popullore
- C. muzikë moderne dhe pop-muzikë
- Ç. muzikë rok

1 pikë

**(31.10) Me çfarë materialesh natyrore është thurur dhe dizajnuar sipërfaqja e përparme e perdes së teatrit?**

*(rrethoje shkronjën para përgjigjes së saktë)*

- A. pambuk dhe ar
- B. lesh dhe ar
- C. mëndafsh dhe pambuk
- Ç. mëndafsh dhe ar

1 pikë

### RREZIQET NGA INTELIGJENCA ARTIFICIALE

Në momentin kur Stiven Hoking, Bill Gejts dhe Illon Maks pajtohen rreth një gjëje, vlen që kësaj t'i kushtojmë vëmendje. Që të tre na tërheqin vërejtjen (paralajmërojnë) për rreziqet e mundshme që mund t'i sjellë inteligjenca artificiale ose IA. Fizikani më i shquar botëror, Hoking thotë që zhvillimi i plotë i inteligjencës artificiale (IA) mund të sjellë edhe “fundin e racës njerëzore”. Mask, një nëpunës teknik, që na i solli “Pej pall”, “Teslla” dhe “Spejs iks” e përshkruan inteligjencën artificiale si “kërcënim ekzistencial më i madh yni” dhe thotë se loja me IA është sikur “ta thërrasësh djallin”. Gejts i cili din shumë për teknologjinë, e vendos veten në taborin e të “bregosurve” kur bëhet fjalë për atë që makinat të bëhen tepër inteligjente dhe të munden t'i kontrollojnë njerëzit.

Nga çka frikësohen këta njerëz të mençur? IA në përgjithësi përshkruhet si aftësi e sistemeve kompjuterike që ta karikojnë apo ta imitojnë sjelljen inteligjente të njeriut. Kjo mund të jetë edhe njohje e të folurit, deri te perceptimi vizual, sjellja e vendimeve dhe përkthimi i gjuhëve. Ka shembuj nga “Dip Blu” i cili e mundi shampionin e shahut, Gari Kasparov deri te superkompjuteri “Votson” i cili e tejkaloi lojtarin më të mirë në botë “Xheopardi”.

Komponentë e rëndësishme e IA dhe element parësor në frikën që e shkakton ajo është aftësia e makinave që vetë të ndërmarrin aksione pa ndërhyrjen e njeriut. Kjo mund të ndodhë në formën e riprogramimit vetanak të kompjuterit gjatë ballafaqimit me pengesa ose kufizime. Me fjalë të tjera, kompjuteri të mendojë vetë dhe të ndërmarrë aksione përkatëse.

Në botën teknologjike ekzistojnë edhe njerëz me pikëpamje më optimiste për IA dhe çka mund të sjellë ajo. Kevin Kelli, redaktori themelues i revistës “Vajerd”, nuk e sheh të ardhmen të populluar nga HALL – kompjuteri vrasës i anijes kozmike në vitin 2001 “Odiseja në gjithësi”. Keli sheh një botë më prozaike, e cila më shumë i ngjan një shërbimi web “Amazon” i lirë, shërbim i mençur ky që po ashtu do të jetë i mërzitshëm, thjesht nga arsyeja që do të zhvillohet në prapaskenën e jetëve tona. Ai thotë që IA do të ringjallë gjëra inerte në të njëjtën mënyrë siç ndodhi me energjinë elektrike para më shumë se 100 vjetesh.” Çdo gjë që më parë e elektrifikonim, tani do ta rinjohim.

Ndoshta nuk duhet të jemi kaq të shqetësuar. Ndoshta jemi në pragun e një hapi të rëndësishëm, jo vetëm në lëminë e inteligjencës artificiale dhe internetit si dhe gjërave në zhvillim, por gjithashtu në botëkuptimin tonë për vetëdijen. Nëse mund t'i zgjidhim pyetjet për privatësinë, sigurinë dhe besimin që e paraqet IA, mund të bëjmë një kërcim evolutiv me përmasa historike. Thjesht, është e mundur që vizioni i mrekullueshëm i Teillhard për një lidhje vetanake të konceptit “shtresë e të menduarit” të bëhet ajo që bën rrjeti gjatë gjithë kohës.

*Shkëputje nga shkrimi “Rreziqet nga inteligjenca artificiale” nga Stiven dhe Bakllam të botuara në “Utrinski Vesnik” me datë 2.3.2015 dhe në <http://www.utrinski.mk/default.asp?ItemID=5E6188D6F5B74A43A83DB4388FFFBC3A;>*

(32.1) Çfarë funksioni ka pasur Kevin Kelli në revistën “Vajerd”?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.2) Kush e përshkruan inteligjencën artificiale si “kërcënim ekzistencial më i madh yni”?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.3) Kë e tejkaloi superkompjuteri “Votson”?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.4) Kush në botën teknologjike ka pikëpamje më optimiste për IA (inteligjencën artificiale) dhe çka mund të sjellë ajo?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.5) Cilat koka të mençura tërheqin vërejtje (paralajmërojnë) për rreziqet e mundshme që mund t'i sjellë inteligjenca artificiale?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.6) Aftësia e makinave që vetë të ndërmarrin aksione pa ndërhyrjen e njeriut është \_\_\_\_\_ e IA dhe element parësor në frikën që e shkakton ajo.

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.7) Nëse e shohim IA nga aspekti pozitiv, çka do të ringjallë?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.8) Cila IA e mundi shampionin e shahut Gari Kasparov?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|











*FAQE E ZBRAZËT*





# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Gusht, 2017

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Me kujdes lexo udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test („Shifra e kandidatit“)

**Mos i shfleto faqet** dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Në detyra duhet të përgjigjesh në një nga mënyrat vijuese:

- duke rrethuar shkrojnë para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar;
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, pikë së pari zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me përgjigjen e pyetjeve në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin të përgjigjet. **Shkruaj lexueshëm**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit**. Përgjigjet e shkruara me laps vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Për pjesën Hartim është paraparë të shkruash një tekst në temë sipas dëshirës tënde. Mbikëqyrësi do të të japë një fletëshesë në të cilën janë të shënuara temat e propozuara dhe udhëzimet e detyrës sipas të cilave duhet të shkruash.

**Të urojmë shumë sukses!**



## XHA GORIO - HONORE DE BALZAK

*(Fragment nga momentet e fundit të jetës së Gorios  
kur është në shtratin e vdekjes)*

- Ah, po të isha i pasur, po ta kisha ruajtur pasurinë time e të mos ua kisha dhënë, ato do të ishin këtu, do të më lanin faqet me të puthura! Do të banoja në një pallat, do të kisha dhoma të bukura, shërbëtorë, zjarr për t'u ngrohur dhe ato do të ishin këtu, me lot nëpër faqe, me gjithë burrat dhe fëmijët e tyre. Do t'i kisha të gjitha. Kurse tani s'kam asgjë! Paraja të jep gjithçka, edhe vajzat! Oh! Ku janë paratë e mia? Sikur të kisha thesare për të lënë, ato do të më rrinin te koka, s'do të dinin ç'të më bënin më parë, do t'u dëgjoja zënë, do t'i shikoja.

Ah, biri im i dashur, djali im i vetëm, më mirë që mbeta i braktisur dhe në mjerim! Të paktën, kur e duan fatzinë, ai është i sigurt që e duan me gjithë shpirt. Jo, desha desha të isha i pasur; do t'i kisha parë! Për besë kushedi? Ato të dyja kanë zemër prej guri. Kaq e madhe ishte dashuria ime për to, sa që s'mbetej vend për dashurinë e tyre ndaj meje.

Një at, duhet të jetë gjithmonë i pasur, duhet t'i mbajë në frerë fëmijët e tij, si kuajt e hasdisur. Kurse unë rrija në gjunjë përpara tyre. Fatzezat! Po e kurorëzojnë denjësisht sjelljen që kanë treguar ndaj meje këto dhjetë vjetët e fundit. Nuk e dini ju se si kujdeseshin ato për mua kohët e para të martesës së tyre! (Oh ç'martirizëm mizor!) U dhash të dyjave nga tetëqind mijë franga, s'kishin si të silleshin keq me mua, as ato, as burrat e tyre. Pa t'i shikoje se si më prisnin: "Këtu babush, atje babaçka". Gjithnjë të shtruar do ta gjeja tryezën tek ato. Me një fjalë, haja bashkë me burrat e tyre, që më nderonin shumë. U dukej se unë diç kisha akoma. Pse vallë? Unë s'kisha folur kurrë për tregëtinë time. Një njeri që u jep të bijave nga tetëqind mijë franga ia vlen që të kujdesesh për të. Dhe ato më s'dinin ç'të më bënin, po u bënin nder parave të mia, jo mua.

Ç'botë e qelbur! Ia kam pirë lëngun unë! Më shpinin me karrocë në teatër dhe, kur më pëlqente, rrija në mbrëmjet që bënin. Shkurt, ato se kishin për turp që ishin vajzat e mia. S'jam budalla unë, jo, mos kini merak, të gjitha i kam vënë re. Gjithë plumbat kanë goditur në shenjë dhe më kanë përshkruar zemrën. E shihja fare mirë unë që ma kishin me djallëzi, po qe sëmundje që s'kishte ilaç.

Në tryezën e tyre rrija si mbi gjemba, se ndjeja veten mirë, si në tryezën e pensionit. Unë s'dija të thoja dy fjalë bashkë. Dhe, kur i pyeste dhëndurët e mi ndonjë nga ata zotërinjtë e shoqërisë së lartë: "Kush është ky zotëria?" Ata i përgjigjeshin: "Është babai i florinjve, është i pasur". "Hej, dialli!" Ia bënte ai dhe më vështronte me respektin që iu bënte florinjve. Po dhe në besdiseshin ndonjëherë nga unë, ua shpërbleja dyfish me të mira atë bezdi.

Fundja, kush është i përsosur? (Plagë e kam këtë të shkretë kokë!) Unë heq e vuaj tani gjithë sa mund të vuaj njeriu kur jep shpirt, o i dashur Eugjen, po të gjitha këto s'janë asgjë përpara dëshpërimit që më shkaktoi vështrimi i parë i Anastasisë, ai më dha të kuptoja se kisha thënë një marrëzi që e kishte fyer. Vështrimi i saj më futi në dhe të gjallë. Do të desha t'i mësoja të gjitha, por vetëm një gjë e kuptova mirë: që isha i tepërt në këtë botë. Të nesërmen shkova të ngushëllohesha te Delfina, po ja që dhe atje bëra një marrëzi tjetër dhe m'u zemërua edhe ajo. U bëra si i prishur mendsh. Mbete tetë ditë rresht, duke mos ditur nga t'ia mbaja. S'kisha guxim të veja t'i shikoja, trembesha mos më qortonin. Dhe ja që m'u mbyllën dyert e shtëpive të vajzave të mia. "O perëndi! Po ti e di se ç'të zeza kam hequr, meqë ti ke numëruar thikët që kam marrë në atë kohë që më plaku, që më kërrusi, që më nxiu, që më vrau, që më thinji, pse më bën të vuaj sot? Unë e kam larë mëkatën që i kam dashur tepër. Ato janë shpëguar mirë për dashurinë time, më kanë torturuar si xhelate. Ah, sa budallenj janë etërit! I doja aq shumë sa prap shkova te to, si ai kumarxhiu në bixhoz. Vajzat e mia ishin vesi im; ato ishin padronet e mia, ishin gjithçka për mua!



Të dyjave u duhej ndonjë gjë, ndonjë stoli, shërbyeset e tyre ma thoshin dhe unë ua jepja që të më prisnin mirë! Sidoqoftë, ato më kanë dhënë ndonjë mësim të vogël, më kanë mësuar sesi të sillem në shoqërinë e lartë. Oh, nuk pritën shumë, jo.

Zunë të turpërohen për mua në sytë e të tjerëve. Ja se çdo të thotë t'i rritësh mirë fëmijët. Epo unë s'mund të veja në shkollë në këtë moshë. (Më dhemb, më dhemb shumë, o zot! Mjekët, ku janë mjekët, sikur të ma hapin kokën, nuk do të vuaja kaq shumë). Vajzat, vajzat e mia! Anastasinë, Delfinën. Dua t'i shoh. Dërgoni merrini me policë, me forcë! Drejtësia është me mua, të gjithë me mua janë, natyra, Kodi Civil. Unë protestoj! Atdheu do të shkatërrohet, në qoftë se prindërit do të merren nëpër këmbë. Kjo është e qartë. Boshti rreth të cilit sillet shoqëria, gjithë bota, është atësia; të gjitha do të shemben, nëse fëmijët nuk i duan prindërit e tyre...

|   |  |
|---|--|
| <p><b>(1.1) Cila është tema e këtij fragmenti?</b></p> <p>_____</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |
| <p><b>(1.2) Deri në cilin moment vajzat treguan interesim për babain e tyre?</b></p> <p>_____</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |
| <p><b>(1.3) Në cilin vend (institucion) ndodhin ngjarjet në fragmentin e dhënë?</b></p> <p>_____</p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |
| <p><b>(1.4) Cili ishte shkaku i besnikërisë së Eugjen de Rastinjakut ndaj Xha Gorios deri në momentet e fundit të jetës së tij?</b></p> <p>_____</p> <p>_____</p> | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |
| <p><b>(1.5) Me çfarë pune merrej Xha Gorio gjatë jetës së tij?</b></p> <p>_____</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |
| <p><b>(1.6) Çfarë ka studiuar Eugjen de Rastinjaku?</b></p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |
| <p><b>(1.7) Gabimi kryesor, thelbësor sipas Xha Gorios në raportin e tij me vajzat është, sepse ai nuk ka arritur t'i _____ vajzat e tij.</b></p>                 | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |
| <p><b>(1.8) Cilin drejtim letrar i takon krijimtaria letrare e Balzakut?</b></p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p><input type="text"/> <input type="text"/></p> <p>1 2</p> |

## GJERGJ FISHTA - GJUHA SHQYPE

Porsi kanga e zogut t'verës,  
 qi vallzon n'blerim të prillit;  
 porsi i ambli fladi i erës,  
 qi lmon gjit e drandofillit;  
 porsi vala e bregut t'detit,  
 porsi gjâma e rrfës zhgjetare,  
 porsi ushtima e nji tërmetit,  
 ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare.

Ah! po; â' e ambël fjala e sajë,  
 porsi gjumi m'nji kërthi,  
 porsi drita plot uzdajë,  
 porsi gazi i pamashtri;  
 edhë ndihet tue kumbue;  
 porsi fleta e Kerubinit,  
 ka'i bien qiellvet tue flutru  
 n't'zjarrtat valle t'amëshimit.

Pra, mallkue njai bir Shqypтари,  
 qi këtë gjuhë të Perëndis',  
 trashigim, që na la i Pari,  
 trashigim s'ia len ai fmis;  
 edhe atij iu thaftë, po, goja,  
 që përbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
 qi n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,  
 flet e t'veten e lën mbas dore.

Në gjuhë shqype nanat tona  
 qi prej djepit na kanë thânun,  
 se asht një Zot, qi do ta dona;  
 njatë, qi jetën na ka dhânun;  
 edhe shqyp na thanë se Zoti  
 për shqyptarë Shqypninë e fali,  
 se sa t'enden stina e moti,  
 do ta gzojn kta djalë mbas djali.

Shqyp na vete, po pik' mâ para,  
 n'agim t'jetës kur kemi shkue,  
 tue ndjekë flutra nëpër ara,  
 shqyp mâ s'pari kemi kndue:  
 kemi kndue, po armët besnike,  
 qi flakue kanë n'dorë t'shqyptarëvet,  
 kah kanë dekë kta për dhë të't'Parvet.

Në këtë gjuhë edhe njai Leka,  
 qi'i rruzllim mbretnin s'i a, xûni,  
 në këtë gjuhë edhe Kastriota  
 u pat folë njatyne ushtrive,  
 qi sa t'drisë e diellit rrota,  
 kanë me kënë ndera e trimnive.

Pra, shqyptarë çdo fës qi t'jini,  
 gegë e toskë, malci e qyteta,  
 gjuhën t'uej kurr mos ta lini,  
 mos ta lini sa t'jetë jeta,  
 por për të gjithmonë punoni;  
 pse, sa t'mbani gjuhën t'uej,  
 fisi juej, vendi e zakoni  
 kanë me u mbajtë larg kambës s'huej,

Nper gjuhë shqype bota mbarë  
 ka me ju njohtë se ç'fis ju kini,  
 ka me ju njohtë për shqyptarë;  
 trimi n'za, sikurse jini.  
 Prandaj, pra, n'e doni fisin,  
 mali, bregu edhe Malcija  
 prej njaj goje sod t'brohrisim:  
 Me gjuhë t'veten rnoftë Shqypnia!

|  |                      |
|--|----------------------|
| <p><b>(2.1) Gjergj Fishta në momentin kur e vëren se e përbuzin gjuhën shqipe, ai gjuhën:</b></p> <p>A. E këndon<br/> B. E qan dhe e vajton<br/> C. E himnizon<br/> Ç. E lartëson</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>(2.2) Karakteristikë e stilit të Fishtës është mënyra ekstreme e shfaqjes së ndjeshmërisë:</b></p> <p>A. Bën thirrje mos të harrohet gjuha<br/> B. Lavdëron dhe mallkon<br/> C. Qan dhe qesh<br/> Ç. Përrul dhe e ngre lartë</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>(2.3) Për të nxjerrë në pah cilësitë e gjuhës shqipe, ai e përdor gjuhën popullore ku:</b></p> <p>A. Shqiptohen fjalë të ëmbla me nuanca nga më të bukurat<br/> B. Sharje popullore<br/> C. Mallkime<br/> Ç. Përqeshje</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>(2.4) Autori në këtë poezi shtron stilistikisht tezën se gjuha është:</b></p> <p>A. Shenjë për ta parë kombin<br/> B. Shenjë se prej ku është kombi<br/> C. Shenjë se në cilën familje merr pjesë<br/> Ç. Shenjë e njohjes së kombit</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>(2.5) Në strofën e katërt, Fishta nxjerr në pah fuqinë e shenjtë, Zotin. Qëllimi i tij është:</b></p> <p>A. Të prekë zemrat e besimtarëve që njëkohësisht ta duan Zotin dhe gjuhën<br/> B. Fanatizmin e tij<br/> C. T'i sprovtojë besimtarët<br/> Ç. Bën mëkat kur thotë ashtu</p> | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>(2.6) Në strofën e pestë dhe të gjashtë del në pah:</b></p> <p>A. Bukuria e gjuhës shqipe<br/> B. Lashtësia e gjuhës shqipe<br/> C. Prejardhja e gjuhës shqipe<br/> Ç. Hipotezat për gjuhën shqipe</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |



### VDEKJA E MALËSORIT

Asnjë kokë përkulur  
Se ja rrëxoni lisat

Asnjë gjëmë mësa guri  
Se ja shembni majet  
Asnjë lot asnjë  
Se ja shteroni krojet

Në sytë e tij vetëm  
Harroi prendimin dita  
Ç'mendimi i vrugët  
Ç'mendimi i ftohtë ndër vetulla

Lum ky çfarë vdekje.

*Azem Shkreli - "Vdekja e malësorit"*

(3.1) Për çka bëhet fjalë në këtë poezi?

---

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.2) Cili moment i jetës së malëorit përshkruhet?

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.3) Përmes cilave tipare u shqua malëtori derisa ishte gjallë?

---

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.4) Pse përcjellja e malëorit bëhet pa gjëmë dhe pa vaje?

---

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.5) Cili varg përcakton gjithë rrjedhën e krijimit të poezisë?

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.6) Çfarë domethënie ka vargu i fundit?

---

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.7) Çfarë vargu ka përdorur poeti në këtë poezi?

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.8) Cilës periudhë letrare i takon Azem Shkreli?

---

---

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|   |               |
|---|---------------|
| <p><b>4</b> Krijimtaria e shkurtër epike në prozë, është:</p> <p>A. roman<br/>B. tregim<br/>C. ep<br/>Ç. poemë</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>5</b> Në shprehjen „Gëzim i hidhur”, kemi figurën stilistike:</p> <p>A. oksimoron<br/>B. metaforë<br/>C. personifikim<br/>Ç. metonimi</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>6</b> Me fjalinë “<i>Na ishte njëherë një burrë me të shoqen e tij shumë të varfër...</i>” fillon:</p> <p>A. fjala e urtë<br/>B. gjëegjëza<br/>C. përralla<br/>Ç. kënga popullore</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>7</b> Cili nga këto lloje epike, shkruhet në vargje:</p> <p>A. epi (epopeja)<br/>B. romani<br/>C. novela<br/>Ç. ditari</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>8</b> Veprat e Zhan Baptis Molierit i takojnë llojit të:</p> <p>A. romanit<br/>B. dramës<br/>C. tregimit<br/>Ç. poemës</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>9</b> Sipas mitologjisë greke, njeriu i parë që fluturoi është:</p> <p>A. Dedali<br/>B. Ikari<br/>C. Kentauri<br/>Ç. Svinga</p>   | <p>1 pikë</p> |

**10** Mbiemri ka kategorinë e shkallës. Mbiemri në gjuhën shqipe ka tri shkallë:

- A. nyjore, pohore, krahasore
- B. pohore, sipërore, kallëzore
- C. pohore, gjinore, kallëzore
- Ç. pohore, sipërore, krahasore

1 pikë

**11** Përemrat vijues “imi, ime, yti, i tij, juaj, e tyre” janë:

- A. Përemra lidhorë
- B. Përemra pronorë
- C. Përemra të pacaktuar
- Ç. Përemra vetorë

1 pikë

**12** Ndajfoljet e vendit i gjejmë me pyetjet?

- A. Kur?, Prej kur?, Deri kur?
- B. Si?, N'çmënyrë?
- C. Ku?, Kah?, Prej nga?
- Ç. Si?, Pse?, Përse?

1 pikë

**13** Mënyrat e pashtjelluara të foljes janë:

- A. Pjesorja, paskajorja, përcjellorja
- B. Diftongjet, pjesorja e përcjellorja, mohorja
- C. Pohorja, krahasorja, sipërorja
- Ç. Numërori, emri, përemri

1 pikë

**14** Fjalët: as...as, edhe...edhe, jo vetëm...por edhe - janë lidhëza:

- A. Përqasore-kundërshtore
- B. Veçuese
- C. Këpujore
- Ç. Përmbyllëse

1 pikë

**15** Varianti i saktë i rrokjes së theksuar është:

- A. këmishë
- B. këmishé
- C. është fjalë e patheksuar
- Ç. këmishë

1 pikë

**16** Cila nga fjalët është shkruar drejt:

- A. shëpalos
- B. çpalos
- C. shpalos
- Ç. ç'palos

1 pikë

**17** Fjala mbivlerësoj është formuar:

- A. me prejardhje
- B. me paranyjëzim
- C. me kompozim
- Ç. me përngjitje

1 pikë

**18** Lako togfjalëshin moti i nxehtë në trajtën e shquar njëjës, në rasën kallëzore.

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**19** Zgjedho foljen dal në kohën e tashme të mënyrës lidhore, në vetën e parë njëjës:

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**20** Shkruaje fjalën me kuptim të kundërt të fjalës thur:

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**21** Fjalët dhe shprehjet e reja që sapo kanë filluar të përdoren në një gjuhë quhen:

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**22** Shkruaje foljen vallëzoj në kohën e ardhme në vetën e parë njëjës.

\_\_\_\_\_

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|   |   |
|---|---|
| <p><b>23</b> Sipas pjesëmarrjes së zërit dhe të zhurmës, bashkëtingëlloret: [p], [t], [th], [k], [s], [sh], janë bashkëtingëllore të</p> <p>_____</p> | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>24</b> Mbiemrin <i>i keq</i> shkruaje në shumës?</p> <p>_____</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>25</b> Frazologjizmin <i>la mbathi me të katra</i> zëvendësoje me një fjalë të vetme:</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>26</b> Shkruaje trajtën e shkurtër të përemrit vetor <i>unë</i> në numrin shumës, në rasën kallëzore.</p> <p>_____</p>                          | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>27</b> Në fjalinë: <i>Nënë Tereza është nobelistja e parë shqiptare</i>, fjala <i>nënë</i> në sintaksë është:</p> <p>_____</p>                  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>28</b> Si bën folja <i>blej</i> në vetën e dytë shumës, koha e tashme, mënyra dëshirore?</p> <p>_____</p>                                       | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>29</b> Fjalja: <i>Rrofshi e qofshi, o djem!</i> sipas kuptimit është fjali:</p> <p>_____</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>30</b> Si quhen në morfologji fjalët që shprehin një tipar të një frymori a të një sendi?</p> <p>_____</p>                                      | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |

## BIOENERGJIA

Fjala bioenergji rrjedh nga fjalët greke: bios - jetë dhe energji - punë, veprim. Bioenergja i është e njohur njerëzimit që nga lashtësia dhe është përdorur atëherë, e përdoret edhe sot, për shërimin e shumë sëmundjeve ose lehtësimin e dhembjeve të sëmurët, me anë të furnizimit natyror me energji, pa ndihmën e medikamenteve dhe aparateve, por duke transferuar energjinë tonë personale, me anë të duarve, mbi trupin e të sëmurit, pa e prekur atë.

Edhe Jungu, në teorinë e tij të “Vetëdijes kolektive dhe të simboleve të arketipave”, thotë se njeriu është qenie psikoenergjetike dhe se shëndeti i tij varet shumë nga ajo se si energjia qarkullon nëpër trupin e tij, madje, çfarë ndien, mendon, dëshiron etj.

Siç thamë më lart, bioenergja i është e njohur njerëzimit që nga kohët më të hershme. Indianët e njohin këtë energji qysh para 5000 vjetësh dhe e quajnë “prana”. Këtë energji universale ata e konsiderojnë burim të jetës. Me anë të ushtrimeve të Jogës, ata manipulojnë edhe sot me këtë energji, nëpërmjet teknikës së frymimit, meditimit dhe ushtrimeve fizike, për ta mbajtur organizmin në gjendje të kthjellët, të qetë dhe të shëndoshë.

Edhe kinezët e njohin këtë energji dhe e quajtën Ch’i. Sipas filozofisë së tyre, e gjithë materia e gjallë apo edhe ajo që konsiderohet e “vdekur”, është e përbërë dhe e përshkruar nga kjo energji. Energjia Ch’i përmban dy pole të forcës, Jin dhe Jang. Kur Jin dhe Jang janë në baraspeshë, sistemi i gjallë (organizmi) është i shëndoshë, ndërsa kur midis tyre sundon disharmonia (jobaraspesha), si rezultat i sajë kemi gjendje të sëmurë.

“Kabala” - teoria mistike e hebrenjve, që ka filluar të paraqitet rreth 450 vjet para Krishtit, bënë fjalë për këtë energji si dritë e shndritshme, dritë astrale. Krishterimi portretonte figurën e Isait dhe figurat tjera të larta shpirtërore të rrethuara me dritë të lehtë e të shndritshme (aureolë) mbi kokë. Shumë mësimë ezoterike, si tekste të vjetra hinduse, teozofistët, tibetasit, budistët e Indisë, zen - budistët e Japonisë, Zonja Blavocki, Rudolf Shtajner e shumë personalitete tjera, që janë marrë me çështje shpirtërore, flasin dhe e përshkruajnë këtë energji.

Në fillim të shekullit XII, Buraku dhe Liberi kanë vërejtur se qeniet njerëzore kanë energji, e cila mund të provokojë ngacime edhe në largësi. Ata kanë cekur se një person, me vetëdëshirë, mund të provokojë efekte pozitive ose negative tek personi tjetër, pa prekje fizike. Edhe Paracelsusi, në Mesjetë, këtë energji e ka quajtur “Ilaster” dhe thoshte se ilasteri është i përbërë nga forca e jetës dhe materies.

Dukurinë e “Energjisë universale”, në vitin 1800, e vëren edhe Mesmeri, i cili në bazë të kësaj energjie e krijoi “mesmerizmin”. Më vonë, Mesmeri këtë energji e përshkruan si hipnotizëm. Wilhem von Rajhenbahu kaloi 30 vjet duke eksperimentuar në lëminë, të cilin e quajti “forcë tërheqëse”. Ai zbuloi se forca në trupin e njeriut prodhon polaritet të njëjtë me atë që gjendet në kristale. Në bazë të këtij eksperimenti, Rajhenbahu e përshkruan anën e majtë të trupit si po, negativ, ndërsa të djathtën si pol pozitiv. Ky sistem është pothuajse i njëjtë me sistemin kinez: Jin dhe Jang.

Në vitin 1919, dr. Wiliam Killner bëri publike kërkimet e veta rreth energjisë njerëzore, për të cilën thotë se e ka parë nëpërmjet ekraneve të ngjyrosura dhe filtrave. Ai shkruan se ka parë tri shtresa në formë të mjegullës rreth trupit të njeriut. Këtë mbështjellës ai e quan “aura”. Killner zbuloi gjithashtu se paraqitja e aurës tek njerëzit është e ndryshme, varësisht nga mosha, vetitë mentale - emocionale dhe gjendja e tyre shëndetësore. Në bazë të kësaj, Killner zbuloi sistemin e diagnostifikimit në bazë të ngjyrave, përmbajtjes dhe dukjes në përgjithësi të mbështjellësit të trupit, pra aurës.

*burimi: <http://www.sa-kra.ch/bioenergja.htm>*

(31.1) Fjala **bioenergji** rrjedh nga:

- A. Greqishtja
- B. Persishtja
- C. Latinishtja
- Ç. Sanskritishtja

1 pikë

(31.2) Bioenergja shëron semundjet apo lehtëson dhimbjet me anë të:

- A. Medikamenteve
- B. Terapisë fizikale
- C. Furnizimit natyror me energji
- Ç. Aparaturës së posaçme

1 pikë

(31.3) Sipas Jungut dhe teorisë së tij, shëndeti i njeriut varet nga:

- A. Mënyra e të ushqyerit
- B. Marrja e terapisë
- C. Aktiviteti fizik
- Ç. Qarkullimi i energjisë në trupin e tij

1 pikë

(31.4) Si e konsiderojnë indianët bioenergjinë?

- A. Si mënyra e vetme e mjekimit
- B. Si burim të jetës
- C. Si shpëtim të jetës
- Ç. Si terapi më e vjetër

1 pikë

(31.5) Kinezët bioenergjinë e quajtën:

- A. Prana
- B. Kabala
- C. Ch'i
- Ç. llaster

1 pikë





(31.6) Si e përshkruan Mesmeri bioenergjinë?

- A. Si shëndet për trupin
- B. Si hipnotizëm
- C. Si forcë tërheqëse
- Ç. Si forcë shkatërruese

1 pikë

(31.7) 30 vjet eksperimentim në lëmin e quajtur forcë tërheqëse bëri:

- A. Killneri
- B. Mesmeri
- C. Wilhem von Rajhenbahu
- Ç. Buraku dhe Liberi

1 pikë

(31.8) Mbështjellësin e përbërë përj disa shtresave në trupin e njeriut, Wiliam Killneri e quajti:

- A. Aura
- B. Aureolë
- C. Mesmerizëm
- Ç. Dritë astrale

1 pikë

(31.9) Kur Paracelzusi tregon se bioenergjia është e përbërë nga forca e jetës dhe materies?

- A. Në antikë
- B. Në shekullin njëzetën
- C. Në shekullin tetëmbëdhjetë
- D. Në mesjetë

1 pikë

(31.10) Sa shtresa në formë të mjegullës përreth njerut ka parë Wiliam Killneri?

- A. Një
- B. Dy
- C. Tre
- D. Katër

1 pikë

## A MUND TË NDODHË TRANSFERIMI I MENDJES?

Është interesante ta përfytyrosh trurin si një kompjuter biologjik, me indet në rolin e harduerit dhe veprimtarinë elektrike të trurit në rolin e softuerit.

Nëse do të ishte kështu, transferimi i mendjes mund të ishte diçka e arritshme nga ana teknike, së paku derisa të krijohen sistemet e avancuara të elektrodave për të arritur diçka të tillë.

Por sipas ekspertëve vetë shkëputja e mendjes nga lënda është diçka e paarritshme.

"Vetja është në gjithë strukturën," - thotë Charles Higginsi, neurolog dhe inxhinier elektrik i Universitetit të Arizonës. "Është në ndërlidhjen e 100 miliardë neuroneve dhe në formën e veçantë të përçuesve dhe të receptorëve nervorë."

Edhe nëse kirurgët do të mund të transplantonin me sukses trurin, do t'ju duhej të transplantonin dhe shtyllën kurrizore, përndryshe do të rrezikonin memorien e deriatëhershme muskulore të personit.

Një zgjidhje ndaj këtij problemi, vijon më tej Higginsi, do të ishte klonimi. Një klon me sistem qendror strukturalisht identik, mbase do të kishte mundësi të stimulohej me sinjale elektrike që sillen si origjinali.

Por vetë klonimi i njeriut ka mbetur në fantashkencë për momentin, pasi neurologët kanë regjistruar deri më tani vetëm lidhjet e njëkohshme të rreth 100 000 neuroneve - që do të përkonin në total me madhësinë e trurit të peshkut.

Ajo që mund të arrijnë shkencëtarët sot është thjesht të riprogramojnë trurin aty ku ndodhet.

Në Universitetin "Columbia" neurologët kanë implantuar stimulues në thellësi të trurit te njerëzit me depresion që nuk mund të trajtohet ende sipas metodave konvencionale.

Me dërgimin e impulseve elektrike në zona të caktuara, simptomat e pacientëve janë zhdukur në mënyrë të menjëhershme. Pas dy vitesh, personave që u janë implantuar stimulues kanë raportuar se u është zhdukur tërësisht depresioni.

Në këtë vijë shkencëtarët mund të hasin dhe në mundësi të tjera që më parë nuk mendoheshin se mund të arriheshin.

"Mund të ndodhë që të zbulojmë rastësisht se ndërsa përpiqemi të ndalojmë krizën epileptike të ndonjë pacienti, të simulohet sakaq një motiv në korteksin pamor për t'i krijuar personit një memorie të caktuar," thotë Higgins.

Për momentin, duket se transferimi i mendjes është ende fantashkencë, por me kalimin e kohës, dhe natyrisht me eksperimentin e mjaftueshëm, njerëzit mund të gjejnë mënyrën të ngarkojnë memorie në tru dhe të mësojnë kështu aftësi të ndryshme të cilat nuk i dinin më parë.

*(Marrë nga "Shekulli")*



(32.1) Si mund të arrihet transferimi i mendjes?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.2) Shkencëtarët thonë që shkëputja e mendjes është:

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.3) Charles Higgins në deklaratën e tij "Është në ndërlidhjen e 100 miliardë neuroneve dhe në formën e veçantë të përçuesve dhe të receptorëve nervorë", e ka fjalën për:

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.4) Sikur të transplatohej me sukses truri, ç'do të nevojitej të bëhej më tej?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.5) Sipas këtij studimi, çka do ta zgjidhte këtë problem pa e rrezikuar memorien e deriatëhershme të personit?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.6) Çka mund të arrijnë shkencëtarët aktualisht me mjetet që posedojnë?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.7) Çka kanë implantuar neurologët e Universitetit "Columbia"?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.8) Çka kanë raportuar pas dy vitesh personat në depresion, pas implantimit të stimuluesve?

1 pikë

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|



Lined writing area consisting of multiple horizontal lines.



Lined writing area consisting of 25 horizontal lines.



Lined area for writing, consisting of multiple horizontal lines.

|                        |   |
|------------------------|---|
| Gjuhë                  |   |
| 1                      | 2 |
| Kompozicioni i tekstit |   |
| 1                      | 2 |
| Përbajtja              |   |
| 1                      | 2 |



*FAQE E ZBRAZËT*



*FAQE E ZBRAZËT*





# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2018

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Me kujdes lexo udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test („Shifra e kandidatit“)

**Mos i shfleto faqet** dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Në detyra duhet të përgjigjesh në një nga mënyrat vijuese:

- duke rrethuar shkrojnë para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar;
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, pikë së pari zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me përgjigjen e pyetjeve në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin te përgjigjet. **Shkruaj lexueshëm**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit**. Përgjigjet e shkruara me laps vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Për pjesën Hartim është paraparë të shkruash një tekst në temë sipas dëshirës tënde. Mbikëqyrësi do të të japë një fletë shtesë në të cilën janë të shënuara temat e propozuara dhe udhëzimet e detyrës sipas të cilave duhet të shkruash.

**Të urojmë shumë sukses!**



*FAQE E ZBRAZËT*



## **Epi i Gilgameshit**

### **Kënga e parë**

Mbret Gilgameshi, trim ngadhjmtar,  
ndërtoi muret rreth e rreth Urukut-  
një tempull t'shenjtë, sikur majë mali,  
që ngrihet përgjyqytetin e ndërtuar  
themelesh t'forta, thua nga çeliku,  
dhe me shtëpi të larta mirë e mbrojtur-  
hyu i qiellit n'at vend banonte.  
Sa fort shkëlqen edhe më shumë shndrit  
pallati i mbretit krejt i zbardhëlluar.  
E treta e Gilgameshit është njeri,  
ndërsa hyjnore dy të tretat i ka...  
Çkado që flet, çkado që ai vendos,  
për qytetarët ligj duhet të jetë...  
Për kënaqësitë e vuajtjet e njeriut  
mbret Gilgameshi kokën nuk e vret...  
S'lëshon pe Gilgameshi dhe s'lejon  
e dashura te i dashuri të shkojë  
as vasha trimit t'ashpër t'i afrohet.  
Deri te hyjt rënkimet u arrijnë,  
te perënditë e plotfuqishme t'qiellit,  
te hyu i Urukut, vend i shenjtë:  
"Mëzatin e fuqishëm ju e krijuat  
e tok me luanin krifëdendur,  
por Gilgameshi, t'cilin prijs e kemi,  
shumë më i fuqishëm është sesa ata."  
Këto ankime i dëgjon Anuji,  
i qiellit hy, dhe thërret Arurunë,  
hyjneshën e formimit të përkryer:  
"O Aruru, që kafshë e njerëz bëre,  
krijo edhe një t'mrekullueshme,  
të jetë e ngjashme, sikur Gilgameshi,  
të jetë e fortë ashtu si edhe ai-  
me Gilgameshin n'dyluftim të dalë-  
atëherë Uruku qetësi do të ketë."  
Si e dëgjoji lutjen Aruruja,  
mendja e saj një qenie krijoi  
sikur e desh Anuji, hyu i qiellit.  
Duart e veta zuri e m'i lau  
e ma gatoi baltën dhe e njomi  
e me pështymën e hyjnisë amtare  
se ç'e formoi trimin, Enkidujin;  
dhe jetë i dha me frymën dhe me gjakun...

Epi i Gilgameshit

(Gjuhë shqipe dhe letërsi, për vitin e parë të gjimnazit të reformuar, Shkup, 2007, f. 261)

|  |   |
|--|---|
| <p><b>(1.1) Epi i Gilgameshit i takon letërsisë</b></p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.2) Gilgameshi ka qeverisur në qytetin</b></p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.3) Fjala e Gilgameshit i cili sundonte me qytetin, për qytetarët ishte</b></p> <p>_____.</p>                | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.4) Sipas fragmentit të dhënë, personazhi i Enkidujit është krijuar që të zbusë vrazhdësinë e _____.</b></p> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.5) Personazhi i Enkidujit është i krijuar prej</b></p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.6) Prej sa këngëve është e përbërë kjo vepër letrare?</b></p> <p>_____.</p>                                 | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.7) Gilgameshi është me prejardhje njerëzore dhe me prejardhje</b></p> <p>_____.</p>                         | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.8) Në pjesën e dytë të veprës letrare, Gilgameshi synon të arrijë</b></p> <p>_____.</p>                     | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |

## 2 Lexoje këngën me vëmendje dhe përgjigju pyetjeve.

### ME JETUE - Ali Podrimja

Erdhe në jetë  
Nuk ka më nevojë për kuje, lutje  
Kryesorja të jetosh  
Këtë gur ta hedhësh më larg se Unë  
Prandaj:  
Bukën ta pjekësh dy herë nën saç  
Ujin ta vlosh deri në shkallën 99  
Derisa të mbetesh ti i vetmi kërthi në ajër  
në kohë në kosmos  
Ti dhe Uji  
Diellin ta shikosh nga hija e plepit  
Dhe ta matësh  
Kur hijen tënde nuk mund ta kapërcesh më  
Qenit ruaju se të kafshon ajo kafshë shtëpiake  
Besnik i madh i Njeriut  
Nga kafshimi i gjarprit mund të shpëtosh  
Macen nxirre nga fjalori yt gjithsesi  
Ajo nuk është symbol i kohës sate as i artit tënd

(Unë gjithmonë ia kam frikën edhe Lules edhe Femrës)

Kur të flasësh fol të dëgjohesh në bjeshkë  
të dëgjohesh në shkretëtirë  
Për të dytën herë mbetesh pa kokë ose kush  
nuk te beson:  
Sa më pak shikoje veten në pasqyrë  
Dhe kurrë mos mendo: I pari  
Ai që ka ekzistuar para teje jam UNË  
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama  
Për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti  
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë  
të natës  
në pikë të vapës  
Asgjë mos rrit asgjë mos krijo me dhunë  
Rast i humbur nuk je edhe pse pylli  
dendësohet  
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar  
në botë  
Dhe si të duash Ti Lumi  
Kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë  
Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë  
e saj e zezë  
Bashkudhëtari im  
Ta provojmë vetveten derisa kemi frymë.

*(Gjuha shqipe dhe letërsia 4, për gjimnazet e reformuara, Albas, 2010, f. 216-218)*

(2.1) Në këtë poezi A. Podrimja duke e parë veten në pozicionin e prindit:

- A. vajton djalin e sëmurë.
- B. mallkon fatin.
- C. ankohet për sëmundjen e djalit.
- Ç. jep këshilla moralizuese dhe etike.

1 pikë

(2.2) Me anë të vargut: "*Ai që ka ekzistuar para teje jam Unë*", A. Podrimja dëshiron të shprehet se:

- A. vdekja bëhet e papërfillshme.
- B. vdekja nuk do ta ndajë nga i biri.
- C. është i bindur se djali nuk do të vdesë.
- Ç. nuk mund t'i shkojë në mend vdekja e fëmijës së vet, pasi kjo është kundër ligjeve të natyrës.

1 pikë

(2.3) Vargjet që ka përdorur A. Podrimja në këtë poezi janë:

- A. vargje të lira.
- B. vargje të thyera.
- C. vargje të bardha.
- Ç. vargje popullore.

1 pikë

(2.4) Cila figurë stilistike është përdorur në vargun: "*Jetën ta jetosh pa e vrarë*".

- A. anafora.
- B. metafora.
- C. antiteza.
- Ç. krahasimi.

1 pikë

(2.5) Si quhet vëllimi poetik nga i cili është shkëputur kjo poezi?

- A. "Lum, lumi".
- B. "Thirrje".
- C. "Shamijat e përshëndetjeve".
- Ç. "Buzëqeshje në kafaz".

1 pikë

(2.6) Ali Podrimja është autor që i përket:

- A. letërsisë bashkëkohore shqiptare.
- B. letërsisë së realizmit shqiptar.
- C. letërsisë së romantizmit shqiptar.
- Ç. letërsisë së vjetër shqiptare.

1 pikë



**"Doktor Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit"**

Në këto e sipër, shtypi i Suedisë nisi të botojë lajme për disa ndryshime që po bëheshin në Shqipëri: Kongresi i Lushnjës dhe ca më vonë kryengritja e Vlorës, u dukën si shenja jete dhe fuqi morale nga ana e popullit shqiptar. Dr. Gjilpëra i vazhdonte me interes zhvillimet. Kish pasur kurdoherë një ndjenjë kurioziteti për Shqipërinë. Patriot, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nuk ish. Mendonte si Sokrati, i cili thosh se nuk ish as athenian as grek, po „qytetar i botës”, mendonte si i urti i kohërave moderne, Gëte, i cili refuzoi të marrë pjesë në lëvizjen patriotike të Gjermanisë kundër Napoleonit, se edhe Gëtja e quante veten një „qytetar të botës” si Sokrati. Bota është atdheu i madh i çdo njeriu të kuptuar. Po nga ana tjetër, si mund të ketë përparim, s’mund të zhvillohet njerëzia, po të mos ndahet puna? Si mund të lulëzojë sheshi i atdheut të përbashkët që është bota, në qoftë se njerëzit nuk grupohen në një mënyrë a në një tjetër, për të lëruar çdo grup një copë të dheut? Dhe ku ka grupim më pas natyrës se sa grupimi i njerëzve që flasin një gjuhë dhe kanë rrojtur brez pas brezi bashkë në një qoshe të botës? Sokrati dhe Gëtja ishin qytetarë të botës, jo njëri grek dhe tjetri gjerman; megjithatë, Sokrati nuk shkoi në Suze të Persisë ose Memfisë të Egjiptit, për të dhënë mësimet e tij, po mbeti në Athinë; Gëtja nuk u vendos në Paris a në Romë për të zhvilluar mendimet e tija, po qëndroi në Weimar. Ashtu edhe këta të dy kozmopolitë të lartë kanë pasur njëfarë patriotizmi, po në një kuptim të gjerë, fare të ndryshme nga patriotizma e ngushtë dhe urrejtsë e një Demosteni ose e një Bismarku. Dr. Gjilpëra, në orë të çajit, kur avulli aromatik që ngrihet nga filxhani merr fantazinë e njeriut dhe e shpie në kujtime të largme, ëndërronte shpesh për Shqipërinë. I vinte ndërmend një ambicie e t’eti për të bërë një spital në Shqipëri, ambicie naive prej të padituri zemërbardhë që s’thellonte. Ç’është një spital në një vend si Shqipëria, ku të gjithë janë të sëmurë? Është një shtëpi ku ata më të sëmurët, ata që janë në të vdekur e sipër venë me shpresën patetike, po të marrë, se do të shërohen duke pirë ca ilaçe! Para dhe mundime të hedhura më kot për të shpëtuar njerëz që nuk është e mundur të shpëtojnë, - kurse me ato para dhe me ato mendime mund të organizohej anembanë vendit një luftë sistematike për të stërvitur popullin në parimet themeltare të shëndetit e të rrojtjes dhe për të gatitur një brez të ri prej njerëzish të shëndoshë, të paqme, të shkathët, me trupe të hijshme dhe të forta, ku sëmundja të thyejë dhëmbët e saj, posa të kafshojë dhe trupin mundës ta lejë të pacenuar. Ja, një vepër me të vërtetë e madhe, një vepër aq fisnike, sa vlen të bëhet qëllimi dhe ambicja e një mendonjësi. Kështu fliste me vete Dr. Gjilpëra, kur kërkimet e ditës në Institutin Karolinska merrnin fund dhe u linin vendin ëndrrave. Vepra e pionerit, domethënë e njeriut që çan një udhë të re në çfarëdo shesh përparimi qoftë, i dukej me tërë madhështinë dhe bukurinë poetike të saj. Ah, se ç’ëndërr sikur të përmbledhte një herë tërë forcat e shpirtit të tij, të shkëputej nga rrethi i qytetëruar dhe të vente si apostull i qytetërisë në mes të barbarëve!

*"Doktor Gjilpëra"-Faik Konica*

(3.1) Dr. Gjilpëra dëshiron të kthehet në Shqipëri që të ndihmojë?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.2) Sipas fragmentit të dhënë shohim se dr. Gjilpëra i çmon lart Sokratin dhe Gëten dhe dëshiron t'u ngjajë atyre, sepse mendonte se njeriu i madh mund të bëhet në:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.3) Dr. Gjilpëra simbolizon shëndetin, dijen, kulturën e lirinë, kurse dy kundërshtarët e tij dr. Emërllahu dhe dr. Protagoras Dhalla simbolizojnë:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.4) Te cila shtresë dr. Gjilpëra mbështet shpresat për rindërtimin e shoqërisë shqiptare?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.5) Kush fshihet pas figurës së dr. Gjilpërës?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.6) Porosia që jep Konica në këtë vepër është se Shqipëria duhet të përparojë duke marrë si model:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.7) Si quhet revista më e njohur e F. Konicës?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.8) Faik Konica në historinë e letërsisë shqiptare njihet si themelues ose nismëtar i:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|   |                      |
|---|----------------------|
| <p><b>4 Cila nga veprat e poshtëshënuara NUK është e shkruar në vargje?</b></p> <p>A. „Tartufi“ nga Moliere.<br/> B. „Antigona“ nga Sofokliu.<br/> C. „Eugjen Onjegini“ nga Pushkini.<br/> Ç. „Don Kishoti“ nga Servantesi.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>5 Çka është oktava?</b></p> <p>A. Poezi me tetë strofa.<br/> B. Strofë me tetë vargje.<br/> C. Varg me tetë rrokje.<br/> Ç. Varg me tetë këmbë metrike.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>6 Cili nga autorët në vijim ka krijuar në shekullin XX?</b></p> <p>A. F. M. Dostoevski.<br/> B. Uiliam Shekspir.<br/> C. Semjuel Beketi.<br/> Ç. Xhovani Bokaço.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>7 Me fjalën “shthurje” në kompozicionin e llojeve letrare dramatike nënkuptojmë:</b></p> <p>A. ngjarja fillestare prej ku fillon ballafaqimi dhe prezentimi i personazheve.<br/> B. fundi i ngjarjes dramatike ku zgjidhet problemi.<br/> C. pika kulminante ku bëhet konfrontimi më dramatik.<br/> Ç. zhvillimi i përplasjes dhe komlikimet që pasojnë nga tendosja.</p> | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>8 Cila rrymë letrare paraqitet si reaksion i klasicizmit?</b></p> <p>A. Renesansa.<br/> B. Ekspresionizmi.<br/> C. Realizmi.<br/> Ç. Romantizmi.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>9 Gjatë rrëfimit të kujtimeve dhe përshkrimeve të jetës së vetë autorit krijohet:</b></p> <p>A. Biografia.<br/> B. Autobiografia.<br/> C. Artikulli.<br/> Ç. Fejtoni.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |

|  |               |
|--|---------------|
| <p><b>10</b> Rënia e zanores fundore të pjesëzës <u>të</u> apo të nyjave <u>të</u>, <u>së</u>, kur këto gjenden para trajtave të shkurtra <u>i</u> dhe <u>u</u> quhet:</p> <p>A. metafoi.<br/>B. apofoni.<br/>C. metatezë.<br/>Ç. elizion.</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>11</b> Nëse në vend të fjalës "<u>mik</u>", përdorim fjalën "<u>armik</u>", kjo nënkupton se kemi përdorur:</p> <p>A. sinonim.<br/>B. antonim.<br/>C. homonim.<br/>Ç. përngjitje.</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>12</b> Në fjalinë: "<i>Ajri që rrethon rruzullin tokësor, ka peshë</i>", folja <u>ka</u> është:</p> <p>A. në vetën e parë, numri njëjës.<br/>B. në vetën e dytë, numri njëjës.<br/>C. në vetën e tretë, numri njëjës.<br/>Ç. në vetën e tretë numri shumës.</p>                  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>13</b> Fjala <i>megjithëse</i> është formuar me:</p> <p>A. paranyzim.<br/>B. kompozim.<br/>C. përngjitje.<br/>Ç. prejardhje.</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>14</b> Në fjalinë: "<i>Megjithëse ne nuk e ndiejmë, ai shtyp sipërfaqen e Tokës për shkak të peshës së tij (nën veprimin e gravitetit)</i>". Përemri <u>ai</u> në këtë fjali luan rolin e:</p> <p>A. kryefjalës.<br/>B. përcaktorit.<br/>C. kallëzuesit.<br/>Ç. kundrinorit.</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>15</b> Në fjalinë "<i>Pesha me të cilën ajri shtyp sipërfaqen e Tokës merr emrin shtypje atmosferike</i>" emri e <u>Tokës</u> është:</p> <p>A. në rasën emërore.<br/>B. në rasën gjinore.<br/>C. në rasën dhanore.<br/>Ç. në rasën rrjedhore.</p>                                | <p>1 pikë</p> |

|   |  |   |   |
|---|--|---|---|
| <p><b>16</b> Sipas kuptimit fjalia: "<i>Shtypja që ushtron atmosfera mbi çdo centimetër katror të sipërfaqes së Tokës është rreth 1kg</i>" është:</p> <p>A. fjali dëftore.<br/> B. fjali pyetëse.<br/> C. fjali thirrmore.<br/> Ç. fjali nxitëse.</p> | <p><b>1 pikë</b></p>   |   |   |
| <p><b>17</b> Në fjalën <i>ajri</i>, i-ja luan funksionin e:</p> <p>A. prapashtesës.<br/> B. mbaresës.<br/> C. parashtesës.<br/> Ç. rrënjës së fjalës.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p>   |   |   |
| <p><b>18</b> Folja: <u>do të lexoja</u> është në mënyrën:</p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%; height: 30px;">1</td> <td style="width: 50%; height: 30px;">2</td> </tr> </table> | 1 | 2 |
| 1   | 2  |   |   |
| <p><b>19</b> Në fjalinë: <u>Atyre u pëlqejnë së tepërmi ushqimet tradicionale</u>, pjesa e nënvizuar në sintaksë njihet si:</p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%; height: 30px;">1</td> <td style="width: 50%; height: 30px;">2</td> </tr> </table> | 1 | 2 |
| 1   | 2  |   |   |
| <p><b>20</b> Fjalja: <i>E hapa dritaren që të hyjë dielli.</i>- është fjali me pjesë të nënrenditur:</p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%; height: 30px;">1</td> <td style="width: 50%; height: 30px;">2</td> </tr> </table> | 1 | 2 |
| 1   | 2  |   |   |
| <p><b>21</b> Fjalët: <i>i bëj bisht, i bëj ballë, shes mend</i> - janë:</p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%; height: 30px;">1</td> <td style="width: 50%; height: 30px;">2</td> </tr> </table> | 1 | 2 |
| 1   | 2  |   |   |
| <p><b>22</b> Në fjalinë: <i>E mbuluan lotët nga shqetësimi.</i> - pjesa e nënvizuar në sintaksë është:</p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <table border="1" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%; height: 30px;">1</td> <td style="width: 50%; height: 30px;">2</td> </tr> </table> | 1 | 2 |
| 1   | 2  |   |   |

|  |   |
|--|---|
| <p><b>23</b> Në fjalinë: <i>Cilin roman e ke lexuar këto ditë?</i> Fjala <u>cilin</u> në morfologji është:</p> <p>_____.</p> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>24</b> <u>Duke vallëzuar</u> është në formën e pashtjelluar të</p> <p>_____.</p>                                       | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>25</b> Fjalja: <i>Të punojmë sa më shumë</i> - është fjali e thjeshtë</p> <p>_____.</p>                                | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>26</b> Fjalët: <i>bukur, mjaft, dikur, afër, fuqishëm</i> - në morfologji janë:</p> <p>_____.</p>                      | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>27</b> Në cilën rasë është emri <u>Plakut</u> në fjalinë: <i>Plakut dëgjoja fjalën.</i></p> <p>_____.</p>              | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>28</b> Shkruaje mbiemrin <u>i urtë</u> në shkallën krahasore:</p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>29</b> Çfarë lloj lidhëzash janë fjalët: <i>kurse, por, mirëpo, ndërsa?</i></p> <p>_____.</p>                          | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>30</b> Homonimet janë fjalë me përbërje tingullore të</p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |

## 10 SHPIKJET MË TË MËDHA TË NJERËZIMIT

Zbulimet që kanë ndryshuar stilin e jetës së njeriut përgjatë shekujve janë këto:

Letra u zbulua në shekullin e dytë të erë sonë në Kinë. Për herë të parë e përdori Dinastia Han për të ilustruar në letër një hartë gjeografike. Zbulimi i letrës ka ndihmuar zhvillimin e arsimit dhe të shkencës. Falë letrës të shkruarit bëhet proces sa më masovik, ndërsa shumë të vërteta për njeriun janë shkruar nëpër libra.

Busulla magnetike u zbulua gjatë kohës së Dinastisë Han në shekullin e dytë të erës së re në Kinë. Busulla, jo vetëm që mundësoi kënaqjen e kureshtjes së njerëzve, por ndihmoi që njeriu të mësojë për pjesë të ndryshme të globit tokësor dhe të eksplorojë vende të ndryshme të botës. Nuk ka fjalë me të cilat mund të përshkruhet kontributi që kjo pajisje pati për njerëzimin, për udhëtimet e tij dhe për shkencën në përgjithësi.

Shtypshkronja u zbulua nga gjermani, Johannes Gutenberg, në vitin 1439. Mundësia për shtypjen e 3,600 kopjeve në ditë, ishte zbulim epokal që mundësoi shpërndarjen më të lehtë të dijes dhe shkëmbimin e përvojave të njerëzve nga vise të ndryshme të botës, parakusht ky i zhvillimit njerëzor.

Makina me avull u zbulua nga Thomas Newcomen-i në vitin 1712 në Angli, në kohën e fillimit të revolucionit industrial.

Telefoni ishte shpikja e inxhinierit skocez, Aleksandar Graham Bell. Ai u zbulua në vitin 1876 dhe në atë kohë ishte me të vërtetë revolucion i teknologjisë së komunikimit. Telefoni konvertonte zërin e njeriut në sinjale elektrike që përçoheshin në kablllo në distancë të largët.

Fonografi, i njohur ndryshe edhe me emrin gramafon, u zbulua në vitin 1877 nga Thomas Edison-i. Kjo shpikje ka shtuar cilësinë e transmetimit të zërit dhe shërbeu si platformë për avancimin e muzikës dhe produkteve të tjera tingullore.

Llamba elektrike u shpik në vitin 1869 nga Joseph Swan-i, por ajo nuk ishte në gjendje të “ndriçojë” më shumë se disa orë. Llamba u përsos më vonë nga Thomas Edison-i (1869).

Makina e fluturimit u zbulua në shekullin e nëntë nga Abbas Ibn Firnas, por ai ishte me shekuj një eksperiment që nuk gjeti shtrirje në masë. Në vitin 1903 vëllezërit Rajt nga Kalifornia veriore në SHBA e zbuluan versionin e parë të aeroplanit të qëndrueshëm që ishte bazë e zhvillimit të hovshëm të aeronautikës.

Kompjuteri në formën e tij të parë u zbulua në SHBA dhe në Britani të Madhe në vitin 1940. Kompjuteri i parë kishte madhësinë e një dhome modeste dhe kishte nevojë për shumë energji. Kompjuteri i parë, siç mund ta merrni me mend, ishte për nevoja ushtarake. Ndërkaq kompjuteri i parë personal u zbulua nga kompania IBM në vitin 1957.

Interneti apo World Wide Web, siç e njohim sot, u zbulua për nevoja ushtarake në vitin 1990 nga anglezi Tim Berners Lee, por për këtë zbulim ka edhe teori tjera që mohojnë se Lee është shpikësi i tij.

*<https://www.facebook.com/Kurioziteti.Enigma>*

**(31.1) Letra për herë të parë është përdorur për:**

- A. të shkruar libra.
- B. të bërë hartë gjeografike.
- C. të bërë pikturë.
- Ç. regjistrimin e të dhënave.

1 pikë

**(31.2) Kush e ka zbuluar shtypshkronjën e parë?**

- A. Tim Berners Li-u.
- B. Jozef Svan-i.
- C. Johannes Gutenberg-u.
- Ç. Tomas Edison-i.

1 pikë

**(31.3) Në kohë e fillimit të revolucionit industrial u zbulua:**

- A. makina me avull.
- B. aeroplani.
- C. interneti.
- Ç. llamba elektrike.

1 pikë

**(31.4) Aleksandar Graham Bell-i e zbuloi:**

- A. gramofonin e parë.
- B. busullën e parë.
- C. aeroplanin e parë.
- Ç. telefonin e parë.

1 pikë

**(31.5) Fonografi e ka shtuar cilësinë e:**

- A. transmetimit të zërit.
- B. librave të shtypura.
- C. letrës.
- Ç. llambës.

1 pikë





**(31.6) Cili nga zbulimet në vijim shekuj me radhë mbeti vetëm si eksperiment?**

**1 pikë**

- A. telefoni.
- B. fonografi.
- C. aeroplani (makina fluturuese).
- Ç. kompjuteri.

**(31.7) Kompjuteri i parë në fillim u përdor për nevoja:**

**1 pikë**

- A. të mjekësisë.
- B. ushtarake.
- C. shkencore.
- Ç. artistike.

**(31.8) Zbulimi i busullës magnetike i ndihmoi njerëzve ndër shekuj për:**

**1 pikë**

- A. eksplorime të vendeve të ndryshme të botës.
- B. përparimin e muzikës.
- C. shkëmbim të njohurive ndërnjerëzore.
- Ç. konvertim të zërit të njeriut.

## VOJAXHERËT 1 DHE 2, 40 VJET NGA LANSIMI

Në gusht dhe shtator të vitit 2017 mbushen plot 40 vjet nga fillimi i punës së sondave kozmike Vojaxher 1 dhe 2. Këto janë dy objektet kozmike më të largëta të dërguara nga Toka. Vojaxheri 2 është larg pothuajse 16 orë drite. Është në kufi të heliosferës, rajon i definuar në ndikimin e erës diellore dhe fushës magnetike të Diellit. Ambasadori i parë i njerëzimit në Rrugën e Qumështit, Vojaxheri 1 është larg më shumë se 19 orë drite. Ai tashmë qe 5 vjet është jashtë heliosferës, në hapësirën ndëryjore.

Sondat ende janë funksionale dhe komunikojnë. Ato edhe më tej vëzhgojnë dhe dërgojnë të dhëna për kushtet në të cilat ndikimi i Diellit zvogëlohet dhe fillon hapësira ndëryjore. Këto sonda kozmike janë edhe kapsula kohore, sepse mund të ekzistojnë me miliarda vite. Një ditë, mund të jenë gjurma e vetme e qytetërimit njerëzor. Secila sondë bart me vete tinguj, fotografi dhe mesazhe nga Toka.

Vojaxheri 1 është lansuar më 5 shtator të vitit 1977. Ajo është fluturakja e vetme kozmike që ka hyrë në hapësirën ndëryjore. Vojaxheri 2 është lansuar më 20 gusht të vitit 1977. Ajo është fluturakja e vetme kozmike që ka lundruar pranë katër planeteve të jashtme: Jupiterit, Saturnit, Uranit dhe Neptunit.

Vojaxherët kanë zbuluar:

- vullkanët e parë aktivë jashtë Tokës, në satelitin Io të Jupiterit,
- paralajmërim për ekzistencën e oqeanit nëntokësor në satelitin Evropa të Jupiterit;
- atmosferë në Titan, hënë e Saturnit;
- satelit të ngrirë, Miranda në planetin Uran;
- gejzer të ngrirë në Triton, hënë në Neptun.

Vojaxheri 1 tani është larguar më shumë se 20 miliardë kilometra në drejtimin veriperëndimor nga Toka. Të dhënat që ai dërgon tregojnë që rrezet kozmike janë prezente madje katër herë më shumë në hapësirën ndëryjore, sesa pranë Tokës. Kjo do të thotë se heliosfera, hapësirë si baloni, në të cilën gjenden planetet e Sistemit Diellor, si dhe era diellore, veprojnë si mburojë nga rrezatimi kozmik. Vojaxheri 1 përdëfton që fusha ndëryjore lokale gjendet përreth heliosferës.

Vojaxheri 2 tani është larguar më shumë se 17 miliardë kilometra në drejtimin jugor nga Toka. Pritet të hyjë në hapësirën ndëryjore në vitet në vijim. Vendndodhjet e ndryshme të dy Vojaxherëve ua mundësojnë shkencëtarëve krahasimin e dy rajoneve hapësinore në të cilat heliosfera hyn në interaksion me mediumet ndëryjore përreth tyre me ndihmën e instrumenteve të cilat bëjnë matjen e grimcave të elektrizuara, fushave magnetike, radio-valëve me frekuencë të ulët dhe plazmës së erës diellore.

Që të dy Vojaxherët kanë nga tre gjeneratorë radioizotopë termoelektrikë, në të cilët me shkatërrimin e plutoniumit -238 me gjysmë shkatërrim kohor prej 88 vitesh, krijohet energjia e duhur për punë afatgjate. Anijet në mënyrë të pavarur mund të kalojnë në sisteme rezervë kur paraqitet nevoja.

Hapësira në të cilën lëvizin ata është pothuajse boshe, kështu që ata janë në nivel të ulët rreziku nga bombardimi prej objekteve të mëdha. Rrethina ndëryjore e Vojaxherit 1 është e mbushur me re të rralla nga materiali i mbetur nga yjet të cilat kanë shpërthyer si super-nova përpara miliona vitesh. Ky material nuk paraqet rrezik për anijen kozmike, mirëpo Vojaxheri e vëzhgon dhe ua mundëson shkencëtarëve që ta hulumtojnë.



Duke pasur parasysh se fuqia e Vojaxherit po zvogëlohet për nga 4 W në vit, inxhinierët mësojnë se si të drejtojnë fluturaket kozmike me kufizime gjithnjë e më të mëdha të fuqisë. Që të përmbledhim punën e Vojaxherëve, duhet të konsultohen dokumentet që janë shkruar shumë më herët.

<http://astronomija.mk/vojaxher-1-i-2-40-godini-od-lansiranjeto/>

**(32.1) Çfarë të dhënash dërgojnë sondat kozmike Vojaxheri 1 dhe 2?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.2) Në ndikimin e kujt është e definuar hapësira e heliosferës?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.3) Sa gjatë mund të ekzistojnë sondat kozmike?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.4) Sipas sondës kozmike Vojaxher 1, ku ndodhet fusha ndëryjore lokale?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|



(32.5) Nga sa gjeneratorë radioizotopë termoelektrikë kanë të dy Vojaxherët?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.6) Me çka është e mbushur Rrethina ndëryjore e Vojaxherit 1?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.7) Sa orë drite është larg Vojaxheri 2 nga Toka?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.8) Çfarë kanë zbuluar sondat kozmike Vojaxheri 1 dhe 2 në planetin Uran?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.9) Kur është lansuar fluturakja kozmike Vojaxher 2?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.10) Ku janë zbuluar vullkanët e parë aktivë jashtë Tokës?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|











*FAQE E ZBRAZËT*



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Gusht, 2018

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Me kujdes lexo udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test („Shifra e kandidatit“)

**Mos i shfleto faqet** dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Në detyra duhet të përgjigjesh në një nga mënyrat vijuese:

- duke rrethuar shkrojnën para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar;
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, pikë së pari zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me përgjigjen e pyetjeve në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit për plotësim të dhënë në të.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin te përgjigjet. **Shkruaj lexueshëm**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit**. Përgjigjet e shkruara me laps vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me dorëshkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Për pjesën Hartim është paraparë të shkruash një tekst në temë sipas dëshirës tënde. Mbikëqyrësi do të të japë një fletë shtesë në të cilën janë të shënuara temat e propozuara dhe udhëzimet e detyrës sipas të cilave duhet të shkruash.

**Të urojmë shumë sukses!**



*FAQE E ZBRAZËT*



**"Iliada" - Homeri**

**(Fragment) Kënga XXII**

"Medet! ja zotat tani më thërresin  
ndër thonjë të vdekjes, pse me mend kujtoja  
që Deifobi trim krah e ndihmë më bëhet,  
kurse ky u ndodhka n'qytet brenda mureve,  
e mua mashtruar mirë më paska Athina.  
Mortjen e zezë nuk e kam larg, po qaset  
dhe s'kam shpëtim. Shumë kohë me shpirt më deshën  
Zeusi dhe i biri Feb largshigjetuesi  
dhe dikur, besa, gjithnjë zot më dilnin.  
Tash ora e zezë të ma marrë shpirin erdhi.  
Por unë pa luftë e pa lavd nuk vritem,  
dhe do të kryej një punë të denjë kreshnike,  
që brez pas brezi ta kujtojnë njerëzia".  
Si foli ashtu, pallën si arëza e nxori,  
qe e madhe e e rëndë në rrip të mezit varej.  
Kular kukzuar iu vërvit Akilit,  
porsi shqiponja që prej t'eprash maja  
zbret në lëndinë thikë përmes resh të zeza,  
për të rrëmbyer ndonjë lepur t'frikshëm  
a qengj të njomë. Ashtu u turr Hektori,  
duke lëkundur t'mprehtën pallë si arëza.  
Po atij rrëmbyeshëm iu vërvit edhe Akili,  
po zemra i digjej nga tërbimi i egër.  
Gjoksin përpara ia mbulonte shqyti  
mjeshtrisht punuar, dhe valë-valë i dukej  
kaska vetuese katër rrathësh tunxhi  
me katër kreshta ari vezullues,  
që në majë pranë e pranë vendosi Efesti.  
Si ylli i mbramjes që shqëlqen më i bukuri  
në mes të natës ndër yjet e qiellit,  
ashtu vetonte maja e heshtës tunxhi,  
që dora e fortë e Akilit vringëllonte,  
duke shartuar zi për Hektorin divin,  
dhe hulumtonte trupin e tij t'ishëm  
ku mund t'ia hapte plagën vdekjeprurëse.  
Armët e bukura tunxhi, që Priamidi  
ia kishte rrëmbyer kurmit të Patroklit,  
kur përdhunisht këtij ia shkuli shpirtin,  
shtatin vigan ia mbronin përveç grykës,  
ku ndahet qafa me të gjerat shpatulla,  
e ku më i hollë se askund është filli i jetës.  
Mu aty Akili heshtën krejt ia rراسي,  
e n'zverk pas qafe i doli maja e heshtës.  
Arma mizore tejzat ia këputi  
përveç skërfyellit, dhe ende i mbeti  
një fije zëri sa t'i fliste Akilit.  
Gjunjët iu shkrehën dhe u plandos në pluhur.

*(Shtëpia botuese Gjon Buzuku- Prishtinë, 2003, f. 443-444)*

|  |   |
|--|---|
| <p><b>(1.1) Cila periudhë e luftës shumëvjeçare është pasqyruar në fragmentin e dhënë?</b></p> <p>_____.</p>                                   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.2) Sipas fragmentit të dhënë, cilët personazhë janë përfshirë në dyluftim?</b></p> <p>_____.</p>                                      | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.3) Kush bëhet shkak për këtë luftë të gjatë shumëvjeçare?</b></p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.4) Cilin arrijnë ta mbrojnë zotat në këtë dyluftim?</b></p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.5) Cila është pjesa e vetme e trupit të Akilit ku mund të plagoset?</b></p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.6) Me çfarë dinakërie akejët hynë në qytetin e Trojës?</b></p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.7) Çfarë lloj vepre letrare është Iliada?</b></p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.8) Shkruani titullin e veprës letrare të Homerit ku rrëfëhet kthimi në shtëpi i njërit prej heronjve të luftës.</b></p> <p>_____.</p> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">2</div> </div> |

**“BAGËTI E BUJQËSI”**

O malet e Shqipërisë e ju o lisat e gjatë,  
Fushat e gjera me lule, q’u kam ndërmënd dit’ e natë  
Ju bregore bukuroshe e ju lumenjt’ e kulluar  
Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruara!  
Do të këndoj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni?  
O vëndëthit e bekuar, ju mëndjen ma dëfreni.  
.....  
Kur dëgjon zëthin e s’ëmës qysh e le qengji kopen’  
Blegërin dy a tri herë edhe ikën e merr dhen;  
Edhe në i pufshin udhën njëzet a tridhjet vetë  
E ta trëmbin, ay s’kthehet, po shkon në mes si shigjetë  
Ashtu dhe zemra ime më le këtu, tek jam, mua  
Vjen me vrap e me dëshirë aty nër viset e tua.  
Tek buron ujët e ftohtë edhe fryn veriu në verë,  
Tek mbin lulja me gaz shumë dhe me bukuri e m’erë  
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtia,  
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam mënd e mija,  
Atje lind diell’i qeshur edhe hëna e gëzuar,  
Fat’ i bardh’ e mirësia në atë vend janë mbuluar:  
Nat’ atje është tjetër nat’ dhe dita tjetër ditë,  
Në pyje të gjelbëruar atje rrinë perënditë.

*Naim Frashëri*

(2.1) Në fragmentin e dhënë fjala s'ëmës simbolizon:

- A. bagëtinë.
- B. natyrën.
- C. mëmëdheun.
- Ç. kohën.

1 pikë

(2.2) Leksiku që ka përdorur poeti është:

- A. i pasur baritor e fshataresk.
- B. i ngarkuar me arkaizma.
- C. i mbushur me barbarizma.
- Ç. i mbushur me neologjizma.

1 pikë

(2.3) Duke u bazuar në fragmentin e dhënë, vërejmë se Naimi ka përdorur vargun:

- A. gjashtërokësh.
- B. tetërokësh të dyzuar.
- C. njëmbëdhjetërokësh.
- Ç. dymbëdhjetërokësh.

1 pikë

(2.4) Tema e kësaj vepre është:

- A. Trimëria dhe besnikëria.
- B. Mikpritja dhe bujaria.
- C. Bagëtia dhe bujqësia.
- Ç. Lumturia dhe harmonia.

1 pikë

(2.5) Vepra "Bagëti e Bujqësi" është:

- A. Poemë lirike baritore.
- B. Poemë epike.
- C. Roman në vargje.
- Ç. Roman historik.

1 pikë

(2.6) Në tërësinë e veprës "Bagëti e Bujqësi" gjejmë:

- A. Shqetësim poetik.
- B. Meditime filozofike.
- C. Eufori dhe emocione.
- Ç. Mendim erotik.

1 pikë



### **GJERDEKU I VASHËS**

.....  
Çupatë po rrinë syqyt  
s'vështrojnë asnjeri në syt,  
po thonë: „Vallë, kun a mbyt!  
Vallë, ku kemi meqanë?”

.....  
Çupatë po bëjnë fiqir;  
„Vallë, ku e kemi takdir?”  
I martojnë me të pahir,  
Se ymër në dorë s'kanë.

.....  
Djalit kur t'i vijnë nishan,  
e merr, e nxjerr në mejdan,  
zë valle; këng' e bën xhevelan  
zë jorgan e tamburanë

.....  
Si të zihet i ziu djalë,  
në kurbet po rreh të dalë,  
haj me këmbë, haj me kalë,  
rreh të fitonjë paranë.  
Çupa vë gjergjefn' e qëndis,  
kryetë hiç nuk e lëviz,  
po me vetëhe murmuris:  
„S' duhet as të rri pranë”.  
Djali ven e ve terzitë,  
i dërgon i sjellë evgjitë,  
e bën aheng nat, e ditë,  
gjersa të sosën vadanë

.....  
Djali dhëndërë nisetë  
Vesh robotë e stolisetë  
Posi mashkulli ndizetë  
Me krushq e me dambullhanë

*Hasan Zyko Kamberi*

(3.1) Çka përshkruan poeti në fragmentin e dhënë?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.2) Sipas fragmentit, ku duhet të shkojë djali që të mund të martohet?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.3) Sa rrokëshe janë vargjet që ka përdorur poeti në këtë poezi?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.4) Në cilin dialekt është shkruar poezia?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.5) Nga vargjet në vijim nënkuptojmë se vajzat:

“I martojnë me të pahir  
Se ymër në dorë s’kanë”

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.6) Cilin motiv e ka përdorur autori në këtë fragment?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.7) Për çka ankohet autori në këtë poezi?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.8) Cilës periudhë letrare i takon Hasan Zyko Kamberi?

1 pikë

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|   |                      |
|---|----------------------|
| <p><b>4 Sa vargje ka soneti?</b></p> <p>A. dhjetë.<br/> B. dymbëdhjetë.<br/> C. katërbëdhjetë.<br/> Ç. gjashtëmbëdhjetë.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>5 Në cilën periudhë letrare ka krijuar Moliëri?</b></p> <p>A. në renesansë.<br/> B. në barok.<br/> C. në klasicizëm.<br/> Ç. në romantizëm.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>6 <i>Tragjedia dhe komedia</i> bëjnë pjesë në gjininë:</b></p> <p>A. lirike.<br/> B. liriko-epike.<br/> C. epike.<br/> Ç. dramatike.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>7 Cila disiplinë merret me shqyrtimin dhe vlerësimin e veprave letrare?</b></p> <p>A. teoria e letërsisë.<br/> B. historia e letërsisë.<br/> C. kritika letrare.<br/> Ç. semantika.</p> | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>8 Figura stilistike e cila i stërzmadhon gjërat, quhet:</b></p> <p>A. litotë.<br/> B. metaforë.<br/> C. hiperbolë.<br/> Ç. metonimi.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> |
| <p><b>9 Cilës rrymë letrare i takon vepra “Hamleti”:</b></p> <p>A. realizmit.<br/> B. romantizmit.<br/> C. klasicizmit.<br/> Ç. humanizmit dhe renesansës.</p>                                | <p><b>1 pikë</b></p> |

|   |               |
|---|---------------|
| <p><b>10</b> Fjalja: "<i>Bie shi</i>" është:</p> <p>A. fjali e thjeshtë me folje.<br/> B. fjali e thjeshtë pa folje.<br/> C. fjali e përbërë.<br/> Ç. periudhë me bashkërenditje.</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>11</b> Në fjalinë: "<i>Kishte pasur zhgënjime mësuesi i vjetër i historisë me fëmijët e tij</i>". Mbiemri i nënvizuar është në shkallën:</p> <p>A. krahasore.<br/> B. pohore.<br/> C. sipërore.<br/> Ç. krahasore të barazisë.</p>            | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>12</b> Fonetika merret me studimin e?</p> <p>A. tingujve.<br/> B. morfemave.<br/> C. fjalëve.<br/> Ç. fjalive.</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>13</b> Morfologjia dhe sintaksa janë pjesë të:</p> <p>A. letërsisë.<br/> B. fonetikës.<br/> C. gramatikës.<br/> Ç. leksikologjisë.</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>14</b> Në fjalinë: "<i>Kurse lagjja jonë ishte indiferente ndaj këtyre ndërrimeve</i>". Fjala <u>jonë</u> në morfologji njihet si:</p> <p>A. përemër lidhor.<br/> B. përemër dëftor.<br/> C. përemër i pacaktuar.<br/> Ç. përemër pronor.</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>15</b> Antonimi i fjalës <u>shëndoshej</u> është fjala:</p> <p>A. dobësohej.<br/> B. trashej.<br/> C. shtonte peshë.<br/> Ç. shëmtohej.</p>   | <p>1 pikë</p> |

|   |   |
|---|---|
| <p><b>16</b> Fjalët: <i>e, dhe, edhe</i>, janë lidhëza bashkërenditëse:</p> <p>A. kundërshtore.<br/> B. veçuese.<br/> C. përmbyllëse.<br/> Ç. këpujore a shtuese.</p>         | <p><b>1 pikë</b></p>  |
| <p><b>17</b> Vendin e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane e përcaktoi:</p> <p>A. Holger Federsen.<br/> B. Franc Bopi.<br/> C. Hahni.<br/> Ç. Gustav Majeri.</p> | <p><b>1 pikë</b></p>  |
| <p><b>18</b> Në çfarë mënyrë foljore është folja në fjalinë: <i>Sa shumë punuaka!</i></p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>19</b> Në fjalinë: <i>Doktor Aliu punon në ambulancë</i>. Fjala <b><u>doktor</u></b> në sintaksë quhet:</p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>20</b> Shkruaje mbiemrin <b><i>i butë</i></b> në shkallën krahasore.</p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>21</b> Fjalët: <b><i>faqebardhë, zemërgjerë, dorëdhënë</i></b>, sipas mënyrës së fjalëformimit janë</p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |
| <p><b>22</b> Forma e pashtjelluar e paskajores së foljes <b><i>besoj</i></b>, është:</p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <p>1 <input type="text"/> 2 <input type="text"/></p> |

|   |  |
|---|--|
| <p><b>23</b> Pjesa e nënvizuar në fjalinë: <u>M'i</u> dha çelësat që i kërkoja. - në morfologji njihet si:</p> <p>_____.</p>            | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>24</b> Çfarë lloj rrethanori është pjesa e nënvizuar në fjalinë: Sa filloi shiu u shmangëm <b>nën strehë</b>. ?</p> <p>_____.</p> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>25</b> Emri <b>kështjellë</b>, është në trajtën e</p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>26</b> Në fjalinë: <u>Të gjithë janë të vetëdijshëm</u>, kryefjala <u>Të gjithë</u> është shprehur me:</p> <p>_____.</p>          | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>27</b> Shkruaje foljen <b>mendoj</b> në mënyrën dëftore në kohën e kryer të thjeshtë, veta e dytë shumës.</p> <p>_____.</p>       | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>28</b> Sipas llojit të kumtimit, fjalia: <i>Rroftë toka jonë!</i> - është fjali:</p> <p>_____.</p>                                | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>29</b> Cilat janë kryedialektet e gjuhës shqipe?</p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>30</b> Frazologjizmin: <b>E bëri hi e pluhur</b>. - zëvendësojeni me një fjalë tjetër:</p> <p>_____.</p>                          | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |

### **CILAT JANË SHKAQET E NDOTJES SË AJRIT?**

Ka shumë shkaqe për ndotjen e ajrit. Si faktorë kryesorë për ndotjen e ajrit konsiderohen nxemja e shtëpive, lirimi i gazrave nga mjetet motorike dhe industria. Sado që të themi se në vitet e fundit është përhapur përdorimi i gazit për amvisëri, megjithatë akoma qymyri përdoret për nxemje. Nuk mund të mos përmendet edhe ndotja nga lirimi i gazrave të automobilave. Me rritjen e banorëve po rritet edhe numri i mjeteve motorike në trafik që drejtpërdrejt do të thotë ndotje më e madhe e ajrit. Kapacitetet industriale me filtrat joadekuatë do të bëhen shkaktari kryesor i ndotjes së ajrit. Në ditët e sotme konsiderohet që kapacitetet industriale janë ndotësit më të mëdhenj sesa mjetet motorike dhe nxemja në shtëpitë individuale.

Pasojat nga nxemja e shtëpive individuale, lirimi i gazrave nga mjetet motorike dhe industria janë të mëdha dhe të dëmshme për shëndetin e njeriut. Ajri i ndotur është shkaktari kryesor për sëmundjet e mushkërive të bardha të njerëzit. Dyoksidi i sulfurit është i dëmshëm dhe i rrezikshëm jo vetëm për njerëzit, por edhe për mbështjellësin e ozonit dhe botën bimore. Kohëve të fundit është zbuluar një rritje e dyoksidit të karbonit për 5% në ajër. Si rezultat përfundimtar nga ndotja e ajrit është edhe rreziku nga ngrohja globale, gjë e cila duhet të ndezë alarmin të popullata e planetit Tokë. Me rritjen e ndotjes së ajrit, paralelisht rritet edhe ngrohja globale.

Instalimi i filtrave në kapacitetet industriale është pa dyshim puna më e rëndësishme, e cila duhet bërë për mbrojtje nga ndotja e ajrit. Gazifikimi, d.m.th. rritja e përdorimit të gazit për amvisëri, konsiderohet si një masë e mirë për uljen e ndotjes së ajrit. Po ashtu, kohë pas kohe duhet bërë kontrolli dhe pastrimi i pajisjeve të cilat shfrytëzohen gjatë përdorimit të gazit. Si masa të tjera që duhet ndërmarrë janë shfrytëzimi i transportit publik, të pengohet shkatërrimi i zonës së gjelbër në natyrë, të realizohen aktivitete për pyllëzim etj. Duhet të kujdesemi për mjedisin jetësor për në të ardhmen, e jo sot për sot. Në të ardhmen mund të kemi, dhe do të kemi, pasoja serioze, nga ndotja e ajrit që sot nuk janë.

Secili njeri, nga mosha 7 deri 70 vjeçare duhet t'i dijë shkaqet e ndotjes së ajrit, sepse në atë mënyrë do të dijë se cilat masa parandaluese duhet t'i ndërmarrë që të ruhet planeti Tokë. Pa i ditur shkaqet e ndotjes, njerëzit nuk do të jenë të vetëdijshëm për pasojat e dëmshme që për çdo ditë i ndiejnë dhe reflektohen në shëndetin e tyre. Prandaj, secili individ i prekur nga ndotja e ajrit duhet të jetë i informuar dhe i vetëdijshëm në lidhje me pasojat e shumta nga ndotja e ajrit, e cila është e rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe duhet të ndërmarrë hapa në lidhje me parandalimin e saj.

*Burimi: Evodevi.net*

**(31.1) Me rritjen e numrit të banorëve po rritet:**

- A. numri i automjeteve motorike.
- B. numri i fabrikave.
- C. përdorimi i gazit në amvisëri.
- Ç. aktiviteti për pyllëzimin e natyrës.

1 pikë

**(31.2) Ajri i ndotur është shkaktari kryesor për sëmundjet e:**

- A. mushkërive të bardha.
- B. zemrës.
- C. lëkurës.
- Ç. mëlqisë.

1 pikë

**(31.3) Cili komponim kimik është i dëmshëm dhe i rrezikshëm për mbështjellësin e ozonit dhe botën bimore?**

- A. dyoksidi i azotit.
- B. klorur natriumi.
- C. monoksid karboni.
- Ç. dyoksidi i sulfurit.

1 pikë

**(31.4) Cili është shkaku i rritjes së ngrohjes globale?**

- A. ndotja e ajrit.
- B. shkrirja e akullnajave.
- C. rrezatimet ultravjollcë.
- Ç. rritja e sasisë së metanit.

1 pikë

**(31.5) Çfarë duhet të bëhet që të rritet mbrojtja nga ndotja e ajrit?**

- A. të modernizohen makinat industriale.
- B. të instalohen filtra nëpër objekte industriale.
- C. të pyllëzohet ambienti përreth objekteve industriale.
- Ç. të përdoren gazrat përkatëse në industri.

1 pikë





**(31.6) Rritja e përdorimit të gazit për amvisëri, konsiderohet si një masë e mirë për:**

1 pikë

- A. rritjen e ngrohjes globale.
- B. uljen e sëmundjeve të zemrës.
- C. uljen e ndotjes së ajrit.
- Ç. uljen e zhdukjes së gjallesave të rralla.

**(31.7) Kohëve të fundit është zbuluar rritje e:**

1 pikë

- A. oksigjenit për 5%.
- B. dyoksidit të sulfurit për 5%.
- C. dyoksidit të karbonit për 5%.
- Ç. gazit natyror për 5%.

**(31.8) Që të ndërmerren masa parandaluese që të ruhet planeti Tokë, duhet të dihen:**

1 pikë

- A. shkaqet e ndotjes së ajrit.
- B. si të shfrytëzohet transporti publik.
- C. si të pyllëzohen mjediset urbane.
- Ç. si të zhvillohet infrastruktura në mënyrë të drejtë.

**PSE DUHET TË LINI SMARTFONAT MËNJANË DHE TË LEXONI MË SHUMË**

Leximi e mban trurin tuaj të ri në moshë. Zhytja në një libër të mirë mund të heqë shumë vite nga mendja juaj, sipas një studimi të kohëve të fundit nga Qendra Mjekësore e Universitetit Rash, siç raportohet nga “Prevention”. Të rriturit që kalojnë kohën e lirë me aktivitete krijuese ose intelektuale (si leximi) kishin një ritëm më të ngadaltë, prej 32 për qind të rënies së aftësive njohëse në fundin e jetës, se sa ata që nuk e bënin. “Sjelljet e zgjuara e bëjnë trurin më efikas, duke ndryshuar strukturën e tij për të vazhduar funksionimin e duhur, pavarësisht nga neuropatologjitë e lidhura me moshën”, tha Robert S. Uilson, profesor i neuropsikologjisë në Qendrën Mjekësore të Universitetit Rash. Një tjetër studim i kohëve të fundit zbuloi se të rriturit në moshë më të vjetër që lexojnë ose luajnë rregullisht lojëra mendore, si shah apo gjëegjëza, janë dy herë e gjysmë më pak të prirur të zhvillojnë sëmundjen e Alzheimerit.

Leximi largon stresin. Nëse zhyteni në një libër të mirë, ju ulni nivelet e hormoneve të stresit si kortizoli. Në një studim britanik, pjesëmarrësit u angazhuan në një aktivitet që provokonte ankth, dhe më pas ose lexonin për disa minuta, ose dëgjonin muzikë, ose luanin lojëra video. Nivelet e stresit të atyre që lexuan ranë 67 për qind, gjë që ishte një rënie më e madhe sesa ajo e grupeve të tjera.

Edhe në qoftë se keni pasur dekada që s’jeni shqetësuar për provimet, ju ende mund të përdorni libra për të zgjeruar fjalorin tuaj mendor. Në fakt, studiuesit vlerësojnë se ne mësojmë pesë deri në 15 për qind të të gjitha fjalëve që njohim përmes leximit, sipas një raporti skollistik. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët, madhësia e fjalorit të të cilëve është direkt dhe dramatikisht e lidhur me librat që lexojnë.

Kuptojmë më mirë të tjerët. Tregimet që lexojmë ofrojnë perspektivë që ndryshon jetën, thonë studiuesit e Universitetit të Jorkut. Përfshirja në jetën e personazheve forcon aftësinë tuaj për të kuptuar ndjenjat e të tjerëve. Për shembull, duke e parë botën nëpërmjet syve të Jane Eyre, mund ta bëni më të lehtë që të lidheni me pikëpamjen e motrës suaj.

Inkurajon për objektivat që keni në jetë. Leximi për një personazh që kapërcen pengesat mund t’ju motivojë për të përmbushur qëllimet tuaja, sipas një zbulimi nga studiuesit e Universitetit Shtetëror të Ohajos. Nëse dëshironi një ngritje në pagë, ndjekja e një personazhi në zyrën e shefit mund t’ju japë guximin për të bërë të njëjtën kërkesë. Sa më shumë që identifikoheni me një personazh dhe përjetoni ngjarjet sikur po ndodhnin me ju, aq më shumë do të jeni në gjendje për të ndërmarrë veprime.

Ndihmon të ndjeheni më të lidhur. Kur identifikoheni me personazhe në një libër, përjetoni një lloj marrëdhënieje të vërtetë që mund të rrisë ndjenjën tuaj të përfshirjes, thonë psikologët në Universitetin e Bufalos. Me fjalë të tjera, leximi i librit “Marley & Me” mund të rrisë bashkëpunimin me pronarët e qenve në park.

<https://manastirilajm.com/pse-duhet-te-lini-smarfonat-menjane-dhe-te-lexoni-shume-kete-vere/>



**(32.1) Çfarë përfitojnë të rriturit që e kalojnë kohën e lirë me aktivitete krijuese ose intelektuale?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.2) Te cilët persona ekziston mundësia më e vogël që të zhvillohet sëmundja e Alzheimerit?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.3) Nëse zhyteni në një libër të mirë, ju ulni?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.4) Për sa për qind bien nivelet e stresit te personat që lexojnë?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.5) Sa për qind të të gjitha fjalëve që njohim i mësojmë përmes leximit të librave?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.6) Duke e parë botën nëpërmjet syve të Jane Eyre-it, çfarë mund të bëjmë?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|



**(32.7) Sipas një zbulimi nga studiuesit e Universitetit Shtetëror të Ohajos, nëse dëshirojmë një ngritje në pagë, si duhet të veprojmë?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.8) Sipas psikologëve të Universitetit të Bufalos, nëse e identifikoni veten me personazhin e një libri që lexoni, çfarë do të përjetoni ju?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.9) Kush flet për efikasitetin e trurit dhe ndryshimin e strukturës së tij?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.10) Çka mund të rritet duke e lexuar librin "Marley & Me" ?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**33 Zgjidhe vetëm njëren temë dhe:**

**13 pikë**

- Shkruaj një ese që do të përmbajë 350 deri në 500 fjalë; Lexoje titullin e temës dhe mendohu mirë se çka duhet të përmbajë eseja; Respektoji rregullat e kompozicionit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respektoji rregullat dhe normat e gjuhës standarde (letrare);
- Mendimet shprehi qartas dhe në mënyrë të lidhur, përdor argumente, përkatësisht fakte dhe dëshmi; Përdor stil dhe leksik përkatës me llojin e temës që e shkruan; Mos shkruaj tekste pikë për pikë të njëjta si në burimet që ke shfrytëruar (libra shkollorë, libra shkencorë, materiale nga interneti etj.).  
Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

**Tema 1: Raskolnikovi, Merso-ja dhe Jozef K në konflikt me shoqërinë dhe me vetveten**

- Trego rëndësinë e shoqërisë në jetën e njeriut.
- Jep shembuj përmes të cilëve shihet përplasja e protagonistëve me rregullat shoqërore, por edhe konflikti me vetveten.
- Shpjego për pasojat nga përplasjet mes protagonistëve.
- Prezanto qëndrimin tënd për të justifikuar veprimet e protagonistëve.

**Tema 2: Përtacia është shkak më i shpeshtë për mos sukses në jetën e njeriut**

- Sqaro domethënien e përtacisë në jetën e njeriut.
- Përshkruaj se ç'do të thotë për ty përtacia.
- Jep shembuj përmes të cilëve do të prezantosh qëndrimin tënd mbi pohimin se – përtacia është shkak më i shpeshtë për mos sukses në jetën e njeriut.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---



Lined writing area consisting of 30 horizontal lines.





Handwriting practice lines consisting of 26 horizontal lines.

|                        |   |
|------------------------|---|
| Gjuhë                  |   |
| 1                      | 2 |
| Kompozicioni i tekstit |   |
| 1                      | 2 |
| Përmbytja              |   |
| 1                      | 2 |





*FAQE E ZBRAZËT*



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Qershor, 2019

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Lexo me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test (“**Shifra e kandidatit**“)

**Mos i shfleto faqet** dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t’u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkrojnë para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit.** Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

Kopjimi ndalohet rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me shkrim është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës tënde.

**Të urojmë shumë sukses!**



*FAQE E ZBRAZËT*



**1 Lexo me kujdes fragmentin e romanit "Krimi dhe Ndëshkimi" nga autori Fjodor Dostojevski dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.**

Nuk ishte frikaman e as humbameno, përkundrazi, prej disa kohësh endej me nerva të ngritura, të acaruar, nxehej e merrte flakë për hiçmosgjë, dukej si i çartur. Ndërkohë po i pëlqente vetmia dhe i druhej takimit me këdo, jo vetëm me pronaren e shtëpisë. E kishte vënë përfund papasja aq ligisht saqë jeta në atë musëndër nuk po i rëndej më. Kishte hequr dorë nga çdo lloj pune, madje edhe nga ajo që i nevojitet njeriut për të mbijetuar.

"Për çfarë po e përgatis veten dhe ç'gjepurave u druhem! - tha me vete me një buzagaz të çuditshëm." (Uegen 2009:5-6)

\*\*\*

Të përulem jo ty, por vuajtjes njerëzore, - shqiptoi si i prishur mendsh dhe u largua për te dritarja. – Dëgjo këtu! – shtoi kur u kthye pas një minute. – Pak më parë i thashë njërit që më fyti se nuk të vinte ty as te gishti i këmbës... I thash se time motre i bëra nder, kur e ula sot pranë teje.

- Ah! E pse ia thatë! Dhe në prani të saj? – e pyeti e tronditur Sonja, -Të rrike me mua qenka nder?! Po unë jam... e përdalë, jam gjynahqare e madhe, shumë e madhe! Ah! Pse e thatë!

Nuk e pata parasysh as të përdalën e as gjynahqaren, por vuajtjen e pashembullt tënden! Por që je gjynahqare e madhe, kjo kështu është, - shtoi me zë ngadhnyyesi. – Dhe ja ku po ta them: je e tillë, sepse kot së koti e ke vrarë veten, ua ke dorëzuar të tjerëve. Pse a nuk është gjynah kjo që ke bërë? Si të mos të shkojnë mornica kur e sheh se në ç'pisllek rron, sa shumë që e urren jetën që je duke bërë, ndërkohë që je bindur se askend nuk shpëton me këtë që bën! (Uegen 2009:274)

\*\*\*

- Po ja, një ditë prej ditësh e pyeta veten: sikur të ishte gjendur në vendin tim Napoleoni dhe të mos kishte si ta niste karrierën, të mos kishte as Tulonin, as Egjiptin, as Monblanin, por të kishte përpara syve një plakaruqe qyqare e shpirtkazëm, të cilën duhet ta zhdukësh e t'i marrësh paratë që ka në sënduk (kuptohet nisur nga synimi që të mund të nisësh karrierën), a do ta bënte, vallë, në rast se nuk kishte rrugëdalje tjetër? Edhe pse nuk është aspak monumentale dhe është diçka mëkatërore! (Uegen 2009:346-347)

*(Fjodor Dostojevski, "Krimi dhe Ndëshkimi",  
Shtëpia Botuese "UEGEN" Tiranë 2009. Përktheu: Jorgji Doksani)*

|  |  |
|--|--|
| <p><b>(1.1) Përse Raskollnikovi e shmang dhe nuk do të takohet me pronaren?</b></p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.2) Cili personazh e çoi të mendojë Raskollnikovin për krimin e bërë?</b></p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.3) Në çfarë gjendje psikike gjendet Raskollnikovi sipas fragmentit të parë?</b></p> <p>_____.</p>                                     | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.4) Sipas paraqitjes së personazheve, në cilin lloj romani bën pjesë “Krimi dhe ndëshkimi” nga F. M. Dostojevski</b></p> <p>_____.</p> | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.5) Në cilin qytet ndodh ngjarja në romanin “Krimi dhe ndëshkimi”?</b></p> <p>_____.</p>   | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.6) Cilat ishin dëshirat e Raskollnikovit në fund të romanit?</b></p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.7) Në cilin shekull zhvillohet ngjarja në romanin “Krimi dhe ndëshkimi”?</b></p> <p>_____.</p>  | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |
| <p><b>(1.8) Ku e shpjegon Raskollnikovi se është “njeri i veçantë dhe njeri i lindur për vepra të mëdha”?</b></p> <p>_____.</p>                | <p><b>1 pikë</b></p> <div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">1</div> <div style="border: 1px solid black; width: 40px; height: 40px; text-align: center; line-height: 40px;">2</div> </div> |

## 2 Lexo me kujdes poezinë dhe përgjigju pyetjeve.

### Vdekja e Nositit - Lasgush Poradeci

Me zjarr ju flas..., me zjarr.  
Në gjirin tim kam hapur varr...  
Që t'i jap shpresë – edhe t'j-a mar...

Un' ik liqerit zemërak  
Fatlum dh'i pastër si zëmbak  
Po zemra ime kullon gjak;

Se vijnë - urtuar zogjtë - e mi,  
Dh'u jap ushqim me dashuri-  
Një dashuri për llaftari:

Pa nis ah! Gjirin ta godas...  
Dh'e hap ah!- gjirin më një ças...,  
Dh'i nginj ah! zogjtë-e vdes me gas!...

Ahere-helmohet e buçet  
Pas mallit t'im liqer-i i shkret,  
E rit tallazin posi det.

Ay e tund, ay e shkund,  
Ay e hap sa me të mund,  
Gjer mun në gjit, gjer mun në fund.

E shpirtin dyke ma përcjellë,  
Më thotë ah! shih sesa 'shti fellë  
Ky gjir'i em që të pat pjellë. ...

...Me zjarr ju flas, me zjarr.

*Lasgush Poradeci, vepra "Ylli i zemrës",  
Shtëpia Botuese "Rilindja" Prishtinë, 1990, f. 161.*

**(2.1) Poezia "Vdekja e Nositit" është me motiv:**  
(rretho shkronjën para përgjigjes së saktë)

- A. shoqëror.
- B. peizazhist.
- C. filozofik.
- Ç. patriotik.

1 pikë

**(2.2) Kjo poezi simbolizon:**

- A. vetësakrifikimin për të mirën njerëzore.
- B. krijuesin e humbur dhe të flijuar.
- C. ideali jetësor i njeriut.
- Ç. dashurinë e humbur.

1 pikë

**(2.3) Cili nga vargjet e mëposhtme kthehet në lajtmotiv të të gjithë poezisë?**

- A. Pa nis ah! gjirin t'a godas...
- B. Me zjarr ju flas..., me zjarr.
- C. Dh'i nginj ah! zogjtë - e vdes me gas!...
- Ç. Në gjirin tim kam hapur varr.

1 pikë

**(2.4) Tri klithmat "ah" që përsëriten në strofën e katërt tregojnë:**

- A. dëshpërim.
- B. dhimbje.
- C. gëzim.
- Ç. frikë.

1 pikë

**(2.5) Çifti i fjalëve dashuri – Ilaftari tregon:**

- A. daljen nga e tashmja dhe hyrjen në përjetësi.
- B. dhimbjen e largimit nga jeta.
- C. krenari për plagën e vetvetes.
- Ç. lidhjen dramatike të jetës me vdekjen.

1 pikë

**(2.6) Lasgush Poradeci në historinë e letërsisë shqipe është i njohur si:**

- A. dramaturg.
- B. prozator.
- C. liriku më i madh modern shqiptar.
- Ç. tregimtar.

1 pikë



### 3 Lexo me kujdes fragmentin "HISTORIA E SKËNDERBEUT" nga Marin Barleti dhe përgjigju pyetjeve.

Po atë natë që ushtria turke dhe barbare mori arratinë, Skënderbeut, pas pendimit të shenjtë të rrëfimit dhe pas misteresh të tjera kishtare që i bëri me respektin e duhur, vdiq duke ia dorëzuar veten dhe shpirtin Zotit të madh, më 17 janar të vitit 1468 pas Krishtit. Skënderbeu, pra, thuhet se u nda këso jete në moshën 68 vjeç, në vitin e 24 të mbretërimit të tij. Me anë tjetër, Skënderbeu e filloi mbretërimin më 28 nëntor të vitit 1443.

Kur e dëgjoi që po e qanin të vdekur, Lekë Dukagjini, princ epirot, të cilin e kemi përmendur më lart, doli me vrap në mes të pazarit dhe me fytyrë të pikëlluar e me zë të lartë tha, duke shkukur mjekrën e flokët: "Mblidhuni, mblidhuni me vrap të gjithë, o princër e sundimtarë arbërorë. Sot u bënë copë dyert e Epirit dhe të Maqedonisë, sot u përmbysën fronet e pushtetet tona, sot u shua krejt së bashku me këtë njeri çdo shpresë jona".

Gjithashtu, gjatë kohës që ai po vdiste, kali, të cilit i hipte kur kishte për t'u përleshur, u bë shumë i egër, i tërbuar e i pafrenueshëm, saqë s'donte të mbante më asnjeri mbi shpinë dhe pas pak mbaroi.

Skënderbeu u varros në qytetin e Lisosit, në kishën e madhe të Shën Kollit. Ceremonia e varrimit të tij, sipas zakonisht të parëve, u bë me një madhështi të paparë; trupi i tij u përcoll me vaj nga të gjithë ushtarët dhe me pikëllim sipas zakonisht të vendit nga të gjithë princërit dhe kapedanët. Dhe eshtrat e tij, që u vunë në atë vend, pushuan në paqe, gjersa Mehmeti, prijësi i turqve, erdhi në Arbëri dhe në Epir për të sulmuar qytetin e Shkodrës. Për këtë sulm apo fushatë ne kemi shkruar më gjerë dhe më gjatë në një libërzë që e kemi botuar. Gjatë kësaj kohe, turqit dhe barbarët, duke u bërë zotër të qytetit të Lisosit, gjetën dhe nxorën nga varri me dëshirë shumë të madhe trupin e Skënderbeut. Dhe atë që, kur ishte gjallë, ia kishin frikën fort dhe vetëm me t'i dëgjuar emrin merrnin arratinë, tani s'di a sepse ashtu deshi perëndia, dëshironin me të madhe ta shikonin të vdekur dhe pothuajse të tretur, që të mos them se deshën ta nderonin e ta adhuronin. Dhe me të vërtetë, te varri dhe eshtrat e tij u mblodhën që të gjithë e kush e kush më parë, sepse kujtonin se do të ishte fatbardhë dhe shumë i lumtur ai që do të mund t'ia shikonte dhe t'ia prekte, kurse më i lumtur ai që do të siguronte për vete një copë fare do të siguronte për vete një copëzë fare të vogël prej tyre, të cilën e qepnin dhe e zbukuronin një palë me argjend, një palë me ar, dhe e varnin në qafë si ndonjë gjë hyjnore, të shenjtë e vendimtare për fatin e tyre, dhe e nderonin me respekt shumë të madh e me frikë perëndie në zemër, duke kujtuar se të gjithë ata që i mbanin me vete ato thërmija do të kishin në jetë po atë fat e mbarësi që pati nga perënditë e pavdekshme dhe gëzoi, sa qe gjallë, vetë Skënderbeu, i vetmi ndër gjithë njerëzit, me sa mbahet mend.

*\*Historia e Skënderbeut, Marin Barleti, libri i trembëdhjetë*

**(3.1) Marin Barleti njihet si përfaqësues:**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(3.2) Karakteristikë e veçantë e humanizmit shqiptar ishte:**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(3.3) Në cilën gjuhë u shkrua vepra Historia e Skënderbeut:**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(3.4) Në çfarë përmasa përshkruhet Heroi i Barletit?**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(3.5) Çfarë shpreh vaji i Lek Dukagjinit?**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(3.6) Në cilin vend u varros Skënderbeu?**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(3.7) Në vajtmin e Lekë Dukagjinit fjala sot përmendet disa herë.  
Çfarë tregon kjo fjalë?**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(3.8) Ajo që ndodhi me eshtrat e Skënderbeut nga ushtarët turq flet për:**

\_\_\_\_\_

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|  |               |
|--|---------------|
| <p><b>4</b> Cila nga veprat e mëposhtme nuk është ep?<br/>(rretho shkronjën para përgjigjes së saktë)</p> <p>A. „Iliada“.<br/>B. „Odiseja“.<br/>C. „Korbi“.<br/>Ç. „Gilgameshi“.</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>5</b> Cila nga llojet e mëposhtme është këngë lirike, me të cilën përshkohen ndjenjat e thella pikëlluese?</p> <p>A. Sonet.<br/>B. Epitaf.<br/>C. Epigram.<br/>Ç. Elegji.</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>6</b> Cila nga këto drama nuk është tragjedi?</p> <p>A. „Hamleti“ nga Vilijam Shkeshpiri.<br/>B. „Mbreti Edip“ nga Sofokliu.<br/>C. „Duke pritur Godenë“ nga Semjuel Beket.<br/>Ç. „Antigona“ nga Sofokliu.</p>                                | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>7</b> Në romanin “Don Kishoti” nga Miguel de Servantes janë përshkruar përjetimet dhe udhëtimet e personazhit kryesor, Sipas qëllimit të autorit ky lloj romani është:</p> <p>A. historik.<br/>B. social.<br/>C. familjar.<br/>Ç. satirik.</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>8</b> Cilës epokë të letërsisë i takojnë veprat e Dantes, Petrarkës dhe Bokaçios?</p> <p>A. Humanizmit dhe renesancës.<br/>B. Klasicizmit.<br/>C. Romantizmit.<br/>Ç. Realizmit.</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>9</b> Cili lloj publicistik letrar-shkencor bën përshkrimin e asaj çfarë është parë dhe përjetuar në një shtet tjetër?</p> <p>A. Roman.<br/>B. Ese.<br/>C. Tregim.<br/>Ç. Udhëpërshkrim.</p>   | <p>1 pikë</p> |

**10** Nëse greqishtja në kuadër të familjes indoeuropiane përfaqëson një degë më vete, atëherë gjuha shqipe është:

- A. Degë më vete.
- B. Degë e gjuhëve sllave.
- C. Degë e gjuhëve gjermanike.
- Ç. Degë e gjuhëve romane.

1 pikë

**11** Me nyje të përparme dalin emrat në rasën:

- A. Gjinore.
- B. Emërore.
- C. Dhanore.
- Ç. Rrjedhore.

1 pikë

**12** Pjesa e gramatikës që studion rregullsinë e bashkimit të fjalëve në fjali quhet:

- A. Leksikologji.
- B. Fonetikë.
- C. Leksikografi.
- Ç. Sintaksë.

1 pikë

**13** Bartëse e kuptimit leksikor të fjalës është:

- A. Parashtesa.
- B. Prapashtesa.
- C. Mbaresa.
- Ç. Rrënja e fjalës.

1 pikë

**14** Gjymtyra që tregon veprim, gjendje a veti quhet:

- A. Kryefjalë.
- B. Kallëzues.
- C. Kundrinë.
- Ç. Përcaktor.

1 pikë

**15** Fjalja që shpreh vullnetin e folësit, si: urdhër, kërkesë, këshillë, lutje etj., quhet:

- A. Fjali nxitëse.
- B. Fjali thirrmore.
- C. Fjali dëshirore.
- Ç. Fjali urdhërore.

1 pikë

**16** Rrofshi e qofshi o djem! Është:

- A. Fjali nxitëse.
- B. Fjali dëshirore.
- C. Fjali thirrmore.
- Ç. Fjali dëftore.

1 pikë

**17** Pjesa e ndryshueshme e ligjëratës që shpreh cilësinë e emrit quhet:

- A. Folje.
- B. Parafjalë.
- C. Mbiemër.
- Ç. Përemër.

1 pikë

**18** Temën e fjalës e gjejmë?

\_\_\_\_\_.

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**19** Fjalët: lexim, drejtim, gëzim, përpos rrënjës së fjalës janë të shprehura edhe?

\_\_\_\_\_.

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**20** Emrat e gjinisë mashkullore që në trajtë të shquar dalin me – i, i takojnë lakimit?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**21** Si quhen fjalët që përbëhen prej dy a më shumë temash, si në shembujt e dhënë  
at+dhe= atdhe, jetë+gjatë= jetëgjatë:

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**22** Format e ndryshme që merr emri quhen?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**23** Në shembullin: *Shkolla është vendi i dijes*. Fjalë shkollë është?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**24** Fjalët dhe shprehjet e reja që sapo kanë filluar të përdoren në gjuhën letrare quhen?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**25** Fjalët: *yni, çfarë, i cili, tjetra janë?*

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**26** Fjalët që shkruhen njësoj, por kanë kuptime të ndryshme quhen?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**27** Emrat pe, dre, dragua, kua janë emra të gjinisë:

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**28** *Shkolla është më e madhe se çerdhja.* Në fjalinë e shënuar mbiemri është shprehur në shkallën?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**29** Cilat janë dy dialektet kryesore të gjuhës shqipe?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

**30** Në shembullin: *Alpinistët u ngjitën në mal!* Cili lloj i rrethorëve është përdorur në fjali?

1 pikë

\_\_\_\_\_ .

1 2

## 31 Lexo me kujdes tekstin e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe përgjigju pyetjeve.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut - është një deklaratë e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948 në Pallatin Shajo, Paris. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut doli nga përvoja e Luftës së Dytë Botërore dhe përfaqëson përpjekjen e parë globale për të artikuluar mbrojtjen e atyre të drejtave që shumë njerëz besonin se ishin të drejta themelore që i takojnë të gjitha qenieve njerëzore.

Deklarata përbëhet nga 30 nene, të cilët janë përpunuar gjatë viteve në vijim nga traktate ndërkombëtare, instrumente rajonale të të drejtave të njeriut, kushtetutat kombëtare, dhe ligje të tjera.

Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut përbëhet nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike me dy Protokolle fakultative.

Këto dy Konventa, të cilat shtjellojnë më tej të drejtat e njeriut, u miratuan nga Asambleja e Përgjithshme e OKB në vitin 1966. Asambleja e Përgjithshme e OKB miratoi dy pakte të detajuara të cilët e plotësonin Kartën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe në vitin 1976, pasi të dyja Konventat ishin ratifikuar nga një numër i mjaftueshëm shtetesh anëtare, Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut mori fuqinë e ligjit ndërkombëtar.

Kur pas Luftës së Dytë Botërore u bë e qartë se krimet e kryera nga regjimi nazist në Gjermani, brenda bashkësisë ndërkombëtare u arrit një konsensus se Karta e Kombeve të Bashkuara nuk i definonte mjaftueshëm të drejtat e njeriut. Ndaj ishte e nevojshme një Deklaratë Universale që të specifikonte këto të drejta dhe t'i shtjellonte ato që të bëhen të vlefshme dispozitat për të drejtat e njeriut nga kjo Kartë.

Përpilimi i Deklaratës iu besua një Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut në vitin 1946, i cili punoi për dy vjet për hartimin e saj. Komisioni u kryesua nga Eleanor Roosevelt, një avokate e njohur për të drejtat e njeriut, dhe përbëhej nga 18 anëtarë të nacionaliteteve dhe përkatësive politike të ndryshme.

Struktura bazike e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, frymëzuar nga Kodi i Napoleonit, duke përfshirë një Preambulë dhe një hyrje ku shpalosen parimet e përgjithshme të Deklaratës, u prezantua në projektligjin e paraqitur nga francezi René Cassin.

Cassin e krahasoi strukturën e Deklaratës me një godinë, të përbërë nga themele, shkallë, katër shtylla, dhe një çati. Nenet 1 dhe 2 shërbejnë si blloqe themeli, të shtruara me parimet e dinjitetit, lirisë, barazisë dhe vëllazërisë.

Shtatë nenet e Preambulës, në të cilët jepen arsyet për ekzistencën e Deklaratës, janë shtyllat që të çojnë drejt thelbit të Deklaratës, të drejtat e njeriut, të ndarë në katër shtylla. Shtylla e parë (nenet 3-11) paraqet të drejtat e individit, siç janë e drejta për jetën dhe ndalimi i skllavërisë. Shtylla e dytë (nenet 12-17) paraqet të drejtat e individit në shoqërinë civile dhe politike (ku përfshihen gjëra të tilla si liria e lëvizjes). Shtylla e tretë (nenet 18-21) merret me liritë themelore shpirtërore, publike, politike, si liria sindikale, liria e mendimit, ndërgjegjes, dhe fesë. Shtylla e katërt (nenet 22-27) përcakton të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore. Sipas modelit të Cassin, të tre nenet e fundit të Deklaratës përfaqësojnë një çati që mbulon të tërë strukturën. Këto nene kanë të bëjnë me detyrimet e individit ndaj shoqërisë dhe ndalimin e përdorimit të të drejtave në kundërshtim me qëllimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

([https://sq.wikipedia.org/wiki/Deklarata\\_Universale\\_p%C3%ABr\\_t%C3%AB\\_Drejtat\\_e\\_Njeriut](https://sq.wikipedia.org/wiki/Deklarata_Universale_p%C3%ABr_t%C3%AB_Drejtat_e_Njeriut))





**(31.1) Shkurtesa DUDNJ nënkupton:**  
(rretho shkronjën para përgjigjes së saktë)

1 pikë

- A. Deklarata Universale për të Drejtat e Fëmijëve.
- B. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.
- C. Deklarata Universale për të Drejtat e Meshkujve.
- Ç. Deklarata Universale për të Drejtat e Femrave.

**(31.2) DUDNJ lindi si rezultat i:**

1 pikë

- A. Luftës së Dytë Botërore.
- B. Luftës së Parë Botërore.
- C. Luftërave Ballkanike.
- Ç. Luftës Gjermano-Franceze.

**(31.3) Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut përbëhet nga:**

1 pikë

- A. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.
- B. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.
- C. Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike.
- Ç. Nga të tre dokumentet e përmendur.

**(31.4) Çfarë duhej të sillej që të precizoheshin të drejtat e individit?**

1 pikë

- A. Statuti i Kombeve të Bashkuara.
- B. Vendim i Këshillit të Mbrojtjes së Kombeve të Bashkuara.
- C. Deklarata universale.
- Ç. Konventa për të drejtat e njeriut.

**(31.5) Komisionin për hartimin e deklaratës e udhëhoqi:**

1 pikë

- A. Eleanor Roosevelt dhe 14 anëtarë të tjerë.
- B. Eleanor Roosevelt dhe 16 anëtarë të tjerë.
- C. Eleanor Roosevelt dhe 18 anëtarë të tjerë.
- Ç. Eleanor Roosevelt dhe 20 anëtarë të tjerë.



**(31.6) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut përfshin:**

**1 pikë**

- A. Dy Preambula dhe dy hyrje.
- B. Dy Preambula dhe një hyrje.
- C. Një Preambulë dhe dy hyrje.
- Ç. Një Preambulë dhe një hyrje.

**(31.7) E drejta për jetën dhe ndalimi i skllavërisë, janë pjesë e:**

**1 pikë**

- A. Shtyllës së katërt.
- B. Shtyllës së tretë.
- C. Shtyllës së dytë.
- Ç. Shtyllës së parë.

**(31.8) Struktura bazike e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut u prezentua nga:**

**1 pikë**

- A. René Cassin.
- B. Herbert Vere Evat.
- C. Eleanor Ruzvellt.
- Ç. Vinston Çerçil.

### NJË ISHULL I HAVAJEVE U ZHDUK NGA FAQJA E DHEUT

Në Ishullin Lindor, një zone të skajshme ranore të Arkipelagut të Havait, i numëro-heshin ditët. Dita e gjykimit erdhi. Pamjet satelitore të publikuara kësaj jave zbulojnë se ai është “fshirë” nga valët e fuqishme të stuhisë, pas uraganit “Valaka”, një nga uraganet më të stuhishme në Paqësor. Fotografitë e bëra para dhe pas, falë Shërbimit Amerikan për Peshq dhe Botën e Egër, më së miri e pasqyrojnë rrëfimin e tmerrshëm mbi atë që ndoshta i pret edhe ishujt e ngjashëm për shkak të ndryshimeve klimatike.

- Vetëm mendova: “O, Zot, u zhduk” – thekson klimatologu Çip Fleçer nga Universiteti i Havajit.

Ishulli Lindor – së bashku me ishullin e afërm Tern - ishte vend i rëndësishëm për shumimin e fokave të rrezikuara të quajtura „Murgu i Havajit“ dhe vend për shumimin e breshkave të gjelbra të detit që janë të rrezikuara. Vendbanimi i rëndësishëm, i cili tani ekziston vetëm nën dallgë, tanimë nuk mund të ofrojë territor të sigurt dhe të thatë për ato specie të detit. Edhe pse studiuesit ende nuk e kanë vlerësuar shkallën e kanosjes së rrezikut për botën e egër lokale, parashikimet nuk janë të mira. Ishulli Lindor, ishte vetëm një vend i vogël, i gjatë vetëm rreth një kilometër dhe i gjerë 120 metër, megjithatë ishte ishulli i dytë më i madh në atolin më të madh në ishujt veriperëndimor të Havajit dhe pjesë e rajonit të mbrojtur Papahanamokuakea.

Papahanamokuakea ishte shpallur rajon i mbrojtur në vitin dymijë e gjashtë dhe është rajoni i tretë më i madh i tillë në botë.

Në cilin vend tjetër mund të presim që të shohim këtë? Çfarë mund të bëjmë për t'i penguar dukuritë e këtilla? Edhe sa kohë na ka mbetur?

Disa studiues thonë se jemi në fazat fillestare, kurse të tjerë tashmë parashikojnë se zhdukjet e ishujve nuk do të jenë vetëm incidente të izoluara.

*<https://www.fakulteti.mk/neës/25102018/havajski-ostrov-ischezna-od-liceto-na-zemjata>*



**(32.1) Si përshkruhet pozita e Ishullit Lindor në fillim të tekstit?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.2) Në çfarë mënyre është përshkruar zhdukja e ishullit?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.3) Cili shërbim ka publikuar fotot para dhe pas zhdukjes së ishullit?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.4) Për cilat specie detare ishte i rëndësishëm Ishulli Lindor?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.5) Shpjegoni rëndësinë e ishullit për speciet e gjallesat e lartpërmendura.**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.6) Cilat ishin dimensionet e Ishullit Lindor?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|



**(32.7) Tregoni çfarë vendi zë Ishulli Lindor sipas madhësisë në zonën e mbrojtur dhe zonat e mbrojtura anembanë botës?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.8) Çfarë thonë disa studiues rreth dukurive të tilla?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.9) Cili rajon në vitin 2006 është shpallur si rajon i mbrojtur?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.10) Si quhen fokat e rrezikuara?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexoje temën dhe mendo se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respekto rregullat lidhur me kompozicionin e tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respekto rregullat e gjuhës standarde;
- Medimet shprehi qartë dhe në mënyrë të lidhur duke përdorur fakte dhe argumente;
- Përdor leksik dhe stil adekuat në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor tekstualisht dhe pa distancë kritike tekste të gatshme nga burime të ndryshme (libra, libra profesionale, ueb-faqe etj.).  
Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

**Tema 1: A duhet që çdo njeri të ketë të kryer arsimin e lartë?**

- Sa e ndihmon diploma e universitetit njeriun e ri që të ndërtojë karrierë?
- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Sqaro se a duhet (mund) të ndërtohet karrierë vetëm me arsim të lartë?
- Sa ndihmon (shpaguhet) investimi në arsimin universitarë për ndërtimin e karrierës?
- A mund një njeri i ri të ndërtojë karrierë me arsim të mesëm ose zanat?
- Prezanto qëndrimin tënd lidhur me temën e dhënë.
- Trego së paku dy argumente në favor të të menduarit tënd (qëndrimit tënd).
- Argumento mendimet e tua me së paku një shembull (dëshmi) për çdo argument të cekur.  
Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

**Tema 2: Rëndësia e simboleve të statusit në jetën sociale të të rinjve**

Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj për rëndësinë e gjëseneve të cilat simbolikisht e paraqesin statusin social të njeriut (telefoni mobil, makina, rrobat e brenduara etj.) në socializimin e të rinjve.
- Shkruaj, a ndikojnë dhe si, këto gjësene në lidhjen e të rinjve në grupet sociale.
- Shkruaj për pasojat pozitive ose negative nga grupimi i të rinjve në bazë të statusit social.
- Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ato së paku me një shembull.
- Prezanto përvoja dhe qëndrime personale mbi atë se, kanë rëndësi ose jo gjësendet që janë simbol i statusit social.
- Mos shkruaj fraza të përgjithshme! Mos përdor tekstualisht dhe pa distancë kritike tekste të gatshme nga burime të ndryshme (libra, libra profesionale, ueb-faqe etj.)











Blank lined writing area consisting of 20 horizontal lines.

|                        |   |
|------------------------|---|
| Gjuhë                  |   |
| 1                      | 2 |
| Kompozicioni i tekstit |   |
| 1                      | 2 |
| Përbajtja              |   |
| 1                      | 2 |

*FAQE E ZBRAZËT*



*FAQE E ZBRAZËT*

*FAQE E ZBRAZËT*



# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Koha për zgjidhje: 240 minuta

Gusht, 2019

Shifra e vlerësuesit TË PARË

Shkruaj  
këtu:

Shifra e vlerësuesit TË DYTË

NGJITE KËTU

## UDHËZIME PËR KANDIDATIN

Lexo me kujdes udhëzimin! Mos anashkalo asgjë!

Ngjite shifrën në vendin e caktuar në test (“**Shifra e kandidatit**”)

**Mos i shfleto faqet** dhe mos fillo me zgjidhjen e detyrave pa të dhënë leje mbikëqyrësi.

Testi përmban detyra.

Detyrave duhet t’u përgjigjesh në këtë mënyrë:

- duke rrethuar shkrojnë para përgjigjes së saktë;
- duke plotësuar dhe
- duke nënvizuar pjesë në tekstet e dhëna (fjalë, grupe fjalësh, fjali, paragraf).

Detyrat, së pari duhet të zgjidhen në test. Pasi të përfundosh me pyetjet në test, **përgjigjet e detyrave barti në listën e përgjigjeve**, sipas Udhëzimit.

Kujdesu për gjuhën dhe drejtshkrimin në përgjigjet e dhëna. **Shkruaj qartë**. Përgjigjet e palexueshme dhe korrigjimet e paqarta vlerësohen me zero (0) pikë.

**Si në test, ashtu edhe në listën e përgjigjeve, shkruaj vetëm me stilolaps të kaltër dhe me shkronja të shkrimit**. Përgjigjet e shkruara me laps dhe/ose me shkronja të shtypit vlerësohen me zero (0) pikë.

**Mos** e shkruaj emrin dhe mbiemrin tënd në asnjë pjesë të testit, përndryshe përgjigjet do të vlerësohen me zero (0) pikë!

Kopjimi ndalohet rreptësisht. Të gjitha tekstet identike ose të ngjashme, si dhe tekstet e shkruara me shkrime të ndryshme vlerësohen me zero (0) pikë.

Pranë çdo detyre është dhënë numri i pikëve për përgjigjen e saktë.

Në pjesën e të shprehurit me shkrim është paraparë të shkruash një tekst me temë sipas dëshirës sate.

**Të urojmë shumë sukses!**



**1 Lexo me kujdes fragmentin e romanit “Don Kishoti i Mançës” të autorit Miguel de Servantes dhe përgjigju pyetjeve të dhëna.**

**DON KISHOTI I MANÇES**  
(fragment nga libri)

*Kreu I*

Sojliu<sup>1</sup> ynë ishte pesëdhjetë vjeç: ishte i fortë nga shëndeti, i thatë nga trupi, i mprehtë nga fytyra, ngrihej që me natë dhe kishte merak gjahun. Disa duan të thonë se llagapi ishte Qesati po merret me mend se quhej Gjizoti. Po kjo s'ka shumë rëndësi për punën tonë, e përmendim se nuk duam të largohemi asnjë pikë nga e vërteta.

Duhet ditur që sojliu i përmendur më sipër, nuk kishte punë, domethënë tërë motin, e kalonte kohën duke lexuar libra kalorësie me aq zell e qejf, sa linte pothuajse fare mënjanë punën e gjahut, bile edhe administrimin e çifligut të tij; dhe kureshtja e mania e tij për këtë gjë arritën gjer në atë pikë sa shiti shumë dynymë ara për të blerë libra kalorësie që t'i lexonte; dhe kështu e mbushi shtëpinë me libra të tillë, aq sa munda të gjej.

Me të tilla lodra fjalësh e humbi fare toruan sojliu i shkretë, se vriste mendjen tërë natën, që t'i merrte vesh dhe t'u këpuste kuptimin, të cilin Aristoteli vetë nuk do t'ua këpuste dot, sikur t'ishite ngritur nga varri posaçërisht për këtë punë...

Fantazia e tij u mbush me të gjitha ato që këndonte në libra, me magjira, sherre, beteja, sfida, plagë, ankesa, furtuna dhe marrëzira të pamundura. Dhe në këtë mënyrë iu mbush mendja se ishin të vërteta të gjitha këto përralla dhe profka të fabrikua dhe s'kishte për të të tjera histori më të sigurta në botë.

Shkurt, pasi e humbi fare toruan, i mbiu në kokë ideja më e çuditshme dhe më e çmendur në botë: iu duk e drejtë dhe e nevojshme për nderin e tij dhe për shërbimin e shtetit të bëhej kalorës i arratisur dhe të shëtiste nëpër botë, i armatosur dhe kaluar, të kërkonte aventura dhe të stërvitej në të gjitha ato që kish kënduar se bënin kalorësit e arratisur, duke ndrequr çdo padrejtësi, duke përballuar çdo andrallë dhe çdo rrezik dhe duke fituar famë dhe nam të përjetshëm.

Dhe e para që bëri ishte të spastronte ca armë të stërgjyshërve të tij, të cilat ishin mykur dhe zgjyrosur dhe ishin hedhur dhe harruar në një qip qindra vite me radhë. I pastroi e i meremetisi aq mirë sa i erdhi n' doresh.... Vajti dhe e pa kalin e tij, dhe ndonëse ishte i dregosur<sup>2</sup> dhe i ngordhur, sa kishte mbetur kockë e lëkurë....pasi shpiku shumë emra e pasi shkoi e ëndërroi, pëlqeu dhe shpëlqeu, rrëkëlëu në kokë e në tru, më në fund, e emëroi Rosinant... Pasi e pagëzoi kalin, me këtë emër kaq të pëlqyer, vendosi të pagëzonte edhe vetveten, dhe me këtë punë u mor nja tetë ditë dhe, më në fund, e quajti veten Don Kishot...Pasi i pastroi armët, pasi e emëroi kalin dhe pasi e pagëzoi vetveten, u mejtua se tani si mungonte tjetër veçse të kërkonte një zonjë, me të cilën do të binte në dashuri. Puna sikur besohet, ngjau kështu: Në një fshat afër ishte një katundare shumë e bukur me të cilën kishte rënë në dashuri kohën e kaluar, ndonëse, sikur merret vesh, ajo s'kishte ditur gjë dhe as që e kishte vënë re. Quhej Aldonza Lorenzo dhe kësaj t'i jepte titullin e zonjës së zemrës së tij. Dhe, duke kërkuar një emër që të mos largohej shumë nga emri i saj dhe t'i kishte hije një princeshe e një zonje të madhe, e pagëzoi Dylqinja e Tobozës.

.....  
*Në këto e sipër, shkoqiti prej së largu nja tridhjetë e katërt mullinj me erë, që ndodhen në atë fushë dhe, posa i pa, Don Kishoti i tha shqytarit të tij:*

- Fati na i rregulloi më mirë punët se ç'dëshirojmë vetë. Se ja, shiko atje, i dashur Sanço, që janë shfaqur nja tridhjetë e ca më tepër viganë kolosalë, me të cilët kam ndërmend të bëj betejë dhe t'i vras që të gjithë, pastaj do t'i plaçkitim dhe kështu do të nisim të pasurohemi. Se kjo është

<sup>1</sup> sojliu - njeri me prejardhje fisnike

<sup>2</sup> dregosur - i mbushur me puçrra të qelbëzuara





një luftë e mirë dhe një shërbim i lartë që i bëjmë Perëndisë, duke e spastruar faqen e dheut nga ky xhibilet.<sup>3</sup>

Ç'viganë? - tha Sanço Pançoja.

- Ata që shikon atje, - iu përgjigj ustai, - me krahë të gjatë prej afro dy milje.

- Shiko mirë, imzot, - iu përgjigj Sançoja, - se ata që duken atje nuk janë viganë, po mullinj ere, dhe ata që duken si krahë janë pëlhurat, të cilat vërtiten prej erës dhe rrotullojnë gurin e mullirit.

- Merret vesh, - iu përgjigj Don Kishoti, - që s'ke haber fare nga aventura. ata janë viganë. Po në ke frikë, largohu dhe shko e falju Perëndisë, kurse unë shkoj e hy në betejë të egër dhe inegale.<sup>4</sup>

Dhe, duke i thënë këto, i ra me mauzë Rosinantit, pa vënë re klithmat e Sanços që e siguronte se pa fjalë, që ishin mullinj me erë dhe jo viganë ata me të cilët gatitej të përpiquej. Po atij i ishte mbushur koka që ishin viganë dhe si dëgjonte klithmat e Sanços, as hapte sytë për të shikuar se ç'ishin, ndonëse ishin afuar, po thoshte me zë të lartë:

- Mos ikni, frikacakë dhe burravecë se një kalorës i vetëm po ju sulmon!

Në këtë mes fryu një erë e lehtë dhe pëlhurat e mëdha nisën të lëvizin. Kur e pa këtë Don Kishoti, thirri:

- Edhe sikur të lëvizni me më tepër krahë se ata të viganit Briare<sup>5</sup>, prapë do ma paguani!

Dhe, pasi tha këtë, dhe pasi thirri me zemër zonjën Dylqinjë, duke iu lutur që ta ndihmonte për këtë rrezik të madh, mbuloi krahërorin me mburojën, uli shtizën, u vërvit me galopin më të shpejtë të Rosinantit, u përlesh me mullirin e parë që i ndodhej përpara dhe i nguli shtizën në pëlhurë, po era e vërviti me aq furi, sa e bëri shtizën copa-copa, duke përfshirë kalin dhe kalorësin që u rrokullisën tatëpjetë fushës si mos më keq.

Sanço Pançoja rendi me tërë shpejtësinë e gomarit të tij që t'i ndihmonte ustait dhe, kur arriti, pa se nuk lëvizte dot nga vendi, aq keq ishte vlarë me gjithë Rosinantin.

- Perëndia na ruajtë! - ta Sançoja. - Nuk të thashë, imzot, të shikoje mirë se ç'bëje, se nuk ishin vetëm mullinj me erë.

Dhe për këtë gjë s'mund të lajthitej, veçse ndonjë që i ka marrë koka erë.

- Hesht, i dashur Sanço, - iu përgjigj Don Kishoti, - se punët e luftës ndërrojnë pa rreshtur, më tepër se gjërat e tjera, dhe ca më tepër kur mejtohem dhe kështu është e vërteta që ai Frestioni i Urtë, i cili m'i rrëmbeu librat, me gjithë odën, i ktheu këta viganë në mullinj, që të ma rrëmbejnë lavdinë e fitores, aq e madhe është mëria që më ka, po fundi i fundit, magjitetë e liga të tij s'kanë se ç'të bëjnë kundër shpatës sime të mirë.

*Miguel de Servantes*

<sup>3</sup> xhibilet - farë e keqe

<sup>4</sup> inegale - e pabarabartë

<sup>5</sup> Briare - në mitologjinë greke qenie me njëqind krahë e pesëdhjetë kokë.



**(1.1) Bazuar në fragmentin e dhënë, si e kalon kohën sojliu (Don Kishoti)?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(1.2) Për çfarë qëllimi Don Kishoti dëshironte të bëhet kalorës i arratisur?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(1.3) Sipas fragmentit të dhënë, pse Don Kishoti u vërsulet mullinjve të erës?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(1.4) Si përfundoi përleshja e Don Kishotit me mullinjtë e erës?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(1.5) Cili është personazhi që e sheh realitetin dhe vazhdimisht e këshillon Don Kishotin që t'i shohë gjërat ashtu siç janë?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(1.6) Pse "Don Kishoti i Mançës" llogaritet si roman antikalorësiak?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(1.7) Cilët tipare e karakterizojnë pamjen fizike të Don Kishotit në fragmentin e dhënë?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(1.8) Cilës periudhë letrare i takon veprimtaria e Miguel de Servantesit?**

**1 pikë**

\_\_\_\_\_

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

### **Vrull**

Zogj të bukur këndojnë me hare,  
Po zemra do më plasë mua në gji.  
I helmuar shkoj jetën të ky dhe :  
Mërzitem në katund, në vetmi.

Tërë shkëlqim m'hapet përpara deti  
Që zgjonte trutë e mi mendime shumë  
Zemra m'u shqer nga tmerri mua të shkretit  
Aq sa vetëm pushoj kur bie në gjumë.

Arbëria matanë detit na kujton  
Se ne të huaj jemi te ky dhe!  
Sa vjet shkuan! E zemra nuk harron  
Që ne turku na la pa Mëmëdhe

Hakmarrja na jep shpresë e na ndriçon,  
Por frynë era dhe akulli me zë,  
Se çka qenë Arbëreshi po harron:  
Dhe s'i vjen turp aspak, po rri e flë.

“Vrull”- Zef Serembe



|   |               |
|---|---------------|
| <p><b>(2.1) Poezia “Vrull” është me motiv:</b></p> <p>A. patriotik.<br/> B. erotik.<br/> C. peizazhist.<br/> Ç. reflektiv.</p>  | <b>1 pikë</b> |
| <p><b>(2.2) Krahas dramës së dobësisë së lëvizjes kombëtare dhe dramës së arbëreshëve të lindur e të rritur në dhe të huaj, poeti këtu paraqet edhe:</b></p> <p>A. tradhtinë ndaj kombit.<br/> B. gjendjen e vështirë ekonomike të popullit.<br/> C. dramën e tij shpirtërore si njeri që nuk gjen fushëveprim.<br/> Ç. dramën e shpërnguljes së shqiptarëve.</p> | <b>1 pikë</b> |
| <p><b>(2.3) Në këtë poezi poeti identifikon veten e tij:</b></p> <p>A. me luftëtarët më trima.<br/> B. me të parët e tij që lindën dhe jetuan në dhe të huaj.<br/> C. me të burgosurin.<br/> Ç. nuk paraqet identifikimi.</p>   | <b>1 pikë</b> |
| <p><b>(2.4) Në vargjet “Se çka qenë Arbëreshi po harron: / Dhe s’i vjen turp aspak, po rri e fle, autori prek në:</b></p> <p>A. dobësimin e Perandorisë Osmane.<br/> B. moralin e shqiptarëve.<br/> C. lëvizjen e Burbonëve.<br/> Ç. sedrën kombëtare të vëllezërve arbëreshë.</p>  | <b>1 pikë</b> |
| <p><b>(2.5) Cila nga veprat e dhëna nuk është e Zef Serembes?</b></p> <p>A. Për lirinë e Venetisë.<br/> B. Poezi italiane dhe këngë origjinale të përkthyer në shqip.<br/> C. Këngët e Milosaos.<br/> Ç. Kthimi i ushtarit.</p>   | <b>1 pikë</b> |
| <p><b>(2.6) Figura që dominon në vargjet e dhëna më poshtë është:</b><br/> <i>Zogj të bukur këndojnë me hare,<br/> Po zemra do më plasë mua në gji.</i></p> <p>A. simboli.<br/> B. krahasimi.<br/> C. personifikimi.<br/> Ç. antiteza.</p>  | <b>1 pikë</b> |

### 3 Lexo me kujdes fragmentin “KUSH E SOLLI DORUNTINËN” nga Ismail Kadare dhe përgjigju pyetjeve.

Duke ecur me kujdes për të mos bërë zhurmë, Stresi iu afrua krevatit ku ishte shtrirë plaka. Koka e saj ishte mbështjellë me një kapuç të bardhë.

-Zonjë,- i foli me zë të ulët,- Zonja Mëmë,- (kështu e thërrisnin zakonisht qysh nga vdekja e djemve).- Jam Stresi, më njihni?

Ajo hapi sytë. Ata dukeshin të ftohtë nga tmerri e nga zia. Një copë herë ai e duroi vështrimin e saj, pastaj, duke afruar kokën edhe më te nënkrejsa e bardhë, pëshpëriti:

-Si jeni, Zonja Mëmë?

Shenja që bëri ajo me sy ishte e pakuptueshme.

-Doruntina ka ardhur mbrëmë?- pyeti Stresi.

E shtrira bëri “po” me sy. Pastaj sytë e saj vazhduan ta vështronin drejt Stresin, sikur kërkonin diçka prej tij. Stresi qëndroi ca çaste në mëdyshje.

-Po si ndodhi?- pyeti ai fare ultazi.- Kush e solli?

Plaka mbuloi sytë me njërën dorë dhe nga një lëvizje e kokës u kuptua se humbi ndjenjat. Stresi i kapi dorën dhe me vështirësi i gjeti pulsën. Ai punonte.

-Thirre njërën nga gratë,- i tha Stresi me zë fare të ulët ndihmësit. Tjetri doli dhe u kthye pas pak bashkë me një grua. Stresi e la dorën e plakës dhe me po ata hapa të kujdesshëm iu afrua krevatit ku ishte shtrirë Doruntina. Tani i dalloj flokët e saj të verdhë mbi nënkrejsë. Në zemër ndjeu një sëmbim, por ai rrinte disi mënjanë, i papërzier me ngjarjen që posa kishte ndodhur. Ishte një sëmbim i vjetër, që kishte lidhje me dasmën e saj, tre vjet më parë, atëherë kur ai, Stresi, në çastin që ajo po largohej hipur mbi kalin e bardhë të nusërisë, midis karvanit të krushqve, kishte ndierë një pikëllim të tillë në zemër, saqë gati kishte pyetur veten me zë: po ç’kam kështu? Ishin të gjithë disi të pikëlluar dhe jo vetëm nëna e vëllezërit, por krejt gjindja, sepse ajo ishte e para vajzë që martohej kaq larg, mirëpo pikëllimi i Stresit ishte i një natyre të veçantë. Dhe në ato çaste që ajo po ikte, ai befasi e kishte kuptuar se ajo ndjenjë e ëmbël, që e kishte pushtuar kohët e fundit për të, s’kishte qenë veçse dashuri. Por ajo kishte qenë një dashuri tjetër lloj, e holluar si mjegulla mbi një hapësirë të pamatë, e padendësuar asnjëherë, e frenuar prej tij qetësisht. Ishte si vesa e mëngjesit, kishte rënë vetëm minutat e para të zgjimit dhe pastaj, në orët e tjera të ditës dhe të natës që tërhequr përgjithmonë. Dhe i vetmi çast kur ajo mjegull kaltëroshe që përpjekur të dendësohej e të krijonte një re, ishte çasti i ikjes së saj. Por ai kishte qenë çast i shkurtër, që ishte harruar shpejt.

Në këmbë para shtratit të saj, Stresi vështroi një copë herë fytyrën e Doruntinës. Ishte po aq e bukur si atëherë, në mos më tepër, me atë vijën e buzëve që ia bënte ato të rënda dhe të lehta njëkohësisht.

-Doruntinë,- i foli ai me zë fare të ulët,- ti ke mbërritur mbrëmë pas mesnate, apo jo?

Ajo bëri një “po” me sy. Stresi deshi ta shtynte edhe pak pyetjen që e mundonte, por ajo i doli vetvetiu:

-Po kush të solli?

Sytë e saj mbetën të palëvizshëm nën vështrimin e tij.

-Kush të solli, Doruntinë?- përsëriti ai.

Ajo nuk ia hiqte sytë, me atë boshësi të pashpresë në mes.

-Ti i the nënës se të solli yt vëlla, Kostandini, apo jo?

Ajo bëri prapë “po” me sy. Stresi u përpoq të gjente shenjat e çmendurisë në sytë e saj, por ata, si edhe më parë, ishin të zbrazur nga gjithçka.

-Po ti ndërkaq besoj se e ke marrë vesh që yt vëlla ka tre vjet që s’është më,- tha Stresi me po atë zë të shuar. Lotët, para se t’i shihte te ajo, i ndjeu brenda vetes. Ishin ca lotë tjetërllor, gjysmë të dukshëm, gjysmë të prekshëm. Nën atë lotëri fytyra e saj u bë edhe më e largët. Ç’më gjeti kështu, dukej sikur thoshin tani sytë e saj. Pse s’më besoni...

Stresi ktheu kokën ngadalë nga ndihmësi i tij dhe nga gruaja tjetër që po rrinin pranë shtratit të zonjës plakë dhe u bëri me shenjë të dilnin. Ai u përkul prapë mbi gruan e re dhe i lëmoi dorën.

-Po si erdhe Doruntinë? Si e bërë gjithë këtë udhë të gjatë?

Sytë e saj, të zmadhuar jashtë mase, diçka përpiquej t’i mbushte.



(3.1) Në qendër të vëmendjes së veprës “Kush e solli Doruntinën”, autori vë:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.2) Thelbi i kësaj vepre dhe i këtij fragmenti jepet në fjalinë:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.3) Në fragmentin e dhënë gjej dy elemente që Kadare i ka marrë nga legjenda e lashtë?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.4) Në fund të fragmentit Stresi përlohet, por pse nuk përlohet Doruntina?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.5) Si shfaqet bota intime e Stresit në këtë fragment?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.6) Në cilën vetë zhvillohet rrëfimi në këtë fragment?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.7) Nëpërmjet cilës figurë stilistike jepet gjendja e rënduar në prag të vdekjes me ëmbëlsinë e ndjenjës së dashurisë?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(3.8) Shkruaj disa nga veprat e shkrimtarit Ismail Kadare?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

|   |               |
|---|---------------|
| <p><b>4</b> Kur i vemë përballë njëra-tjetrës dy mendime, dy objekte, dy dukuri të ndryshme, atëherë kemi të bëjmë me figurën stilistike:</p> <p>A. Metaforë.<br/>B. Personifikim.<br/>C. Krahasim.<br/>Ç. Hiperbolë.</p>   | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>5</b> Të shkruarit e fabulave, karakteristike është për krijimtarinë e:</p> <p>A. P. Kornejit.<br/>B. La Fontenit.<br/>C. Zh. B. Molierit.<br/>Ç. O. Balzakut.</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>6</b> Cila është përgjigja e saktë e kombinimeve të mëposhtme për autorin dhe veprën?</p> <p>A. Shekspiri – “Hamleti”.<br/>B. Homeri – “Mbreti Edip”.<br/>C. M. de Servantesi – “Shtegtimet e Çajld Haroldit”.<br/>Ç. Dante Aligieri – “Komedia Njerëzore”.</p> | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>7</b> Epi i “Gilgameshit” është vepër e:</p> <p>A. Kulturës dhe civilizimit asiro-babilonas.<br/>B. Kulturës dhe civilizimit egjiptian.<br/>C. Kulturës dhe civilizimit të vjetër grek.<br/>Ç. Kulturës dhe civilizimit kinez.</p>                              | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>8</b> Cila nga llojet e mëposhtme i shpreh ndjenjat e dashurisë, ndarjes, dashurisë ndaj natyrës:</p> <p>A. lirika.<br/>B. epika.<br/>C. satira.<br/>Ç. didaktika.</p>  | <p>1 pikë</p> |
| <p><b>9</b> Eskili, Sofokliu dhe Euripidi janë të njohur si autorë antik të:</p> <p>A. tragjedisë.<br/>B. komedisë.<br/>C. epikës.<br/>Ç. retorikës.</p>  | <p>1 pikë</p> |

**10** Lidhëzat: në, nëse, po qe se, në qoftë se, në rast se, janë:

- A. Mënyrore.
- B. Shkakore.
- C. Lejore.
- Ç. Kushtore.

1 pikë

**11** Pjesa e ndryshueshme e ligjëratës që zë vendin e një emri apo të një mbiemri quhet:

- A. Përemër.
- B. Lidhës.
- C. Folje.
- Ç. Ndajfolje.

1 pikë

**12** Kopshti i gjyshes sate është i bukur. Fjala sate është:

- A. Përemër pronorë.
- B. Përemër i pacaktuar.
- C. Përemër pyetës.
- Ç. Përemër lidhorë.

1 pikë

**13** Dikush po vjen. Fjala dikush është përemër:

- A. Pronor.
- B. Lidhor.
- C. I pacaktuar.
- Ç. Pyetës.

1 pikë

**14** Pjesa e gramatikës që studion rregullën e bashkimit të fjalëve në fjali quhet:

- A. Leksikologji.
- B. Fonetikë.
- C. Leksikograf.
- Ç. Sintaksë.

1 pikë



**15** Fjalja që shpreh vullnetin e folësit si: urdhër, kërkesë, këshillë, lutje, etj., quhet:

1 pikë

- A. Fjali nxitëse.
- B. Fjali thirrmore.
- C. Fjali dëshirore.
- Ç. Fjali urdhërore.

**16** Fjalja që ka në vete kryefjalën dhe kallëzuesin quhet:

1 pikë

- A. Fjali e thjeshtë me një gjymtyrë kryesore.
- B. Fjali dykryegjymtyrëshe.
- C. Fjali e zgjeruar.
- Ç. Fjali njëkryegjymtyrëshe.

**17** Lidhëzat: daç...daç, ja...ja, herë...herë, ose...ose, janë:

1 pikë

- A. Lidhëza bashkërenditëse këpujore.
- B. Lidhëza përmbyllëse.
- C. Lidhëza bashkërenditëse veçuese.
- Ç. Lidhëza kundërshtore.

**18** Në fjalinë: “*Majat e malit shkëlqejnë nga rrezet e diellit*”, fjalët e shkruara me të trasha në sintaksë kryejnë funksionin e:

1 pikë

\_\_\_\_\_.

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**19** Foljet që përdoren vetëm në vetën e tretë si: macja mjaullin, kali hingëllin quhen folje \_\_\_\_\_.

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**20** Folja *mësoj* në formën e pashtjelluar të përcjellores bën:

\_\_\_\_\_ .

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**21** Fjalën *Vendi* ndaje në rrokje:

\_\_\_\_\_ .

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**22** Fjalja: *Vërja veshin diturisë*, në sintaksë është fjali:

\_\_\_\_\_ .

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**23** Sipas pjesëmarrjes së zërit dhe të zhurmës, bashkëtingëlloret *p, t, th, k, s, sh*, janë bashkëtingëllore të:

\_\_\_\_\_ .

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**24** Mbiemri *i bukur* në shkallën sipërore bën:

\_\_\_\_\_ .

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**25** Fjalët: *bukur, mjaft, dikur, afër, fuqishëm*, në morfologji janë:

\_\_\_\_\_ .

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**26** Pjesa e nënvizuar në fjalinë Ti dha librat që i kërkoje, në morfologji quhet:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**27** Folja *mendoj* në kohën e kryer të mënyrës dëftore, veta e dytë shumës bën:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**28** Çfarë lloji të lidhëzave bashkërenditëse janë: e, edhe, dhe?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**29** Çfarë është fjala *të mësuarit* në morfologji?

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**30** Shndërroje emrin *hëkur* në mbiemër të nyjshëm:

1 pikë

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

### E tani t'ju shoh, me këto fakte

- Pas audicionit të parë televiziv të Fred Asterit në vitin 1933, në njoftimin me shkrim të redaktorit përgjegjës për kasting në MGM, thuhej: “Nuk di të aktrojë! Lartë-poshtë tullac! Nga loja s’ka as L!” Këtë shënim e ka ruajtur Asteri në kornizë mbi kamin, në shtëpinë e tij në Beverli Hills.

- Kur Piter Xh. Danieli ishte në klasën e katërt, mësuesja e tij, zonja Filips, vazhdimisht i thoshte: “Piter, prej teje as bilbil druri nuk bëhet, e ku më nesër të bëhesh njeri”. Danieli, deri në moshën 26-vjeçare tekstualisht ishte analfabet. Në mbrëmje, një nga shokët e tij qëndronte me të dhe i lexonte një kopje të librit “Përdore kokën dhe bëhu i pasur”. Sot, ai është pronar i të gjitha lagjeve ku si i vogël ishte rrahur dhe sapo kishte publikuar librin e tij të fundit “Zonja Filips, po të ishit e verbër, nuk do të huqnit aq shumë!”.

- Luiza Mej Koj Alkot, autorja e veprës “Gratë e vogla“, gjithnjë ka qenë e detyruar nga familja të gjejë punë si ndihmëse shtëpiake apo rrobaqepëse.

- Bethoveni, nuk ka qenë ndonjë mrekulli prej violinisti dhe më tepër ka dashur të luaj kompozicionet e veta se sa të ushtrojë dhe të përsos teknikën. Profesori i tij e vlerësonte si kompozitor të mjerë. Kompozimin e tij e konsideronte të mjerë dhe ishte i sigurt që Bethoveni kurrë nuk do të bëhej i famshëm.

- Prindërit e këngëtarit të famshëm të operas, Enriko Karuso, dëshironin që ai të bëhej inxhinier. Mësuesi i tij konsideronte që Karuso nuk ka kurrfarë zëri dhe nuk ka gjasa të bëhet këngëtar opere.

- Çarls Darvini hoqi dorë nga karriera e mjekësisë, kurse babai i i tij i mllëfosur e qortoi: “O Zot, a nuk dëshiron të bëhesh diçka në jetë, ose edhe më tej të ngatërrohesh me me qentë e tu dhe me gjuetinë e urryer të minjëve”. Për vete Darvini ka shkruar: “Të gjithë profesorët e mi, këtu bie edhe im atë, nuk më konsideronin më shumë se një fëmijë mesatar, madje me koeficient inteligjence më të ulët nga ajo e rëndomta“.

- Albert Ajnshtajni nuk ka thënë asnjë fjalë derisa nuk kishte mbushur katër vjeç dhe nuk ka ditur të lexoj deri në moshën shtatëvjeçare. Mësuesi i tij e ka përshkruar si person “me të meta mentale”, anti-social dhe i humbur përgjithmonë në ëndrrat e tij të marra“. Ajnshtajni, ka qenë i përjashtuar, kurse më vonë edhe i refuzuar nga shkolla politeknike në Cyrih.

-Babai i skulptorit Ogist Roden ka thënë: “Në vend të djalit, unë po ruaj një idiot”. Rodeni, konsiderohej si nxënës më i keq në tërë shkollën, madje tri herë nuk ia doli të regjistrohet në shkollën e artit. Xhaxhai i tij e quante analfabet torollak.

- Leon Tolstoi, autori i veprës “Luftë dhe paqe“, është përjashtuar nga fakulteti. E njihnin “njëkohësisht si të pa aftë dhe pa vullnet për të mësuar”.

- Shkrimtari i dramave, Tenesi Uilliams ishte tepër i zemëruar, kur drama e tij “Unë, e juaja” nuk qe zgjedhur në konkursin në Uashington, ku studionte letërsinë angleze të shekullit XVI.

- Uinston Çerçili, nuk kishte arritur ta kalojë klasën e gjasht dhe kishte përsëritur. Ai, pr shkak të humbjeve dhe pengesave të mëdha deri në moshën 62 vjeçare nuk kishte arritur të bëhej kryeministër. Kontributi i tij më i madh ndodh në kohën e “pensionit”.

- Madje, tetëmbëdhjetë botues e refuzuan novelën e Riçard Bah-ut, “Pulëbardha e Xhonatan Livingstonit”, që përfundimisht ta botojë Mekmilani në vitin 1970. Deri në vitin 1975, libri është shitur në shtatë milionë kopje vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

- Riçard Hukeri ka punuar shtatë vjetë në novelën e tij humoristiko-ushtarake M\*A\*S\*H, e cila ishte refuzuar nga njëzetë e një shtëpi botuese, para se ta botonte Marou. Libri është shitur si hallvë, dhe sa hap e mbyll sytë është bërë best-seler, nga i cili kanë lindur një film bllok-baster dhe një serial i suksesshëm televiziv.



**(31.1) Nga ky tekst mund të përfundojmë se:**

- A. duhet të dëgjohen mendimet e tjetrit.
- B. njerëzit gabimisht i vlerësojnë aftësitë e njerëzve të tjerë.
- C. më me rëndësi është të bëhemi të pasur dhe të famshëm.
- Ç. të gjithë njerëzit e famshëm kanë qenë analfabetë.

1 pikë

**(31.2) Në çfarë mënyre janë sjellë mësuesit dhe profesorët e njerëzve të famshëm kur ata kanë qenë nxënës?**

- A. profesionale.
- B. objektive.
- C. motivuese.
- Ç. nënçmuese.

1 pikë

**(31.3) Nga ky tekst mund të konkludojmë se për të pasur sukses në jetë vendimtare janë:**

- A. të jesh këmbëngulës.
- B. ndihma e prindërve.
- C. shkolla si institucion.
- Ç. lidhjet në shoqëri.

1 pikë

**(31.4) Sa tituj veprash përmenden në tekst?**

- A. pesë.
- B. gjashtë.
- C. shtatë.
- Ç. tetë.

1 pikë

**(31.5) Cili person i famshëm është quajtur “analfabet torollak”?**

- A. Leon Tolstoji.
- B. Piter Xh. Danieli.
- C. Vinston Çerçili.
- Ç. Ogist Rodeni.

1 pikë



**(31.6) Si bazë e lindjes së filmit bllok-baster dhe një seriali të suksesshëm televiziv është vepra:**

- A. „M\*A\*S\*H“.
- B. Luftë dhe paqe.
- C. „Pulëbardha e Xhonatan Livingstonit“.
- Ç. Unë, Juaji.

1 pikë

**(31.7) Sa gra shkrimtare përmenden në tekst?**

- A. një.
- B. dy.
- C. tre.
- Ç. katër.

1 pikë

**(31.8) Politikan i vetëm për të cilin flitet në tekst është:**

- A. Tenesi Vilijamsi.
- B. Vinston Çerçili.
- C. Piter Xh. Danieli.
- Ç. Riçard Hukeri.

1 pikë

## SI U SHPIK TELEVIZORI

Mendohet se pikërisht në këtë ditë, 90 vjet më parë, John Logie Baird eksperimentoi me versionin e parë të “televizorit mekanik”. Në ekranin që ishte shumë i vogël, u shfaq një kokë njeriu që lëvizte. Ishte koka e Daisy Elizabeth Gandy-it, bashkëpunëtores së John Logie Baird-it, shkencëtarit skocez që njihet si shpikësi i televizorit.

Kutia që solli për herë të parë figurat lëvizëse në shtëpitë e njerëzve, në versionin e saj të parë eksperimental ngjante më shumë me radion, vetëm se zëri shoqërohej me figurën, që qartësohej duke rrotulluar një buton për “skanim elektronik”. Ekranin ishte shumë i vogël, dy centimetra i gjatë dhe një centimetër i gjerë.

Në fillim aftësia për të transmetuar figurën larg ishte shumë e kufizuar. 90 vjet më parë, kur Bairdi ua tregoi të tjerëve shpikjen e tij, bashkëpunëtorja e tij ndodhej në dhomën tjetër, para një lloji të kamerës, ndërsa pamja e saj shfaqej në ekranin e vogël të prototipit të televizorit.

Ishte 26 janar i vitit 1926, në Londër, në lagjen Soho. I ftuar për të parë çudinë ishte edhe një gazetar nga “Times”.

Bairdi u shpjegoi se aparati që kishte shpikur quhej “televizor” dhe se mund të shfaqte në moment lëvizjet dhe veprimet e njerëzve që ndodheshin diku tjetër.

Ishte një shpikje që do të transformonte botën në mënyrë të jashtëzakonshme, që mund të krahasohen vetëm me dukuri si shtypshkronja, apo interneti. Mirëpo, si zakonisht shumëkush e pa me dyshim dhe mospërfillje.

“Se për çfarë mund të përdoret ky aparat në praktikë, mbetet ende e paqartë”, shkroi në atë kohë, gazetari i vetëm që ndoqi eksperimentin, pa e kuptuar se sapo kishte parë lindjen e një mjeti të komunikimit masiv që do t’i shkaktonte krizën e parë madhore gazetave të shtypit, përfshi edhe asaj për të cilën punonte.

Ia vlen të shtosh këtu, se vetëm një vit më parë, Bairdi ishte përpjekur t’ia tregonte këtë shpikje një gazete tjetër. Por me të gjitha shpjegimet gjithë pasion, askush nuk kishte dashur t’i hidhte një sy aparatit të tij, në redaksinë e “Daily Express”.

“Hiqmani atë të çmendur nga holla i ndërtesës”, bërtiti kryeredaktori i gazetës kur i thanë se një person me emrin John Logie Baird, nuk largohej pa u treguar gazetarëve aparatit që shfaqte pamje të transmetuara nga larg.

Me gjithë këto dyshime fillestare, u deshën vetëm pak vite që shpikja të çmendte botën. Qysh në vitin 1929, BBC pranoi përdorimin e televizorëve të prodhuar në mënyrë masive nga Bairdi. Ai do të shpikte edhe televizorin me ngjyra dhe do të mbetet një nga shpikësit më të mëdhenj në këtë fushë. Ai ishte djali më i vogël në mesin e katër fëmijëve të një prifti skocez, që mund të ishte vrarë në Luftën e Parë Botërore, kur në mënyrë vullnetare deshi t’i bashkangjitet ushtrisë britanike, por e refuzuan për shkak të shëndetit të dobët. Qysh në moshë të vogël ishte i fiksuar pas elektronikës.

Ai studio inxhinierinë në Universitetin e Glasgout, por i braktisi studimet që t’u përkushtohet shpikjeve të tij.

Sot, nëse kërkoni në “Google”, do të shihni një shënim që nderon emrin dhe punën e tij, plot 90 vjet pas krijimit të kësaj kutie, dritare, nga e cila shihet e gjithë bota. Është me rëndësi që ky nder i bëhet në internet dhe shihet në kompjuterë, prodhime të një teknologjie të përparuar që rrezikon ta lërë pas televizorin, si dikur ky i fundit që e kishte lënë radion pas, në emër të një epoke të re të mediave për komunikim.

*<http://illyriapress.com/90-vjet-me-pare-u-shpik-televizori/>*



(32.1) Çfarë bëri Logie Bairdi 90 vjet më parë?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.2) Nga cili vend ishte John Logie Bairdi?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.3) Kujt i ngjasonte kutia që solli figurën lëvizëse në shtëpitë e njerëzve?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.4) Trego dimensionet e ekranit?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.5) Kur u shfaq pamja e parë në ekranin e vogël?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

(32.6) Kujt do t'i shkaktonte krizë lindja e një mjeti të komunikimit masiv?

1 pikë

---

---

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|





**(32.7) Cilët nga prodhimet e teknologjisë së përparuar rrezikojnë ta lënë pas televizorin?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.8) Cila nga mediat e adaptoi përdorimin e televizorëve dhe kur?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.9) Ku ka studiuar John Logie Bairdi?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

**(32.10) Përse John Logie Bairdi nuk është pranuar, edhe pse në mënyrë vullnetare është paraqitur në Ushtrinë britanike në Luftën e Parë Botërore?**

---

---

**1 pikë**

|   |   |
|---|---|
| 1 | 2 |
|---|---|

- Shkruaj një tekst nga 350 deri në 500 fjalë; Lexoje temën dhe mendo se çfarë duhet të përmbajë teksti; Respekto rregullat lidhur me kompozicionin e tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi); Respekto rregullat e gjuhës standarde;
- Shprehi mendimet në mënyrë qartë dhe të lidhur duke përdorur fakte dhe argumente;
- Përdor leksikun dhe stilin adekuat në përputhje me llojin e tekstit që shkruan. Mos përdor tekste të gatshme tekstualisht dhe pa distancë kritike nga burime të ndryshme (tekste mësimore, libra profesional, ueb-faqe etj.). Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

**Tema 1: Moda dhe ndikimi i saj ndaj të rinjve**

Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Shkruaj se çdo të thotë për ty moda (rroba, frizura etj.) dhe çfarë ndikimi ka moda ndaj të rinjve.
- Prezanto shembuj për ndikimin e modës në dukjen e përgjithshme të të rinjve.
- Sqaro se çdo të thotë se duhet pasur imazhin personal.
- Shpreh një qëndrim se a duhet ndjekur moda me patjetër.
- Trego së paku dy argumente për temën dhe përpunoj ata së paku me një shembull.

**Tema 2: Kujdesi i njeriut për mjedisin jetësor është investim për ardhmërinë e njerëzimit**

Orientime konkrete për të shkruar temën e lirë:

- Lexo temën dhe mendo mirë se çka duhet të përmbajë teksti.
- Prezanto së paku dy argumente për temën dhe mbështeti me shembuj adekuat.
- Shkruaj se çka do të thotë për ty natyra dhe kujdesi ndaj natyrës.
- Prezanto shembuj pozitiv dhe negativ për kujdesin/moskujdesin ndaj mjedisit jetësor dhe për pasojat pozitive ose negative ndaj njerëzve dhe përgjithësisht ndaj natyrës.
- Shkruaj për domosdoshmërinë që sekush duhet të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e mjedisit jetësor në të cilin jeton dhe të jetë përgjegjës për ruajtjen e tij.
- Sqaro se çfarë rëndësie ka për ardhmërinë e njerëzve dhe ardhmërinë e planetit Tokë kujdesi për një mjedis të shëndetshëm natyror.





A series of 28 horizontal lines for writing, arranged in a single column on the page.





Lined area for writing.

| Gjuhë                  |   |
|------------------------|---|
| 1                      | 2 |
| Kompozicioni i tekstit |   |
| 1                      | 2 |
| Përbajtja              |   |
| 1                      | 2 |

*FAQE E ZBRAZËT*

*FAQE E ZBRAZËT*



*FAQE E ZBRAZËT*

**ÇELËSI - GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**  
qershor, 2016

**Shënim:**

- Përgjigjet e pyetjeve të hapura pranohen si të sakta, po qe se janë të afërta me përgjigjet e çelësit. Si të sakta pranohen edhe ato përgjigje, të përcaktuara nga komisioni i vlerësuesve.
- Në të shkruarit, vlerësimi bëhet me kritere të veçanta.

| Numri i detyrës                                | Qëllimi i detyrës | Përgjigjja e saktë  | Pikë          | Pyetje   | Vërejtje nga vlerësuesi |
|--|-------------------|---|---------------|----------|-------------------------|
| <b>LETËRSI E HUAJ</b>                          |                   |   |               |          |                         |
| <b>1."Tartufi", Moliere</b>                    |                   | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Verbim religjioz (çdo lloj përgjigje e lidhur me besimin fanatik, naiv,....)</li> <li>2. arsyen / racionalen</li> <li>3. hipokrizinë / dyftyrësinë e priftërisë / klerikëve</li> <li>4. gruan e Orgonit, Elmirën</li> <li>5. komedi</li> <li>6. në shtëpinë e Orgonit (ose Pernelit)</li> <li>7. Tartufi</li> <li>8. e klasicizmit / në klasicizëm</li> </ol> | <b>8 pikë</b> | <b>8</b> |                         |
| <b>LETËRSI KOMBËTARE</b>                       |                   | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. në të cilën jetonte vegjëlja / e masës popullore / popullit shqiptar</li> <li>2. në monolog</li> <li>3. të rrokjes së tretë dhe të shtatë të theksuar</li> <li>4. u arratis nga atdheu / kur Ahmet Zogu vjen në</li> </ol>  | <b>8 pikë</b> | <b>8</b> |                         |
| <b>2."Anës Lumenjve",<br/>Fan Stilian Noli</b> |                   |   |               |          |                         |

|  |                          |  |               |          |  |
|--|--------------------------|--|---------------|----------|--|
|  |                          | <p>pushtet</p> <p>5. aliteracioni</p> <p>6. sociale të popullit / shoqërore të popullit / e rëndë / e mjerueshme, ....</p> <p>7. "Fryhet Vjosa derdhet Buna" (citim nga vargjet e strofës së gjashtë)</p> <p>8. "Albumi"</p> |               |          |  |
| <b>Numri i detyrës</b>                 | <b>Qëllimi i detyrës</b> | <b>Përgjigjja e saktë</b>  |               |          |  |
| <b>3."Studenti në shtëpi", Migjeni</b> | 1, 4, 5, 9               | <p>1. B. novele</p> <p>2. C. Itali</p> <p>3. A. Patriarkale</p> <p>4. B. I ashpër</p> <p>5. B. gazmore, e etshme për të renë</p> <p>6. C. Satirës</p>  | <b>6 pikë</b> | <b>6</b> |  |
| <b>3.TEORIA E LETËRSISË</b>            | 4,7,8                    | <p>4.Ç. historia e letërsisë</p> <p>5. A. biografi</p> <p>6. C. humanizmit dhe renesancës</p> <p>7. A. Honore de Ballzak</p> <p>8. C. peizazhiste</p> <p>9. B. Aristofani</p>  | <b>6 pikë</b> | <b>6</b> |  |

|          |  |   |  |   |  |
|----------|--|---|--|---|--|
| 4. GJUHË |  | <p>10. A. fjalë të përbëra (kompozita)</p> <p>11. C. në lakimin e tretë</p> <p>12. C. Mbaresë</p> <p>13. A. këpujore a shtuese</p> <p>14. A. kohore</p> <p>15. C. emër i gjinisë asnjane</p> <p>16. C. Në qoftë se</p> <p>17. C. Kallëzues emëror</p> |  | 8 |  |
|----------|--|---|--|---|--|

|       |  |  |         |    |  |
|-------|--|--|---------|----|--|
| GJUHË |  | <p>18. Fjali dëftore.</p> <p>19. të pacaktuar / përemra të pacaktuar</p> | 13 pikë | 13 |  |
|-------|--|--|---------|----|--|

|  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|
|  |  | <p><b>20.</b> mbiemra të nyjshëm / mbiemra</p> <p><b>21.</b> përkufizim</p> <p><b>22.</b> turpërohet / përulet / nënshtrohet</p> <p><b>23.</b> krahasore</p> <p><b>24.</b> figura stilistike / fjalë të figurshme</p> <p><b>25.</b> kritikë letrare</p> <p><b>26.</b> dy folje / 2 folje / dy kallëzues</p> <p><b>27.</b> pikëçuditëse !/!</p> <p><b>28.</b> moti</p> <p><b>29.</b> zanoreve</p> <p><b>30.</b> ndryshime fonetike / ndërrime morfonologjike /<br/>ndërrime fonologjike</p> <hr/> |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|

|  |              |  |
|--|--------------|--|
| <p><b>TË LEXUARIT</b></p> <p><b>31.Sekretet interesante të industrisë së modës</b></p> | <p>1,4,7</p> | <p><b>31. A.</b> që ta theksojnë statusin social të tyre</p> <p><b>31. Ç.</b> amësi</p> <p><b>31. C.</b> me krem për flokë</p> <p><b>31. B.</b> Bred Piti, Xhorxh Kluni, Robert Patisoni</p> <p><b>31. C.</b> Që të fillojnë të rruhen dhe të duken "më evropianë"</p> <p><b>31. Ç.</b> të fillojnë të qepin kopsa në mëngët e xhaketave</p> <p><b>31. A.</b> sepse është më ekskluzive</p> <p><b>31. C.</b> prej yndyrës së gjedhëve</p> <p><b>31. A.</b> jastëk</p> <p><b>31. B</b> i kanë rruar</p> |
|--|--------------|--|

|   |  |  |                      |                 |  |
|---|--|--|----------------------|-----------------|--|
| <p><b>TË LEXUARIT</b></p> <p><b>32. Evropa midis internetit dhe paisjeve mobile – koha për kapërcim</b></p> |  | <p><b>1.</b> (pothuajse) 410 milionë</p> <p><b>2.</b> 66% e shfrytëzuesve</p> <p><b>3.</b> Në Gjermani</p> <p><b>4.</b> Google-Androidi / Google / Android</p> <p><b>5.</b> Bisedë / për të biseduar</p> <p><b>6.</b> Përdorimi i videopërmbytjeve / të shikuarit e videopërmbytjeve</p> <p><b>7.</b> Google</p> | <p><b>8 pikë</b></p> | <p><b>8</b></p> |  |
|---|--|--|----------------------|-----------------|--|

|  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|
|  |  | 8. Kanalet e reja të komunikimit siç është Interneti / interneti |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|

| <b>TË SHKRUARIT</b>   |  |   |                |
|---|--|---|----------------|
| <b>Kjo aftësi vlerësohet me kriteret e të shkruarit të cilat janë në programin e provimit</b> |  |   |                |
| <b>33. Teksti duhet të përmbajë 350-500 fjalë</b>   |  | <p><b>Nuk hiqen pikë nëse teksti ka:</b><br/>350 – 500 fjalë;</p> <p><b>Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka:</b><br/>-----fjalë;</p> <p><b>Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 350 fjalë, përkatësisht më shumë se 500 fjalë.</b></p> <p>Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit.<br/>Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull: 16. 06. 2016 - ka tri fjalë)</p> <p><b><u>TEMA 1: Të jesh human është nevojë dhe detyrë e njeriut</u></b><br/><b><u>Udhëzime konkrete për ta punuar temën nga materiali</u></b></p> <p>1. Lexoje temën dhe mendohu mirë se çka duhet të përmbajë teksti!<br/>2. Gjatë punimit të temës së dhënë, bazohu në udhëzimet e poshtëshënuara:<br/>A) Shpjegoje domethënien e nocioneve: <i>të qenët human (humanizëm), nevojë, detyrë</i> si dhe rëndësinë e tyre në jetën e njeriut!<br/>B) Të qenët human (humanizmi) është veti e lindur e njeriut apo diçka që mësohet gjatë jetës?<br/>C) Jep sqarime se a është humanizmi nevojë e jetës së njeriut apo është detyrë e tij!<br/>Ç) Si ndikon humanizmi në zhvillimin e personalitetit?<br/>3. Paraqite qëndrimin tënd lidhur me temën e dhënë!<br/>4. Jep të paktën dy argumente në favor të mendimit (qëndrimit) tënd!<br/>5. Mbështeti mendimet e tua me të paktën një shembull (dëshmi) për çdo argument të dhënë!</p> | <b>13 pikë</b> |

|  |  |   |  |
|--|--|---|--|
|  |  | <p>6. Mos shkruaj fraza të përgjithshme!</p> <p><u>TEMA 2: Faji i heronjve tragjikë në veprat e letërsive të vjetra</u></p> <p><u>Udhëzime konkrete për ta punuar temën nga materiali</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Paraqiti karakteristikat e letërsive të vjetra, duke i paraqitur njëherazi edhe temat më të shpeshta dhe format letrare më të shpeshta!</li> <li>2. Zgjidhi autorët dhe veprat nëpërmjet të cilëve do të pasqyrosh <i>fajin tragjik</i> dhe <i>heronjtë tragjikë!</i></li> <li>3. Heronjtë tragjikë të zgjedhur ndërlidhi me fajin e tyre!</li> <li>4. Çfarë ndikimi kanë këta heronj në zhvillimin e ngjarjeve në vepra?</li> <li>5. Analizo të paktën nga dy personazhe veprash të ndryshme që u përkasin letërsive të vjetra!</li> <li>6. Mos i përshkruaj (mos i ritrego) brenditë e veprave, por analizoji veprimet, ngjarjet dhe personazhet!</li> <li>7. Mos përdor tekste të gatshme nga burime të ndryshme (tekste shkollore, literaturë profesionale, ueb faqe etj.) tekstualisht dhe pa distancë kritike.</li> </ol> |  |
|--|--|---|--|

- -Kandidati e humb të drejtën për t'iu vlerësuar aftësia e të shkruarit, sipas kriterëve të parashikuara, po qe se përmbajtja e tekstit nuk i përgjigjet temës së dhënë.
- Kandidati e humb të drejtën për t'iu vlerësuar aftësia e të shkruarit, sipas kriterëve të parashikuara, po qe se në tekstin e shkruar ka më tepër ose më pak fjalë se numri i parashikuar i fjalëve që është dhënë në Udhëzimin e vlerësimit, për vitin përkatës të provimit.

**Në Udhëzimin e lartpërmendur, në procesin e vlerësimit të testeve, përveç kriterëve të sipërthëna, duhet të zbatohen nga vlerësuesit edhe udhëzimet e poshtëshënuara:**

- Teksti, pavarësisht nga fakti se cila nga temat e dhëna është punuar, po qe se ajo është shkruar në gjuhën ***dialektore***, për kriterin që ka të bëjë me ***gjuhën*** merr 0 pikë.
- Teksti që përmban citate, pjesë të marra prej teksteve të tjera, kritika etj., *pa e theksuar burimin* e tyre, apo nëse ato nuk janë parafrazuar duke e emërtuar autorin, për kriterin ***përmbajtje***, merr 0 pikë.
- Teksti, në të cilin pjesa më e madhe e temës së punuar paraqet *ritregim* të veprës, për kriterin ***përmbajtje*** merr 0 pikë.



**ÇELËSI I TESTIMIT TË MATURËS NË GJUHËN SHQIPE DHE LETËRSI  
GUSHT, 2016**

**Vërejtje**

- Pyetjet me alternativa të shumta të përgjigjeve nuk kontrollohen nga vlerësuesit.
- Përgjigjet e pyetjeve të hapura pranohen si të sakta nëse janë të afërta me përgjigjet e çelësit ose si të sakta pranohen ato formulime, të cilat i ka zgjedhur komisioni i vlerësuesve.
- Në të shkruarit vlerësimi i do të bëhet me kriteret e veçanta.

| <b>LETËRSI</b>                            |                          |  |             |               |                                  |
|---|--------------------------|--|-------------|---------------|----------------------------------|
| <b>Numri i detyrës</b>                    | <b>Qëllimi i detyrës</b> | <b>Përgjigjja e saktë</b>  | <b>Pikë</b> | <b>Pyetje</b> | <b>Vërejtje nga kontrolluesi</b> |
| <b>1. "Hamleti" nga Uiliam Shekspir</b>   |                          | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tragjedi</li> <li>2. Në Danimarkë</li> <li>3. Nga fantazma</li> <li>4. Hidhërim / urretje / shpërfillje</li> <li>5. Vrasja e xhaxhait të vet. / vrasja e babait të Hamletit / raporti mes Hamletit dhe nënës së tij</li> <li>6. renesancë</li> <li>7. vdes/ e vrasin me shpatën e Laertit.</li> <li>8. Ta marrin vesh a e di Hamleti të vërtetën për vrasjen e babait të vet.</li> </ol>   | 8           |               |                                  |
| <b>2. "Hanko Halla", Ali Asllani</b>      |                          | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. B. ankesat e Hallës, se si nuset e kohës së sotme bëjnë punët dhe kalojnë kohën</li> <li>2. A. radio</li> <li>3. Ç. me shami në kokë, me flokë të gjata, më flori në gushë</li> <li>4. C. simbolizojnë shtresën e bejlerëve nga e cila rrjedh i nipi</li> <li>5. Ç. dymbëdhjetërokëshi</li> <li>6. A. poemës</li> </ol>  |             |               |                                  |
| <b>3. DRAMA "EMIRA" NGA ANTON SANTORI</b> |                          | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sepse dashuron Mirianin / nga shenjat e para të dashurisë që ka ndaj Mirianit dhe e kundërta/ nga dashuria që ndien për Mirianin</li> <li>2. Dashuri</li> <li>3. Metaforën</li> <li>4. Për Emirën</li> <li>5. Emirës dhe Mirianit (dhe përpiqet që ta bëjë xheloz Kallonjerin)</li> <li>6. Dhuna që ushtrojnë cubat në një fshat arbëresh dhe përpjekja e pushtetit legjitim që ta shpëtojë popullatën nga kjo e keqe e madhe që banorëve të Piciljes ua ka vështirësuar jetën. / dhuna e cubave</li> <li>7. Intrigat dhe xhelozia e Kalinës dhe Kallonjerit</li> <li>8. Zemërgjerësia/ bujaria/ toleranca / sinqeriteti / mirëkuptimi etj.</li> </ol> |             |               |                                  |

**GJUHË / TEORI E LETËRSISË**

- |  |  |  |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|
|  |  | <ol style="list-style-type: none"><li>4. c) udhëpërshkrim</li><li>5. c) strofë e përbërë prej tri vargjesh</li><li>6. b) me të cilën zmadhohen apo stërzmadhohen veçoritë e njerëzve apo sendeve</li><li>7. ç) rimë</li><li>8. a) ese</li><li>9. c) akt</li><li>10. b) parafjalë</li><li>11. c) metaforë</li><li>12. c) i lexuar</li><li>13. c) lakimit të tretë</li><li>14. ç) përemra</li><li>15. b) kallëzuesore</li><li>16. b) rrethor mënyre</li><li>17. b) ndajfolje të vendit</li><li>18. Dhanore</li><li>19. Pavetore</li><li>20. qe – ndra, qend-ra, qen-dra</li><li>21. Njëkryegjymtyrëshe</li><li>22. o,u y</li><li>23. shumë i ftohtë, jashtëzakonisht i ftohtë, tepër i ftohtë...</li><li>24. Pjesëza</li><li>25. Trajta të shkurtra të përemrave vetorë / trajta të shkurtra</li><li>26. Në mënyrën habitore</li><li>27. u zemërua/ u hidhërua</li><li>28. kundrinor i drejtë</li><li>29. për të ngrënë</li><li>30. parafjalës</li></ol> |  |  |  |
|--|--|--|--|--|--|

**TË LEXUARIT**

| Numri i detyrës  | Qëllimi i detyrës | Përgjigjja e saktë  | Pikë | Pyetje | Vërejtje nga kontrolluesi |
|--|-------------------|---|------|--------|---------------------------|
| <b>31. HUMBËSIT MË TË MËDHENJ NË VITIN 2015</b>            |                   | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. c) „Shigjetari“</li> <li>2. b) Gvinet Palltrou</li> <li>3. b) „Pan“</li> <li>4. a) dramë kriminalistike-akcion</li> <li>5. ç) „Katërshja fantastike“</li> <li>6. b) Hju Xhekmen</li> <li>7. ç) 35 milionë dollarë</li> <li>8. ç) sipas revistës „Forbs“</li> </ol>  |      |        |                           |
| <b>32. Ushtrimet për koncentrim më të mirë të fëmijëve</b> |                   | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. E lindur</li> <li>2. Të investojë përpjekjet intelektuale, respektivisht të mendojë / të mendojë</li> <li>3. Çdo ditë të bëjë ushtrime të caktuara intelektuale siç janë: gjëgjëza ose puzzle, ndërtimi i objekteve të ndryshme ose qyteteve nga kubëzat me madhësi të ndryshme ose vizatimi.</li> <li>4. Nëse ndonjë stimulans i jashtëm pengon rrjedhën e mendimeve të fëmijës derisa është duke bërë diçka.</li> <li>5. Sepse ekziston rreziku që humbja e shpejtë e interesimit të manifestohet më vonë përmes vështirësive në mësim.</li> <li>6. Fëmija që nga vegjësia mësohet që prindërit ta ndërpresin ose t'i ndihmojnë në ato që bëjnë.</li> <li>7. “Kam përshtypje që çdo gjë që i them i hyn në njërën vesh dhe i del nga tjetri!”</li> <li>8. Në lojëra që do t'i pëlqejnë</li> <li>9. afat për kryerjen e detyrave / afat</li> <li>10. 30 minuta vozitje me biçikletë në park</li> </ol> |      |        |                           |
|  |                   |   |      |        |                           |

**TË SHKRUARIT**

Kjo aftësi vlerësohet me kriteret e të shkruarit të cilat janë në programin e provimit

|  |                         |  |                                      |
|--|-------------------------|--|--------------------------------------|
| <p><b>33. Teksti duhet të përmbajë 350-550 fjalë</b></p> | <p align="center">4</p> | <p><b>Nuk hiqen pikë nëse teksti ka:</b><br/>300 – 550 fjalë;<br/><b>Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka:</b><br/>290 ose 560 fjalë;<br/><b>Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë.</b><br/>Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit.<br/>Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull: 16. 06. 2014 - ka tri fjalë)<br/><b>TEMA 1: <i>Arsimimi i të rinjve ndikon në përparimin e një vendi</i></b><br/><b><u>Udhëzime konkrete për ta punuar temën e lirë</u></b><br/>1. Lexoje temën dhe mendohu mirë se çka duhet të përmbajë teksti!<br/>2. Gjatë punimit të temës së dhënë, bazohu në udhëzimet e poshtëshënuara:<br/>A) Paraqite domethënien e nocioneve “arsimimi i të rinjve” dhe “përparim”!<br/>B) Si ndikon arsimimi në zhvillimin e personalitetit?<br/>C) Sa ndikon arsimimi i të rinjve në përparimin e një vendi?<br/>Ç) Jep shembuj të ndikimit të arsimimit të të rinjve ndaj përparimit të një vendi!<br/>3. Paraqite qëndrimin tënd lidhur me temën e dhënë!<br/>4. Jep të paktën dy argumente në favor të mendimit (qëndrimin) tënd!<br/>5. Mbështeti mendimet e tua me të paktën një shembull (dëshmi) për çdo argument të dhënë!<br/>6. Mos shkruaj fraza të përgjithshme!</p> <p><b>TEMA 2: <i>Guximi dhe urtia e njeriut – temë e shpeshtë e letërsive të lashta</i></b><br/><b><u>Udhëzime konkrete për ta punuar temën nga materiali</u></b><br/>1. Paraqiti karakteristikat e letërsive të vjetra, duke i paraqitur njëherazi edhe temat më të shpeshta dhe format letrare më të shpeshta!<br/>2. Ceki autorët dhe veprat nëpërmjet të cilëve do ta pasqyrosh guximin dhe urtinë e njeriut!<br/>3. Ndërlidhi veprat dhe personazhet e zgjedhur që shquhen për guximin dhe urtinë e njeriut!<br/>4. Çfarë ndikimi kanë këta heronj në zhvillimin e ngjarjeve në vepra?<br/>5. Analizo të paktën nga dy personazhe veprash të ndryshme që u përkasin letërsive të vjetra!</p> | <p align="center"><b>13 pikë</b></p> |
|--|-------------------------|--|--------------------------------------|

|  |  |  |  |
|--|--|--|--|
|  |  | 6. Mos i përshkruaj (mos i ritrego) brenditë e veprave, por analizoji veprimet, ngjarjet dhe personazhet!<br>7. Mos përdor tekste të gatshme nga burime të ndryshme (tekste shkollore, literaturë profesionale, ueb faqe etj.) tekstualisht dhe pa distancë kritike. |  |
|--|--|--|--|

- -Kandidati e humb të drejtën për t'iu vlerësuar aftësia e të shkruarit, sipas kriterëve të parashikuara, po qe se përmbajtja e tekstit nuk i përgjigjet temës së dhënë.
- Kandidati e humb të drejtën për t'iu vlerësuar aftësia e të shkruarit, sipas kriterëve të parashikuara, po qe se në tekstin e shkruar ka më tepër ose më pak fjalë se numri i parashikuar i fjalëve që është dhënë në Udhëzimin e vlerësimit, për vitin përkatës të provimit.

**Në Udhëzimin e lartpërmendur, në procesin e vlerësimit të testeve, përveç kriterëve të sipërthëna, duhet të zbatohen nga vlerësuesit edhe udhëzimet e poshtëshënuara:**

- Teksti, pavarësisht nga fakti se cila nga temat e dhëna është punuar, po qe se ajo është shkruar në gjuhën **dialektore**, për kriterin që ka të bëjë me **gjuhën** merr 0 pikë.
- Teksti që përmban citate, pjesë të marra prej teksteve të tjera, kritika etj., *pa e theksuar burimin* e tyre, apo nëse ato nuk janë parafrazuar duke e emërtuar autorin, për kriterin **përmbajtje**, merr 0 pikë.
- Teksti, në të cilin pjesa më e madhe e temës së punuar paraqet *ritregim* të veprës, për kriterin **përmbajtje** merr 0 pikë.

**Kritere për vlerësimin e aftësisë së *Të shkruarit***

- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se përmbajtja e teksteve nuk përputhet me temën e dhënë.
- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se teksti i shkruar për destinim praktik nuk e plotëson formën e kërkuar.
- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se numri i fjalëve në tekstin e shkruar është më i madh se numri i parashikuar në Udhëzimin për vlerësim për vitin konkret të provimit.

| Kriteret e vlerësimit   | Treguesit e kritereve   | Detyra e vlerësuesit   |
|---|---|--|
| <p><b>1. Gjuha</b> - - gjithsej 2 pikë</p> <p>drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit - 1 sintaksa - 1</p> | <p><b>1. Drejtshkrimi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdorimi i germës së vogël dhe i germës së madhe;</li> <li>- të shkruarit e fjalëve në mënyrë të bashkuar apo të ndarë;</li> <li>- ndarja e fjalëve në fund të rreshtit ;</li> <li>- drejtshkrimi i fjalëve;</li> <li>- përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit.</li> </ul> <p><b>2. Sintaksa</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kompozicioni sintaksor i drejtë i fjalisë dhe përdorimi funksional i saj.</li> </ul> | <p><b>Vlerësuesi me kujdes duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i zbulojë dhe t'i klasifikojë gabimet në tekst sipas sqarimit të dhënë; ta përcaktojë peshën dhe përsëritjen e gabimeve (me përsëritje nënkuptohen gabimet që përsëriten disa herë, p.sh. <i>burr</i> në vend të <i>burrë</i>); gabimi i përsëritur numërohet një herë.</li> <li>- ta vlerësojë kompozicionin sintaksor të drejtë të fjalisë (renditjen e drejtë të fjalive; përdorimin e lidhëzave përkatëse, renditjen e drejtë të fjalive të nënrenditura – fjalitë në periudha).</li> </ul> |
| <p><b>2. Kompozicioni i tekstit</b></p> <p>- gjithsej 2 pikë</p>  | <p><b>Në tekst ndahen në mënyrë të qartë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- hyrja</li> <li>- pjesa kryesore</li> <li>- përfundimi / rregullimi i paragrafëve me fjali këpujore <b>1 pikë</b></li> <li>- respektimi i kufirit të numrit të parashikuar të fjalëve <b>1 pikë</b></li> </ul>  | <p><b>Vlerësuesi me kujdes duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ta konstatojë praninë e që të tri pjesëve të kompozicionit; ta vlerësojë lidhshmërinë dhe renditjen e pjesëve; ta vlerësojë rregullimin e tekstit sipas paragrafëve, duke vlerësuar praninë e fjalive këpujore;</li> <li>- të konstatojë nëse nxënësi ka përdorur numër të duhur fjalësh.</li> </ul>  |

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p><b>3. Kreativiteti në përmbajtje</b> - gjithsej 9 pikë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptuarit e temës</li> <li>- zhvillimi i temës</li> <li>- lidhja kreative e pjesëve dhe e përmbajtjes</li> <li>- fokusimi në idenë kryesore të temës</li> <li>- elementet origjinale dhe kreative në stilet letrare dhe jo letrarë</li> <li>- respektimi i kërkesave të përcaktuara</li> <li>- leksik përkatës</li> </ul> | <p><b>Në tekst lexohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptuarit e temës duke përdorur shembuj përkatës si prova të shtjellimit të temës. - <b>2 pikë</b></li> <li>- shtjellimi i temës me ide dhe argumente që paraqesin rëndësi themelore për domethënien e temës <b>1 pikë</b></li> <li>- mendime kritike të ndërlidhura në mënyrë kreative, duke përdorur fakte të sakta që kanë të bëjnë me temën <b>2 pikë</b></li> <li>- të theksuarit (fokusimi në) e idesë themelore në përpilimin e tekstit duke i lidhur pjesët në mënyrë origjinale dhe kreative - <b>1 pikë</b></li> <li>- përdorimi përkatës i stileve letrare dhe jo letrare në kontekstin e temës në të cilën ka origjinalitet dhe kreativitet - <b>1 pikë</b></li> <li>- krijimi i tekstit që përputhet me kërkesat konkrete, të përcaktuara në Udhëzim -<b>1 pikë</b></li> <li>- Përdorimi i leksikut që përputhet me llojin e tekstit dhe me temën - <b>1 pikë</b></li> </ul> | <p><b>Vlerësuesi me kujdes duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ta vlerësojë të kuptuarit e temës dhe shtjellimin e saj në tekst;</li> <li>- ta vlerësojë përputhshmërinë e përmbajtjes në pjesët e kompozicionit;</li> <li>- t'i vlerësojë faktet, idetë, pyetjet dhe përgjigjet e paraqitura në tekstin e dhënë.</li> <li>- ta vlerësojë kreativitetin e paraqitur në tekst</li> <li>- t'i vlerësojë elementet origjinale dhe kreative</li> <li>- me shprehjen <i>leksik</i> përkatës nënkuptohet: përfshirja e fjalëve, e frazave dhe e ndërkombëtarizmave të ndryshëm dhe përdorimi përkatës i tyre.</li> </ul> |
|---|---|--|

**ÇELËSI I TESTIMIT TË MATURËS NË GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI  
QERSHOR, 2017**

**Vërejtje**

- Pyetjet me alternativa të shumta të përgjigjeve nuk kontrollohen nga vlerësuesit.
- Përgjigjet e pyetjeve të hapura pranohen si të sakta nëse janë të afërta me përgjigjet e çelësit ose si të sakta pranohen ato formulime, të cilat i ka zgjedhur komisioni i vlerësuesve.
- Në të shkruarit vlerësimi i do të bëhet me kritere të veçanta.

| <b>LETËRSI</b>                                    |                          |  |             |               |                                  |
|---|--------------------------|--|-------------|---------------|----------------------------------|
| <b>Numri i detyrës</b>                            | <b>Qëllimi i detyrës</b> | <b>Përgjigjja e saktë</b>  | <b>Pikë</b> | <b>Pyetje</b> | <b>Vërejtje nga kontrolluesi</b> |
| <b>1. “KOMEDIA HYJNORE” FERRI, DANTE ALIGIERI</b> |                          | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ferr/ para ferr / në mes shtegëtisë të pyllit krejt errësi,në pyll.</li> <li>2. Virgjili</li> <li>3. Humanizmi (dhe renesansa ose pararenesanca).</li> <li>4. Sipas mëkateve që kanë bërë / sipas peshës së mëkateve (9 rrathë)</li> <li>5. Gjuhë popullore / dialekti toskan /gjuhë italiane</li> <li>6. Nga tri pjesë</li> <li>7. Frikë / shqetësim (çdo sinonim që lidhet me këtë )</li> <li>8. 3 (tri), 9 (nëntë),të jenë patjetër por pranohen nëse shtohen edhe numrat 7,100,33,10.</li> </ol>   | <b>8</b>    | <b>8</b>      |                                  |
| <b>2. "14 Vjeç dhëndërr" nga A. Z. ÇAJUPI</b>     |                          | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>B.</b> Se dëshiron ta nxjerrë në pah qëllimin kryesor të saj</li> <li>2. <b>C.</b> Sepse ajo ia bënte drekën dhe darkën</li> <li>3. <b>C.</b> Pozita e një burri parazit që ushqehet nga munda dhe djersa e gruas</li> <li>4. <b>A.</b> Sepse dëshiron të ketë një krah pune më shumë</li> <li>5. <b>C.</b> Me shembullin e djalit të beut</li> <li>6. <b>Ç.</b> Me mençurinë, shkathtësinë dhe dinakërinë e saj</li> </ol>   | <b>6</b>    | <b>6</b>      |                                  |
| <b>3. “ERVEHEJA “ nga MUHAMET CAMI</b>            |                          | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kur burri i Ervehesë i linte amanet vëllait / Lënien amanet te vëllai / Lutjen që i bën të vëllait për t'u kujdesur për Ervehënë</li> <li>2. Vigjilenca/ Sinqeriteti / Humanizmi (njerëzia)/Besnikëria</li> <li>3. Bukurisë së saj –ose kunatit,vëllau I burrit ose botës mashkullore.</li> <li>4. Sprovimet e Ervehesë për të mbrojtur nderin dhe besën/ temën e moralit.</li> <li>5. Varfëria/ shkaqet ekonomike/siq është zakon (adet)</li> <li>6. Nga Kur'ani/ nga libri I shenjtë,nga një libër me emrin <b>Revza</b></li> <li>7. Me alfabetin arabo-turk</li> <li>8. Katërvarëgëshe / katrenën/</li> </ol> | <b>8</b>    | <b>8</b>      |                                  |



**GJUHË / TEORI E LETËRSISË**

|  |  |   |           |           |  |
|--|--|---|-----------|-----------|--|
|  |  | <p>4. Ç) Vargu i parë me të katërtin<br/>5. A) Realizmit<br/>6. B) Nikolla Boallo<br/>7. Ç) Tetë vargje<br/>8. B) Motivin e këngës<br/>9. A) Krahasimit<br/>10. C) Me anë të ndërrimeve fonetike dhe me anë të prapashtesave<br/>11. B) Dhanore<br/>12. A) Gjysmëndihmëse<br/>13. A) Kohe<br/>14. A) Kumbulla<br/>15. B) Kryefjalë<br/>16. A) Atdhe<br/>17. C) Historizma<br/>18. Dëftore<br/>19. Habitore<br/>20. a, e, ë, i<br/>21. Qytetar<br/>22. Thirrje, ftesë, grishje<br/>23. Fshatra<br/>24. Në vendlindje<br/>25. Ndajfolje mënyre. Ndajfolje<br/>26. Kunetërit e vegjël<br/>27. Një fletoreje<br/>28. Pësore (mesore, joveprore)<br/>29. Kryefjalore<br/>30. Turke / orientale</p> | <b>27</b> | <b>27</b> |  |
|--|--|---|-----------|-----------|--|

| TË LEXUARIT   |                   |  |      |        |                           |
|---|-------------------|--|------|--------|---------------------------|
| Numri i detyrës   | Qëllimi i detyrës | Përgjigjja e saktë   | Pikë | Pyetje | Vërejtje nga kontrolluesi |
| 31. TEATRI<br>GRANDIOZ<br>EDHE MË TEJ<br>SHKRUAN<br>HISTORI |                   | 2. C) Vetëm nga autorë rusë<br>3. B) Knjazi Petar Urusovi dhe Mihaill Madoksi<br>4. B) Afro 200 euro.<br>5. Ç) Skulptura të muzave.<br>6. A) U shkatërrua nga zjarri<br>7. B) „Mazepa“ dhe „Eugjen Onjegini“ nga Çajkovski<br>8. A) Të teatrit “Bolshoj”<br>9. A) Muzikë moderne dhe klasike<br>10. Ç) Mëndafsh dhe ar | 10   | 10     |                           |
| 32. RREZIQET<br>NGA<br>INTELIGJENCA<br>ARTIFICIALE          |                   | 1. Redaktor themelues<br>2. Illon Maksi (Një nëpunës teknik)<br>3. Lojtarin më të mirë në botë “Xheopardi”<br>4. Kevin Keli<br>5. Stiven Hoking, Bill Gejts dhe Illon Maks<br>6. Komponentë e rëndësishme<br>7. Gjëra inerte<br>8. “Dip Blu”   | 8    | 8      |                           |

| TË SHKRUARIT   |   |  |         |
|--|---|--|---------|
| Kjo aftësi vlerësohet me kriteret e të shkruarit të cilat janë në programin e provimit |   |  |         |
| 33. Teksti duhet të përmbajë 350-550 fjalë   | 4 | <p><b>Nuk hiqen pikë nëse teksti ka:</b><br/>300 – 550 fjalë;<br/><b>Hiqet 1 pikë nga kompozicioni në qoftë se teksti ka:</b><br/>290 ose 560 fjalë;<br/><b>Teksti nuk vlerësohet (nuk kontrollohet) në qoftë se ka më pak se 290 fjalë, përkatësisht më shumë se 560 fjalë.</b><br/>Në numrin e përgjithshëm të fjalëve nuk numërohen fjalët e titullit.<br/>Datat numërohen nga një fjalë për ditën, muajin dhe vitin (shembull:</p> | 13 pikë |

16. 06. 2014 - ka tri fjalë)

**Tema 1. *Arti e fisnikëron dhe e bën më të bukur jetën e njeriut***

**Udhëzime konkrete për ta punuar temën e lirë**

Lexoje temën dhe mendo mirë çfarë duhet të përmbajë teksti.

2. Gjatë shkrimit të përgjigjes së temës së dhënë udhëhiq nga këto udhëzime:

- Paraqite domethënien e nocionit *art*, duke theksuar njëherazi edhe rolin e tij në jetën e njeriut!

- Çfarë rëndësie ka arti në jetën tënde?

3. Paraqite qëndrimin tënd në lidhje me temën e dhënë.

4. Jep të paktën dy argumente në favor të mendimit (qëndrimit) tënd.

5. Mbështeti mendimet e tua me të paktën një shembull (dëshmi) për çdo argument të dhënë.

6. Mos shkruaj fraza të përgjithshme!

**\_Tema 2. *Ndjenjat dhe imagjinata karakteristika mbizotëruese në veprat e romantizmit***

**Udhëzime konkrete për ta punuar temën nga materiali**

1. Punimi duhet t'i përmbajë karakteristikat e drejtimit letrar të romantizmit si dhe përfaqësuesit e këtij drejtimi letrar.

2. Në punim nxënësi duhet t'i përfshijë veprat dhe autorët nëpërmjet të cilëve do ta pasqyrojë rrëfimin e ndjenjave dhe të imagjinatës që janë karakteristike për romantizmin.

|  |  |  |
|--|--|--|
|  | <p>3. Karakteristikat e drejtimit letrar të romantizmit të ndërlidhen me tiparet e personazheve si dhe me ngjarjet e veprave - të pasqyruara në punim.</p> <p>4. Analizo të paktën dy personazhe të veprave të ndryshme që i përkasin drejtimit të romantizmit, duke e paraqitur njëherazi edhe praninë e ndjenjave dhe të imagjinatës, si karakteristika të romantizmit!</p> <p>5. Të kesh parasysh faktin se nuk kërkohet ritregimi i përmbajtjes së veprave, por analiza e veprimeve, e ngjarjeve dhe e personazheve.</p> <p>6. Mos merr tekste të gatshme dhe pa një distancë kritike, nga çfarëdo burimi qoftë, siç janë: tekstet shkollore, literatura profesionale, ueb faqet etj.!</p> |  |
|--|--|--|

- -Kandidati e humb të drejtën për t'iu vlerësuar aftësia e të shkruarit, sipas kriterëve të parashikuara, po qe se përmbajtja e tekstit nuk i përgjigjet temës së dhënë.
- Kandidati e humb të drejtën për t'iu vlerësuar aftësia e të shkruarit, sipas kriterëve të parashikuara, po qe se në tekstin e shkruar ka më tepër ose më pak fjalë se numri i parashikuar i fjalëve që është dhënë në Udhëzimin e vlerësimit, për vitin përkatës të provimit.

**Në Udhëzimin e lartpërmendur, në procesin e vlerësimit të testeve, përveç kriterëve të sipërthëna, duhet të zbatohen nga vlerësuesit edhe udhëzimet e poshtëshënuara:**

- Teksti, pavarësisht nga fakti se cila nga temat e dhëna është punuar, po qe se ajo është shkruar në gjuhën **dialektore**, për kriterin që ka të bëjë me **gjuhën** merr 0 pikë.

- Teksti që përmban citate, pjesë të marra prej teksteve të tjera, kritika etj., *pa e theksuar burimin* e tyre, apo nëse ato nuk janë parafrazuar duke e emërtuar autorin, për kriterin **përmbajtje**, merr 0 pikë.

- Teksti, në të cilin pjesa më e madhe e temës së punuar paraqet *ritregim* të veprës, për kriterin **përmbajtje** merr 0 pikë.

## Kritere për vlerësimin e aftësisë së *Të shkruarit*

- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se përmbajtja e teksteve nuk përputhet me temën e dhënë.
- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se teksti i shkruar për destinim praktik nuk e plotëson formën e kërkuar.
- Kandidati e humb te drejtën për t'u vlerësuar sipas kritereve të parashikuara të aftësisë së të shkruarit, po qe se numri i fjalëve në tekstin e shkruar është më i madh se numri i parashikuar në Udhëzimin për vlerësim për vitin konkret të provimit.

| Kriteret e vlerësimit  | Treguesit e kritereve   | Detyra e vlerësuesit   |
|--|---|--|
| <p><b>1. Gjuha</b> - - gjithsej 2 pikë</p> <p>drejtshkrimi dhe shenjat e pikësimit - 1</p> <p>sintaksa - 1</p> | <p><b>1. Drejtshkrimi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdorimi i germës së vogël dhe i germës së madhe;</li> <li>- të shkruarit e fjalëve në mënyrë të bashkuar apo të ndarë;</li> <li>- ndarja e fjalëve në fund të rreshtit ;</li> <li>- drejtshkrimi i fjalëve;</li> <li>- përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit.</li> </ul> <p><b>2. Sintaksa</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kompozicioni sintaksor i drejtë i fjalisë dhe përdorimi funksional i saj.</li> </ul> | <p><b>Vlerësuesi me kujdes duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- t'i zbulojë dhe t'i klasifikojë gabimet në tekst sipas sqarimit të dhënë; ta përcaktojë peshën dhe përsëritjen e gabimeve (me përsëritje nënkuptohen gabimet që përsëriten disa herë, p.sh. <i>burr</i> në vend të <i>burrë</i>); gabimi i përsëritur numërohet një herë.</li> <li>- ta vlerësojë kompozicionin sintaksor të drejtë të fjalisë (renditjen e drejtë të fjalive; përdorimin e lidhëzave përkatëse, renditjen e drejtë të fjalive të nënrenditura – fjalitë në periudha).</li> </ul> |
| <p><b>2. Kompozicioni i tekstit</b></p> <p>- gjithsej 2 pikë</p>   | <p><b>Në tekst ndahen në mënyrë të qartë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- hyrja</li> <li>- pjesa kryesore</li> <li>- përfundimi / rregullimi i paragrafëve me fjali këpujore <b>1 pikë</b></li> <li>- respektimi i kufirit të numrit të parashikuar të fjalëve <b>1 pikë</b></li> </ul>  | <p><b>Vlerësuesi me kujdes duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ta konstatojë praninë e që të tri pjesëve të kompozicionit; ta vlerësojë lidhshmërinë dhe renditjen e pjesëve; ta vlerësojë rregullimin e tekstit sipas paragrafëve, duke vlerësuar praninë e fjalive këpujore;</li> <li>- të konstatojë nëse nxënësi ka përdorur numër të duhur fjalësh.</li> </ul>  |

|   |   |  |
|---|---|--|
| <p><b>3. Kreativiteti në përmbajtje</b> - gjithsej 9 pikë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptuarit e temës</li> <li>- zhvillimi i temës</li> <li>- lidhja kreative e pjesëve dhe e përmbajtjes</li> <li>- fokusimi në idenë kryesore të temës</li> <li>- elementet origjinale dhe kreative në stilet letrare dhe jo letrarë</li> <li>- respektimi i kërkesave të përcaktuara</li> <li>- leksik përkatës</li> </ul> | <p><b>Në tekst lexohet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptuarit e temës duke përdorur shembuj përkatës si prova të shtjellimit të temës. - <b>2 pikë</b></li> <li>- shtjellimi i temës me ide dhe argumente që paraqesin rëndësi themelore për domethënien e temës <b>1 pikë</b></li> <li>- mendime kritike të ndërlidhura në mënyrë kreative, duke përdorur fakte të sakta që kanë të bëjnë me temën <b>2 pikë</b></li> <li>- të theksuarit (fokusimi në) e idesë themelore në përpilimin e tekstit duke i lidhur pjesët në mënyrë origjinale dhe kreative - <b>1 pikë</b></li> <li>- përdorimi përkatës i stileve letrare dhe jo letrare në kontekstin e temës në të cilën ka origjinalitet dhe kreativitet - <b>1 pikë</b></li> <li>- krijimi i tekstit që përputhet me kërkesat konkrete, të përcaktuara në Udhëzim -<b>1 pikë</b></li> <li>- Përdorimi i leksikut që përputhet me llojin e tekstit dhe me temën - <b>1 pikë</b></li> </ul> | <p><b>Vlerësuesi me kujdes duhet:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ta vlerësojë të kuptuarit e temës dhe shtjellimin e saj në tekst;</li> <li>- ta vlerësojë përputhshmërinë e përmbajtjes në pjesët e kompozicionit;</li> <li>- t'i vlerësojë faktet, idetë, pyetjet dhe përgjigjet e paraqitura në tekstin e dhënë.</li> <li>- ta vlerësojë kreativitetin e paraqitur në tekst</li> <li>- t'i vlerësojë elementet origjinale dhe kreative</li> <li>- me shprehjen <i>leksik</i> përkatës nënkuptohet: përfshirja e fjalëve, e frazave dhe e ndërkombëtarizmave të ndryshëm dhe përdorimi përkatës i tyre.</li> </ul> |
|---|---|--|

**ÇELËSI - GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI**  
**gusht, 2017**

**Vërejtje**

- Pyetjet me alternativa të shumta të përgjigjeve nuk kontrollohen nga vlerësuesit.
- Përgjigjet e pyetjeve të hapura pranohen si të sakta nëse janë të afërta me përgjigjet e çelësit ose si të sakta, pranohen ato formulime të cilat i ka zgjedhur komisioni i vlerësuesve.
- Në *aftësinë Shkrim* vlerësimi i do të bëhet me kritere të veçanta.

**Shënim:**

